



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 265

Tiranë – E enjte, 12 janar 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 134/2016 datë 22.12.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.....	27299
Ligj nr. 135/2016 datë 22.12.2016	Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike.....	27303
Ligj nr. 136/2016 datë 22.12.2016	Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar.....	27309
Ligj nr. 139/2016 datë 22.12.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit.....	27310
Ligj nr. 142/2016 datë 22.12.2016	Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë.....	27312



LIGJ
Nr. 134/2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 10 129, DATË 11.5.2009,
“PËR GJENDJEN CIVILE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, pika 2, pas fjalëve “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile” shtohen fjalët “i vitit 2010 (në vijim Regjistri Kombëtar)”.

Neni 2

Në nenin 11, pas fjalës “shtetësia” shtohen fjalët “ushtrimi i përgjegjesisë prindërore”.

Neni 3

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Gjendja civile e një personi mund të jetë:

- a) “beqar/e”, shtetasi, i cili nuk ka lidhur akt martese;
- b) “i/e martuar”, shtetasi, i cili është lidhur me akt martese;
- c) “i/e ve”, shtetasi, të cilit i ka vdekur bashkëshorti/ja, me të cilin ishte i/e lidhur me akt martese;
- ç) “i/e divorcuar”, shtetasi, martesa e të cilit është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.”.

Neni 4

Në nenin 14, pika 1, pas fjalës “së Shqipërisë”, shtohen fjalët “ose jashtë vendit”.

Neni 5

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

1. Një person apo një ose më shumë familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një personi apo të një familjeje tjetër kur nuk kanë lidhje familjare, kur plotësohen standardet e sipërfaqes së banimit për frymë, si dhe kur zotërojnë një kontratë ose kur kryefamiljari i familjes pritëse apo shtetasi që zotëron titull të ligjshëm pronësie ose përdorimi të banesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat e ndryshimit të vendbanimit.

Në këtë rast, kryefamiljari i familjes pritëse dhe personi apo kryefamiljari që kërkon të banojë në vendbanimin e tij shprehin vullnetin e tyre për këtë qëllim para nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është vendbanimi i familjes pritëse.

2. Në rast të lidhjeve familjare të vërtetuara, pranimi i personit apo i familjes në vendbanimin e ri bëhet në bazë të deklaratimit të tyre para nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është vendbanimi i familjes pritëse.

3. Strukturat komunitare të bashkisë/njësisë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës ndodhet vendbanimi i ri, kryejnë verifikimet përkatëse, në lidhje me plotësimin e standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë. Pas kryerjes së verifikimit, strukturat komunitare përgatisin një raport, i cili është pjesë e praktikës që administron nëpunësi i zyrës së gjendjes civile për këtë qëllim.”.

Neni 6

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”.



Neni 7

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Veprimet për fitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile përcjell në zyrën e gjendjes civile, ku do të regjistrohet shtetasi, dekretin e Presidentit të Republikës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Në këtë rast, zyra e gjendjes civile, në momentin e paraqitjes së shtetasit, cakton datën dhe orën e kryerjes së betimit.

2. Në rastin e dekretit të Presidentit të Republikës për lënien e shtetësisë shqiptare, zyra e gjendjes civile, ku shtetasi rezulton i regjistruar, kryen veprimet për çregjistrimin e tij nga Regjistri Kombëtar brenda 30 ditëve, nga marrja e dekretit. Kopje e këtij dekreti i përcillet Ministrisë së Punëve të Jashtme nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3. Rregullat, procedurat për kryerjen e betimit dhe teksti i betimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.”

Neni 8

Në nenin 27, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Aktet e martesës, të mbajtura në postet konsullore, si dhe deklarimet e lindjes e të vdekjes, të mbajtura në shërbimin e gjendjes civile të vendeve të huaja, për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përcillen, periodikisht, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila ia dërgon për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.”

Neni 9

Në nenin 32, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Për kryerjen e veprimeve, zyrat e gjendjes civile pranojnë vetëm akte ose dokumente origjinale.”

Neni 10

Në nenin 33 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Regjistri Kombëtar është dokumenti unik shtetëror ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile

për çdo shtetas shqiptar, shtetas të huaj, person pa shtetësi si dhe për personat, të cilët kanë fituar statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes plotësuese, për faktet juridike, të cilat kanë ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Në Regjistrin Kombëtar transkriptohen të dhënat për shtetasit shqiptarë sipas akteve të zyrave të gjendjes civile të vendeve të huaja. Pasqyrimi i këtyre akteve bëhet kronologjikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile janë kryer verifikimet e nevojshme për përputhshmërinë e të dhënave në dokumentacionin e administruar me ato të shërbimit të gjendjes civile.”

Neni 11

Në nenin 41 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Fondi për shpërblimin për regjistrimin e lindjes brenda afatit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4, të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit. Procedurat për përfitimin e shpërblimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.”

Neni 12

Neni 50 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 50

1. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet për mbajtjen e aktit të martesës në Regjistrin Kombëtar dhe përditëson të dhënat, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

2. Transkriptimi i të dhënave referuese të aktit të martesës, që shtetasit shqiptarë kanë lidhur në zyrat e gjendjes civile në vende të huaja, në Regjistrin Kombëtar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shtetasi, që pretendon se i është cenuar një e drejtë nga pasaktësi në aktin e martesës, mund t'i drejtohet gjykatës kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, për të rivendosur të drejtën e cenuar.”

Neni 13

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 51

1. Akti i vdekjes është dokumenti që vërteton ligjërisht vdekjen e shtetasit dhe mbahet për çdo të vdekur. Ky akt nënshkruhet nga nëpunësi i gjendjes civile dhe deklaruesi, pasi të jetë administruar dokumenti “skedë vdekjeje”, i lëshuar nga institucionet e autorizuara shëndetësore, që kanë të drejtë të vërtetojnë këtë fakt.

2. Akti i vdekjes përmban:

a) zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku mbahet akti i vdekjes;

b) numrin dhe datën e mbajtjes së aktit të vdekjes;

c) vendin dhe orën e vdekjes;

ç) shkakun e vdekjes, të përcaktuar sipas dokumentit shëndetësor;

d) identitetin dhe numrin personal të të vdekurit ose konfirmimin e të ngarkuarit të posaçëm, për kufomat e gjetura, që nuk mund të identifikohen;

dh) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e mjekut ose të ekspertit mjeko-ligjor, që ka plotësuar skedën e vdekjes;

e) të dhënat referuese të njoftimit përkatës të institucionit të prokurorisë, që autorizon kryerjen e veprimeve për raste të përcaktuara në këtë ligj;

ë) emrin, mbiemrin e nëpunësit të zyrës së gjendjes civile.”

Neni 14

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Deklarimi i vdekjes bëhet nga:

a) çdo pjesëtar madhor i familjes;

b) nga persona të afërt të familjes;

c) për personat e vetmuar, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë/njësisë administrative, në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi që ka ndërruar jetë ka pasur vendbanimin/vendqëndrimin e tij të fundit, ose në zyrën e gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është gjetur kufoma apo ka ndodhur fakti juridik i vdekjes.”

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Afati për deklarimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë, nga data e vdekjes ose gjetja e kufomës, për vdekjet brenda vendit, dhe 90 ditë, nga data e vdekjes, për vdekjet jashtë vendit.”

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Për vdekjen aksidentale, afati i deklarimit në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë nga lëshimi i lejes nga prokurori, e cila paraqitet në zyrën e gjendjes civile nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.”

Neni 15

Në nenin 56, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës ka ndodhur lindja, pasi administron deklaratën e shkruar të personave të përcaktuar në nenin 40, të këtij ligji, lidhur me:

a) emrin që do t'i vendosin fëmijës së lindur, përveç emrave të klasifikuar të papërshtatshëm, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) mbiemrin që do të mbajë fëmija, në përputhje me Kodin e Familjes, i pasqyron këta përbërës të gjendjes civile në aktin e lindjes.”

Neni 16

Në nenin 60, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shërbimi i gjendjes civile, krahas detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, i jep informacion subjekteve të përcaktuar nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, mbi bazën e dokumentacionit që administron, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, kundrejt tarifës që përcaktohet, sipas parashikimit të nenit 73 të këtij ligji.”

Neni 17

Neni 61 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 61

1. Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile organizohet, si më poshtë vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) zyrat e arkivit së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut;

c) zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative;

ç) shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare.

Shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike e konsullore shqiptare funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Veprimet e nëpunësve të autorizuar e të trajnuar në Regjistrin Kombëtar, në postet konsullore, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon



shërbimin e gjendjes civile dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme.

2. Shërbimi i gjendjes civile mund të ofrohet, në mënyrë të kufizuar, edhe nga institucione të tjera shtetërore, të përcaktuara nga legjislacioni përkatës.

3. Shërbimi i gjendjes civile mund të ofrohet edhe në forma ose mënyra të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ofrimin e shërbimeve publike në sportel.

4. Rregullat, llojet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 18

Neni 66 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 66

Emërimi dhe lirimi i nëpunësit në zyrën e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut

Emërimi dhe lirimi nga detyra i nëpunësit në zyrën e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, bëhet nga prefekti i qarkut, me miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, sipas kriterëve të përcaktuara me urdhër të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Neni 19

Në nenin 67 shkronja “b”, fjalët “shkallë rrethi” zëvendësohen me fjalët “nivel qendër qarku”.

Neni 20

Pas nenit 69 shtohet neni 69/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 69/1

1. Dokumenti “certifikatë”, që sipas dispozitave të këtij ligji lëshohet sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar, nga zyra e gjendjes civile në njësi administrative, mund të lëshohet edhe nga zyra e gjendjes civile në bashki, në juridiksionin e së cilës ndodhet njësi.

2. Në rastin e ofrimit të shërbimit, sipas parashikimit të bërë në pikat 2 dhe 3, të nenit 61, të këtij ligji, dokumenti “certifikatë” lëshohet sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar, me nënshkrimin dhe/ose vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.”

Neni 21

Neni 73, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 73

1. Informacionet që jepen nga shërbimi i gjendjes civile për subjektet private, të përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kryhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe të Ministrit të Financave.

2. Të ardhurat e siguruar nga tarifafat, sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.”

Neni 22

Në nenin 74, pika 1, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a” hiqen fjalët “në nenin 15, pika 3”.

2. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) shkelja ose mosrespektimi i dispozitës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 15, dënohet me gjobë, në masën 10 000 lekë, dhe me pezullim të shërbimit deri në vjeljen e gjobës, të cilën e vendos dhe e vjel nëpunësi i gjendjes civile.”

Neni 23

Kudo në ligj, fjalët:

1. Fjalët “njësi bashkiake/komuna” zëvendësohen me fjalët “njësi administrative”.

2. Fjalët “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile” zëvendësohen me fjalët “Regjistri Kombëtar”.

3. Fjalët “Degët e gjendjes civile në qark” zëvendësohen me fjalët “zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut”.

Neni 24

Dispozitë kalimtare

Gjoba e parashikuar për shkeljen ose mosrespektimin e dispozitës së përcaktuar në nenin 22, të këtij ligji, pezullohet për 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 25

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendimin në zbatim të pikës 4, nenit 17, të këtij ligji.



2. Ngarkohet ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile që, brenda 3 muajve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim në zbatim të pikës 3, të nenit 7, dhe të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe Ministri i Punëve të Jashtme të nxjerrin udhëzim të përbashkët, në zbatim të pikës 1, të nenit 17, të këtij ligji.

4. Ngarkohet ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të pikës 1, nenit 21, të këtij ligji.

5. Ngarkohet ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile të nxjerrë urdhrin në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9937, datë 9.1.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 135/2016

PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, EMERGJENCAT DHE SHPËTIMIN NË VEPRIMTARINË MINERARE DHE NË PUNIMET NËNTOKËSORE NË VEPRAT HIDROENERGJETIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë sigurinë dhe shëndetin

në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të garantojë sigurinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve e të personave të tjerë, që kryejnë punë në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Emergjencë” është situata e pazakontë që sjell prishjen e regjimit normal të punës në minierë apo në punime nëntokësore të veprave hidroenergjetike, e shkaktuar nga faktorë natyrorë (gjeologo-minerarë), teknologjikë apo njerëzorë, shoqëruar me avari, aksidente në punë ose për shkak të punës, incidente të rrezikshme apo ngjarje.

2. “Shpëtim” është operacioni i organizuar e i drejtuar me burime njerëzore e materiale për ndërhyrjen në përballimin dhe ndalimin e emergjencës.

3. “Avari” është prishja e regjimit normal të punës në veprimtarinë minerare.

4. “Shpëtues” është punëmarrësi i kualifikuar, i specializuar dhe i trajnuar për ndërhyrje në përballimin e ndalimin e emergjencave dhe në operacione shpëtimi në nëntokë.

5. “Inspektor” është punëmarrësi i kualifikuar i AKSEM-it, me eksperiencë profesionale, që ushtron kontroll në zbatimin e kërkesave ligjore e teknike për sigurinë dhe shëndetin në punë në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike.

6. “Subjekt” është personi juridik ose fizik që zotëron leje minerare, marrëveshje kontraktuese për punë në miniera apo në ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

7. “Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)” është autoriteti shtetëror kompetent për inspektimin e sigurisë, vlerësimin e rreziqeve, përcaktimin e masave parandaluese, vendosjen e sanksioneve dhe ndërhyrjen për përballimin e emergjencës dhe



shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe të punimeve nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

8. “Punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike” janë tunele, puse, kanale, xhepa që ndërtohen ose hapen në nëntokë nga subjekti që kryen veprimtari për ndërtimin e veprave hidroenergjetike.

9. “Veprimtari minerare” janë veprimtaritë e kërkimit, të zbulimit, shfrytëzimit, përpunimit, mbylljes, konservimit dhe rehabilitimit të mjedisit minerar.

10. “Vepra hidroenergjetike” janë vepra të ndërtuara në përputhje me legjislacionin në fuqi, të cilat, me anë të proceseve shndërruese, shfrytëzojnë potencialin e rënies së ujit për prodhimin e energjisë elektrike.

11. “Pajisje vetëshpëtuese” janë aparate që shërbejnë për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes nga veprimi i gazeve helmuese, për një periudhë të caktuar kohe.

12. “Ministri” është ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

a) institucionet qendrore shtetërore, që përcaktojnë me anë të akteve nënligjore procedurat për realizimin dhe mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit të punëmarrësve në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike;

b) subjektet publike e private, vendase ose të huaja, që administrojnë, kryejnë punë në veprimtarinë minerare, punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike;

c) subjektet publike e private, vendase ose të huaja, që kryejnë e miratojnë studime, përgatisin dhe zbatojnë projekte teknike, hartojnë e miratojnë programe e planizim të zhvillimit të punimeve në veprimtarinë minerare dhe punime nëntokësore në vepra hidroenergjetike;

ç) autoriteti shtetëror kompetent për inspektimin e sigurisë në punë në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike, për vlerësimin e rreziqeve dhe të ndërhyrjeve në emergjenca e shpëtim.

KREU II

KËRKESA DHE DETYRIME PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, EMERGJENCAT DHE SHPËTIMIN

Neni 5

Kërkesat e sigurisë në punë

1. Të gjitha subjektet që kryejnë veprimtari në miniera dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike, si dhe studime ose projekte në këto fusha, janë të detyruara të zbatojnë kërkesat e sigurisë në punë në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, të emergjencave dhe shpëtim.

2. Kërkesat e sigurisë teknike në punë dhe në veprimtarinë minerare e punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, të emergjencave dhe shpëtim, hartohen nga ministri, në bashkëpunim me AKSEM-in, dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Detyrimet e subjekteve

1. Çdo subjekt që zotëron një leje minerare, që kontraktin një shërbim të specializuar mbi një të drejtë minerare, si dhe ato që kanë marrëveshje kontraktore për të kryer punime nëntokësore të veprave hidroenergjetike, para fillimit të veprimtarisë regjistrohen në AKSEM.

2. Subjektet, në momentin e regjistrimit të tyre në AKSEM, deklarojnë personat përgjegjës, të ngarkuar me drejtësimin administrativ, drejtësimin teknik dhe problemet e sigurisë në punë, si dhe informojnë, jo më vonë se 5 ditë pune, për çdo ndryshim të këtij personeli.

3. Çdo vend pune, objekt, instalim dhe impiant, që lidhet me veprimtarinë minerare dhe që ka punëmarrës që kryejnë punë, duhet të jetë i projektuar dhe nën kontrollin e mbikëqyrjes e një personi përgjegjës.

4. Subjektet njoftojnë menjëherë AKSEM-in për çdo rast aksidenti, me rrezik ose humbje jete, si dhe për raste të emergjencave serioze, që kërkojnë ndërhyrjen e trupës së emergjencave dhe shpëtim, si dhe këqyrjen e vendit të ngjarjes nga ky institucion.

5. Çdo subjekt minerar apo subjekt që kryen punime nëntokësore të veprave hidroenergjetike me palët nënkontraktore përcakton, me



marrëveshje të firmosur, përgjegjësitë për zbatimin e kërkesave ligjore për sigurinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të punëmarrësve.

6. Subjektet duhet të njoftojnë AKSEM-in, brenda 5 ditëve pune, për ndërprerjen apo rifillimin e punës në objekt.

Neni 7

Emergjencat dhe shpëtimi

1. Çdo subjekt që kryen punime nëntokësore, ku vërtetohet prania e gazit metan ose gazeve të tjera shpërthyesë apo ekzistojnë mundësitë e shfaqjes së tyre, siguron organizimin dhe funksionimin e skuadrës për emergjencë dhe shpëtim.

2. Çdo subjekt, që kryen punime nëntokësore, është i detyruar të përgatisë planin e emergjencave, si një dokument për planizimin dhe përballimin e emergjencave nëntokësore, ku pasqyrohen, në mënyrë të hollësishme, parashikimi, masat parandaluese dhe burimet njerëzore e materiale për të përballuar rastin dhe shpëtimin e njerëzve.

3. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e emergjencave dhe shpëtimin, si dhe procedurat e hartimit, përmbajtjes e miratimit të planit të emergjencës, të detyrueshme për subjektet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe për subjektet e tjera që kryejnë punime në nëntokë, në miniera apo në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Çdo punëmarrësi të nëntokës i sigurohen pajisje të mbrojtjes personale dhe pajisje vetëshpëtimi personale.

Neni 8

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Mbikëqyrja shëndetësore e punëmarrësve është detyrim i punëdhënësit.

2. Punëdhënësi u siguron punëmarrësve mbikëqyrje shëndetësore të përshtatshme, me risqet për sigurinë e shëndetit në vendin e punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë e mjekësinë e punës.

3. Punëdhënësi, siguron mbikëqyrje shëndetësore në momentin e fillimit të punës dhe mbikëqyrje shëndetësore periodike, në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator në fuqi për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë të punëmarrësve në industrinë minerare nxjerrëse

sipërfaqësore e nëntokësore dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

4. Çdo kosto financiare për mbikëqyrjen shëndetësore të punëmarrësve është detyrim i punëdhënësit.

Neni 9

Sinjalizimi dhe komunikimi

1. Subjekti merr masat e nevojshme për të siguruar e garantuar sistemin dhe pajisjet e sinjalizimit, të dallueshme qartë për çdo vend pune që paraqet rrezik për jetën e shëndetin e punëmarrësve, si dhe për të parandaluar apo mënjanuar hyrjen e personave të tjerë në sipërfaqen e lejuar të veprimtarisë së tij apo në punimet që kryhen në veprën e tij nëntokësore.

2. Subjekti siguron funksionimin e sistemit të komunikimit të çdo niveli drejtimi me punëmarrësit në vendin e punës, si në kushte normale, ashtu edhe në raste për të përballuar e shmangur rreziqe apo për të realizuar ndërhyrje të menjëhershme, në raste emergjencash e fatkeqësish.

KREU III

ZHVILLIMI I PUNIMEVE NË OBJEKT

Neni 10

Zhvillimi i punimeve

1. Subjektet zhvillojnë punime në rastet kur:

a) ka projekte teknike e pasaporta teknologjike të miratuara për punimet dhe punët që do të kryejnë;

b) plotësojnë kërkesat e parashikuara në rregulloret e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë dhe sigurojnë normat për ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit;

c) janë marrë masa që punimet në miniera, punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike, makineritë, pajisjet dhe lënda plasëse të mirëmbahen në një nivel të tillë, që të plotësojnë kërkesat e sigurisë në punë;

ç) zotëruesi i lejes minerare zbaton kërkesat e përcaktuara në projektin e miratuar tekniko-teknologjik.

Neni 11

Informimi i punëmarrësve

1. Subjektet që kryejnë veprimtari minerare dhe punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike



marrin masa që punëmarrësit të përvetësojnë të dhënat dhe instruksionet e duhura për përdorimin e makinerive, të pajisjeve, të lëndës plasëse dhe të materialeve që kanë në përdorim.

2. Të dhënat dhe instruksionet e përdorimit të makinerive, pajisjeve e të lëndës plasëse duhet të përmbajnë informacione për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Neni 12

Formimi i punëmarrësve

Subjektet që kryejnë veprimtari minerare dhe punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike marrin masat e nevojshme që punëmarrësit:

a) e ngarkuar për përdorimin e makinerive, të pajisjeve dhe të lëndës plasëse të kenë formimin e mjaftueshëm për rreziqet që përmban përdorimi i tyre;

b) e ngarkuar me riparimet dhe mirëmbajtjen të kenë kualifikimin dhe formimin e duhur për kryerjen e këtyre detyrave;

c) që kryejnë punë me lëndë plasëse dhe ata të skuadrave për emergjencë e shpëtim në subjekte të testohen, të vlerësohen e të pajisen me dëshmi çdo 5 vjet, nga komisionet teknike të ngritura në AKSEM.

Neni 13

Këqyrja e avarive

1. Për çdo rast aksidenti ose avarie të rëndë në minierë, në karrierë apo punim nëntokësor në veprat hidroenergjetike, subjekti duhet të njoftojë menjëherë AKSEM-in, Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe çdo institucion tjetër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. AKSEM-i shqyrton aksidentet e avaritë e rënda që ndodhin gjatë veprimtarisë dhe përcakton shkaqet e përgjegjësitë si dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e gjendjes.

3. Zotëruesi i lejes minerare dhe/ose subjekti që kryen punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike është i detyruar t'i japë inspektorit që shqyrton aksidentin ose avarinë çdo të dhënë që ka lidhje me të.

KREU IV

AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Neni 14

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është person juridik publik, buxhetor, i organizuar në nivel qendror, i cili kryen veprimtari në fushën e sigurisë në punë, të emergjencave dhe shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

Neni 15

Organizimi

1. AKSEM-i organizohet si drejtori në varësi të ministrit dhe e ka selinë e tij në Tiranë.

2. Organizimi dhe funksionimi i AKSEM-it rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Marrëdhëniet e punës së titullarit të AKSEM-it dhe nëpunësve të tij rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil.

4. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 16

Detyrat e AKSEM-it

1. Për përballimin e emergjencave në subjekte, AKSEM-i realizon këto detyra:

a) për çdo situatë emergjente në veprimtari në miniera dhe në punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike siguron gatishmërinë e plotë të personelit, të pajisjeve e të mjeteve për të ndërhyrë e përballuar situatën e shpëtimit të jetës së njerëzve;

b) kërkon, nga çdo subjekt që kryen punime nëntokësore, të parashikojë në praktikën e punës së tij situatat emergjente dhe të ketë të përgatitur planin e emergjencave, në lidhje me masat për përballimin e tyre, një kopje e të cilit dorëzohet në AKSEM çdo vit dhe sa herë subjekti praktikon punë në nëntokë për herë të parë;

c) inspekton, bashkëpunon, bashkëvepron e kryen stërvitje të përbashkët me personelin e emergjencave të subjekteve në kushtet konkrete të zhvillimit të punimeve apo në situata të improvizuara emergjence;



ç) monitoron e mbikëqyr minierat e mbyllura dhe jashtë përdorimi;

d) vlerëson, mbyll dhe monitoron grykat e punimeve minerare në minierat e braktisura;

dh) regjistron çdo subjekt që kryen veprimtari minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike;

e) vlerëson aftësitë teknike dhe profesionale të çdo personi fizik që kërkon të përdorë e të kryejë punë me lëndë plasëse në subjekte apo të punojë si specialist për emergjencë dhe shpëtim;

ë) regjistron rastet e emergjencave dhe të aksidenteve të rënda me rrezik apo humbje jete;

f) kryen analizat dhe verifikon rezistencën në tërheqje të litarëve të çelikut, që përdoren në impiantet ngritëse vertikale e të pjerrëta të transportit në subjekte;

g) verifikon e vlerëson territorin e vendndërtimit të depove për magazinimin e lëndëve plasëse të subjekteve dhe miraton projektin e ndërtimit të këtyre depove;

gj) kryen vlerësimin e projekteve teknike, me qëllim pajisjen e subjekteve me autorizimin e përdorimit civil të lëndëve plasëse;

h) çdo detyrë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 17

Të drejtat e AKSEM-it

1. Inspektorët e AKSEM-it kanë të drejtë të hyjnë, sipas programit të inspektimit të miratuar, në çdo kohë në territorin dhe në vendet e punës të subjekteve që kryejnë punë në veprimtarinë minerare dhe në punime nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

2. Në zbatim të programit dhe të objektit të inspektimit, inspektorët e AKSEM-it kanë të drejtë të kërkojnë e të marrin një kopje të dokumenteve administrative e teknike të veprimtarisë së subjektit.

3. Inspektorët dhe personeli i emergjencave të AKSEM-it kërkojnë mbështetjen dhe ndërhyrjen e forcave të rendit kur:

a) pengohen dhe cenohen gjatë kryerjes së detyrës;

b) nuk zbatohet urdhri i ndalimit dhe ndërprerja e punës, në rastet me rrezik serioz për jetën e njerëzve;

c) nuk lejohen të hyjnë në hapësirat e punës së subjekteve.

Neni 18

Inspektimi i subjekteve nga AKSEM-i

1. AKSEM-i kryen inspektime në subjekte private dhe publike, vendase e të huaja, që ushtrojnë veprimtari minerare dhe punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Veprimtaritë minerare, punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike u nënshtrohen inspektimeve të programuara të AKSEM-it, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Minierat dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike u nënshtrohen inspektimeve teknike jashtë programit të AKSEM-it në çdo kohë, kur paraqiten rrethana të veçanta, që lidhen me rreziqe për jetën e njerëzve, avari ose aksidente.

4. AKSEM-i kryen inspektime në subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare dhe punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike, ku vlerëson nëse:

a) ushtrimi i aktivitetit minerar apo punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike kryhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi;

b) është përgatitur dokumentacioni teknik i nevojshëm për ushtrimin e sigurt të aktivitetit minerar apo për punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike;

c) janë marrë masat e nevojshme për kujdesin shëndetësor të punëmarrësve, në përputhje me legjislacionin dhe aktet teknike në fuqi.

Neni 19

Masat urgjente

1. Kur inspektori i AKSEM-it konstaton se një minierë ose punim nëntokësor në veprat hidroenergjetike rrezikon sigurinë e njerëzve dhe të mjedisit, me vendim të ndërmjetëm, sipas nevojave të rastit, merr masa urgjente, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kundër vendimit që vendos masa urgjente mund të bëhet ankimi i veçantë, në përputhje me ligjin për inspektimin.



Neni 20

Konflikti i interesave

1. Punëmarrësve të AKSEM-it u ndalohet të kenë interesa të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me subjektet ku ata ushtrojnë kontroll.

2. Punëmarrësit e AKSEM-it kanë detyrim të përmbushin çdo kërkesë tjetër, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Neni 21

Burimet financiare

1. Burimet financiare të AKSEM-it janë:

a) Buxheti i Shtetit;

b) të ardhurat me destinacion, që realizohen nga shërbimet për të tretët.

2. AKSEM-i realizon të ardhura nga shërbimet që kryen për subjektet private ose publike, nga pagesa e tarifave për:

a) lëshimin e dëshmimeve dhe publikatave për zjarrmëtarët dhe shpëtuesit e subjekteve;

b) realizimin e provave dhe analizave të rezistencës në tërheqje të litarëve të çelikut të impianteve ngritëse të subjekteve;

c) regjistrimin fillestar të subjekteve;

ç) monitorim, verifikim e inspektim, të kërkuara nga vetë subjekti.

3. Tarifat për këto të ardhura caktohen me udhëzim të përbashkët nga Ministri i Financave dhe ministri që mbulon veprimtarinë minerare.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga AKSEM-i, si më poshtë:

a) kur subjekti kryen shkelje të pikave 1, 2 e 6, të nenit 6, të këtij ligji, masa e gjobës është 150 mijë lekë;

b) kur subjekti nuk njofton AKSEM-in në rast aksidenti ose avarie të rëndë në minierë, në karrierë apo në punim nëntokësor në veprat hidroenergjetike, masa e gjobës është 100 mijë lekë;

c) kur subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna e të përcaktuara në aktet e inspektimit të mëparshëm të AKSEM-it, masa e gjobës është 200 mijë lekë;

ç) kur shkelen pikat e nenit 7, të këtij ligji, masa e gjobës është 200 mijë lekë;

d) kur konstatohet se mungon plani vjetor i zhvillimit të punimeve apo punohet jashtë këtij plani, nuk ka sigurim jete për të gjithë punëmarrësit, urdhrat e punës dhe udhëzimet teknike nuk respektojnë normat teknike të vendosura, mungojnë pasaportat teknologjike për procese të ndryshme të praktikës së punës, planimetria e punës së objektit nuk plotësohet sipas rregullave teknike të sigurisë, masa e gjobës është 300 mijë lekë;

dh) kur inspektori ose grupi i inspektorëve të AKSEM-it pengohet të kryejë detyrën, në zbatim të dispozitave të kreut IV, të këtij ligji, masa e gjobës është 400 mijë lekë.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të AKSEM-it bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

3. Të ardhurat nga masat administrative, të aplikuara sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

Neni 23

Pezullimi i punimeve

1. Në rastet e përfundimit të inspektimeve të programuara apo të inspektimeve jashtë programit, inspektori ose grupi i inspektorëve të AKSEM-it, kur vlerëson prezencë të rreziqeve serioze për jetën e punëmarrësve, shkelje të rënda të ligjit e të rregullave teknike për sigurinë dhe shëndetin në punë, pezullon kryerjen e punimeve në objekt.

2. Pezullimi i punimeve mund të jetë tërësor ose i pjesshëm, për vende e fronte pune të veçanta, i përkohshëm ose i përhershëm.

3. Pezullimi i punimeve pasqyrohet në procesverbal dhe i bëhet i ditur, menjëherë, përfaqësuesit të subjektit. Në procesverbal pasqyrohen qartë hapësira, koha e pezullimit dhe detyrat konkrete.

4. Në rastet kur merret vendim për pezullim tërësor të punimeve, pavarësisht nga koha, përgatitet relacioni me problematikën e subjektit dhe i dërgohet ministrit.

5. Kur subjekti nuk respekton vendimin e pezullimit të punimeve të inspektorëve, AKSEM-i i



propozon ministrin revokimin e lejes së subjektit dhe njofton organet e Policisë së Shtetit e të prokurorisë, në territorin ku kryen aktivitet subjekti.

Neni 24

E drejta e subjekteve për ankim

1. Kundër vendimit me gjobë, të vendosur nga inspektorët e AKSEM-it, subjekti ka të drejtën e ankimit me shkrim pranë komisionit të shqyrtimit të gjobave në AKSEM, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

2. Komisioni i shqyrtimit të gjobave në AKSEM, i miratuar sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit, shqyrton ankimin, merr vendimin dhe njofton subjektin për vendimin e marrë brenda 15 ditëve, nga data e regjistrimit të ankimit.

3. Subjektet kanë të drejtën që, kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Gjobave, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kundër vendimit për pezullim apo ndalim të punimeve në mënyrë tërësore, subjekti ka të drejtë të bëjë ankim te ministri, brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së vendimit të inspektorëve të AKSEM-it.

5. Brenda 15 ditëve, nga data efektive e ankimit, ministri shqyrton ankimin, ngrë grup pune për rivlerësim të problematikës dhe merr vendim përfundimtar.

6. Subjektet kanë të drejtë që, kundër vendimit të ministrit, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën administrative të shkallës së parë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 5, pika 2, nenit 7, pika 3, dhe nenit 15, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri dhe Ministri i Financave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 21, pika 3, të këtij ligji.

Neni 26

Shfuqizime

1. Ligji nr. 8741, datë 15.2.2001, “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë e sigurisë në punë, të emergjencave dhe shpëtimit në veprimtarinë minerare apo në punimet hidroenergjetike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në daljen e akteve të reja nënligjore.

Neni 27

Ndryshim emërtimi

1. Në çdo akt ligjor ose nënligjor, apo marrëdhënie juridike të krijuar, emërtimi “Repartit i Inspektim-Shpëtim Miniera”, zëvendësohet me “Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”.

2. Titullari dhe punëmarrësit e ish-Repartit të Inspektim-Shpëtim Miniera konsiderohen të emëruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9938, datë 9.1.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 136/2016

PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 9584, DATË 17.7.2006, “PËR PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA ME LIGJ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, pika 1, shtohet emërtimi “Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” .

Neni 2

Në lidhjen nr.1, që përmendet në nenin 4, bëhen këto shtesa:

1. Në klasifikimin “D”, pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11. Kryetari i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 0,6.”.

2. Në klasifikimin “E”, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 0,55”.

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Për anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ky ligj i shtrin efektet financiare nga data e emërimit në detyrë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9939, datë 9.1.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 139/2016**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE NR. 1 TË
MARRËVESHJES NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SHTETEVE TË BASHKUARA TË
AMERIKËS PËR KONTROLLIN E
LËNDËVE NARKOTIKE DHE
ZBATIMIN E LIGJIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese nr.1 e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9942, datë 9.1.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**MARRËVESHJE NDRYSHUESE NR. 1
E MARRËVESHJES PËR KONTROLLIN E
LËNDËVE NARKOTIKE DHE ZBATIMIN E
LIGJIT, I DATËS 1 KORRIK 2015,
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

I. Informacion i përgjithshëm

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (secila individualisht e referuar si "Pala" dhe kolektivisht si "Palët") bien dakord bashkërisht të modifikojnë dhe ndryshojnë marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve



të Bashkuara, të nënshkruar në datën 1 korrik 2015 (Marrëveshja) si më poshtë:

Me qëllim modifikimin e Programit për Zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë Penale dhe shtesën prej 3 milion \$ për të zbatuar reformat gjyqësore;

Përshkrimi i plotë i projektit dhe objektivat e përmbushjes së objektivave janë përshkruar në seksionin II dhe III më poshtë. Ky ndryshim i marrëveshjes së datës 1 korrik 2015 nuk i ndryshon matjet e performacës të zbatueshme për projektet e renditura sipas marrëveshjes. Të gjitha detyrimet, afatet dhe kushtet e tjera në përmbajtje të marrëveshjes së datës (data) do të mbeten të zbatueshme dhe në fuqi dhe efekt të plotë. Sigurimi i financimit të qeverisë së SHBA-së pas vitit aktual fiskal kushtëzohet nga progresi i kënaqshëm në drejtimit të objektivave të projektit dhe disponueshmërisë së fondeve të autorizuara dhe të ndara mbi bazë vit pas viti nga Kongresi i SHBA-së dhe të miratuara nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Palët bien dakord që për këto qëllime mund të sigurohen fonde shtesë, në bazë të të njëjta termave dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen, e ndryshuar, pa qenë e nevojshme më pas të ndryshojë marrëveshjen për të pasqyruar shumën e fondeve të siguruar. Qeveria e SHBA-së do të njoftojë Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, kur duhet të jepen burime shtesë në mbështetje të këtyre projekteve.

II. Përshkrimi i projektit

Programi për zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë Penale

Programi për zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë Penale (SDP) do të sigurojë asistencë për institucionet kryesore të drejtësisë penale të Shqipërisë, zyrtarët e antikorrupsionit dhe agjencitë mbështetëse për të forcuar kapacitetin e Shqipërisë për të luftuar të gjitha format e krimit, në veçanti duke u fokusuar në përmirësimin e efektivitetit dhe cilësisë së procedimeve penale dhe forcimin institucional në këtë kuadër. Rezultatet e projektit do të përfshijnë trajnimin, dhurimin e pajisjeve, asistencën teknike dhe këshillimin nga ekspertë të fushave, duke përfshirë ekspertët e Shteteve të Bashkuara, pjesëmarrës nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Bisedimet për Zgjerim të Komisionit Evropian.

Masat e ndërmarra në mbështetje të kësaj iniciative përfshijnë zbatimin e pesë (5)

komponentëve: 1. Rritja e kapacitetit të prokurorëve dhe hetuesve për të luftuar krimet e organizuara, korrupsionin dhe format e tjera të aktiviteteve kriminale; 2. Zhvillimi i një sistemi të drejtësisë penale nëpërmjet legjislacioneve të përmirësuara; 3. Ndihma ndaj gjyqësorit për të gjykuar rastet brenda afateve kohore, në mënyrë efektive, të paanshme dhe etike; 4. Rritja e aksesit të qytetarëve në drejtësi; dhe 5. Monitorimi i zbatimit të reformave gjyqësore dhe mbikëqyrja për vetëgjykim/verifikimin e gjyqësorit në koordinim me Komisionin Evropian.

Programi për zhvillimin e sistemit të drejtësisë kriminale do të marrë plotësisht në konsideratë bisedimet për anëtarësim ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, në mënyrë të veçantë planet e veprimit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe kapitullin 24 (Drejtësia, liria dhe siguria) të *Acquis Communautaire* (legjislacionit të Bashkimit Evropian). Gjithashtu, SDP do të sigurojë ekspertizë sa herë që është e përshtatshme dhe e mundur.

Për këtë qëllim, Qeveria e SHBA-së dhe Qeveria e Shqipërisë do të ndërmarrin veprime dhe do t'i përdorin burimet mbi baza vjetore, siç autorizohet nga proceset e tyre përkatëse legjislative për të mbështetur këtë përpjekje.

Masat që duhet të merren përfshijnë:

- Mbështetjen dhe financimin e projekteve për Zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë Penale për të zbatuar komponentët e përshkruar më sipër.

III. Objektivat e përmbushjes së projektit dhe verifikimi i arritjeve

Qëllimi afatgjatë i këtij projekti është forcimi i sektorit shqiptar të drejtësisë penale, institucionet dhe zyrtarët e tij, në mënyrë që të përgjigjet për të gjitha llojet e krimit, me fokus të veçantë në korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke synuar ta afrojë vendim më pranë anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në përputhje me qasjen strategjike të vendit. Një plan menaxhimi i performancës (PMP) i referuar edhe si një plan monitorimi dhe vlerësimi (M&V) për menaxhimin e procesit të mbledhjes së të dhënave, si dhe mbledhjen dhe rregullimin e të dhënave, do të zbatohet për çdo projekt.

Komponenti I i Projektit: Rritja e kapacitetit të prokurorëve dhe hetuesve për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe format e tjera të aktivitetit kriminal.



- Objektivi i këtij komponenti të projektit është zhvillimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse për trajnimin, orientimin dhe këshillimin për prokurorët dhe hetuesit.

Komponenti 2 i Projektit: Zhvillimi i sistemit të Drejtësisë Penale nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit.

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është dhënia e kontributit dhe këshillimit për hartimin e ligjit themelor të drejtësisë penale, politikave dhe kodit etik.

Komponenti 3 i Projektit: Ndhurma ndaj gjyqësorit për gjykimin e çështjeve në kohë, në mënyrë efikase, të paanshme dhe etike.

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është rritja e transparencës dhe të kuptuarit e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit.

Komponenti 4 i Projektit: Rritja e aksesit të qytetarëve në drejtësi.

- Objektivi i këtij komponenti të Projektit është rritja e aksesit të qytetarëve shqiptarë në drejtësi.

Komponenti 5 i Projektit: Monitorimi i zbatimit të reformave gjyqësore dhe mbikëqyrja për vetingun e gjyqësorit në koordinimin me Komisionin Evropian.

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është monitorimi i zbatimit të reformave gjyqësore dhe mbikëqyrjes për vetingun e gjyqësorit, në koordinim me Komisionin Evropian.

IV. Vlerësimi i programit

Përfaqësuesit e palëve do të takohen dy herë në vit për të rishikuar progresin ndaj arritjes së objektivave të projektit. Një raport me shkrim mbi këto takime do të përgatitet dhe do t'i jepet palëve përkatëse. Progresi do të vlerësohet në përputhje me parametrat e arritjes të përshkruara më sipër. Informacioni që duhet të shqyrtohet gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve do të përfshijë tregues cilësorë dhe sasiorë. Këto vlerësime i shtohen monitorimit të vazhdueshëm të programeve dhe aktiviteteve nga personeli përkatës i të dy qeverive. Në këtë kontekst, një punë praktike nga ana e përfituesve do të ndiqet me synimin e evidentimit të ndryshimeve që mund të lidhen me ushtrimin e aftësive dhe njohurive të reja (për shembull, zbatimin e standardeve ndërkombëtare në të drejtat e njeriut dhe fusha të tjera, kohës së nevojshme për kryerjen e hetimeve, numrin e padive të depozituara dhe të gjykuara, si dhe arritjes e ngjashme të identifikueshme).

Bërë në dy kopje në Tiranë, Shqipëri më datë 21 të muajit shtator të vitit 2016, në gjuhën angleze dhe shqipe ku të dy tekstet janë njëjloj autentike.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

PËR QEVERINË E SHTETEVE TË
BASHKUARA
AMBASADORI
Donald Lu

LIGJ
Nr. 142/2016

KODI HEKURUDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË¹

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

¹ Ky Kod është përfshirë me:

- Direktivën 2012/34/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 nëntor 2012, “Për krijimin e një zone të vetme europiane bekurudbore”, Numri CELEX 32012L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 343, datë 14.12.2012, faqe 32-77.

- Direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016, “Mbi sigurinë bekurudbore”, Numri CELEX 32016L0798, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 138, datë 26.5.2016, faqe 102-149.

- Direktivën (BE) 2016/797 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016, “Mbi ndërpërimin e sistemit bekurudbor brenda Bashkimit Europian”, Numri CELEX 32016L0797, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 138, datë 26.5.2016, faqe 44-101.

- Direktivën 2007/59/KE/ të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007, “Mbi certifikimin e makinistëve të lokomotivave dhe trenave operative në sistemin bekurudbor në Komunitetin Europian”, të ndryshuar, Numri CELEX 32007L0059, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 315, datë 3.12.2007, faqe 51-78.

- Rregulloren (BE) 2016/976 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016, “Për Agjencinë e Bashkimit Europian për Hekurudbat dhe që shfuqizon rregulloren (KE) nr. 881/2004”, Numri CELEX 32016R0796, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 138, datë 26.5.2016, faqe 1-43.

- Rregulloren (KE) 1370/2007 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2007, “Për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudbë dhe rrugë dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KKE) nr. 1191/69 dhe nr. 1107/70”, Numri CELEX 32007R1370, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 315, datë 3.12.2007, faqe 1-13.

- Rregulloren (KE) 1371/2007 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007, “Mbi të drejtat dhe detyrimet e pasagjerëve bekurudbore”, Numri CELEX 32007R1371, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 315, datë 3.12.2007, faqe 14-41.



Neni 1 Objekti

Ky Kod përcakton:

a) rregullat e zbatueshme për administrimin e infrastrukturës hekurudhore dhe të aktiviteteve të transportit hekurudhor të sipërmarrësve hekurudhorë dhe operatorëve, veprimtaria e të cilëve rregullohet me anë të këtij Kodi;

b) kriteret e zbatueshme për Autoritetin Rregullator Hekurudhor, Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore, Autoritetin Licencues Hekurudhor dhe për Autoritetin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore;

c) parimet dhe procedurat e zbatueshme për vendosjen dhe mbledhjen e tarifave të infrastrukturës hekurudhore dhe ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore.

Neni 2 Qëllimi

Ky Kod ka si qëllim:

a) krijimin e një kuadri ligjor të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen dhe zhvillimin e transportit hekurudhor bashkëkohor në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) zhvillimin e një transporti hekurudhor efikas dhe konkurrues me llojet e tjera të transportit, duke krijuar kushtet që sipërmarrësit hekurudhorë të kenë statusin e operatorëve të pavarur e të përshtaten me nevojat e tregut, në përputhje me zakonet e mira tregtare;

c) organizimin dhe funksionimin e sektorit hekurudhor në bazë të parimeve të ndarjes së administrimit dhe ndarjes së llogarive midis infrastrukturës hekurudhore dhe veprimtarive të transporteve hekurudhore;

ç) zhvillimin dhe përmirësimin e sigurisë në hekurudhë dhe të qasjes në treg për shërbime të transportit hekurudhor nëpërmjet:

i) krijimit të një Autoriteti Rregullator Hekurudhor, një Autoriteti të Sigurisë Hekurudhore, një Autoriteti Licencues Hekurudhor dhe një Autoriteti Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, duke përcaktuar qartë mënyrën e ndërveprimit të tyre;

ii) zhvillimit dhe realizimit të objektivave të përbashkët të sigurisë dhe metodave të përbashkëta të sigurisë, me qëllim harmonizimin e rregullave kombëtare.

Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Ky Kod zbatohet në:

a) përdorimin e sistemit hekurudhor për shërbime hekurudhore, kombëtare dhe ndërkombëtare;

b) sistemin hekurudhor të Republikës së Shqipërisë, që ndahet në nënsisteme përbërëse strukturore dhe operative të ndërtimit e të funksionimit të tij;

c) aplikimin e kërkesave të sigurisë në të gjithë sistemin hekurudhor, duke përfshirë administrimin e sigurt të infrastrukturës hekurudhore, të operimit të trafikut dhe të ndërveprimit midis sipërmarrësve hekurudhorë dhe administruesve të infrastrukturës.

2. Përjashtohen nga zbatimi i këtij Kodi:

a) metrotë, tramvajet dhe sistemet e tjera të lehta hekurudhore;

b) rrjetet që janë të ndara nga ana funksionale dhe pjesa tjetër e sistemit hekurudhor, e destinuar për funksionimin e shërbimeve lokale, urbane ose periferike të udhëtarëve dhe/ose të mallrave, si dhe sipërmarrësit hekurudhorë që operojnë në këto rrjete;

c) veprimtari të tjera, që rregullohen me aktet nënligjore të ministrit përgjegjës për transportet.

Neni 4 Parime të përgjithshme

1. Transporti hekurudhor në Republikën e Shqipërisë rregullohet me dispozitat e këtij Kodi dhe aktet ligjore dhe nënligjore që miratohen në zbatim të tij, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe atë ndërkombëtar në këtë sektor.

2. Normat dhe aktet ligjore dhe nënligjore, në zbatim të këtij Kodi, udhëhiqen nga parimi i sigurisë hekurudhore në lëvizje, lirisë së ofrimit të shërbimeve hekurudhore, ndërveprimit në lëvizjen në hekurudhë, nga parimi i tregut të hapur dhe konkurrues, transparent dhe jodiskriminues.

3. Njohja dhe zbatimi i përpiktë i dispozitave të këtij Kodi dhe i akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij janë të detyrueshme për të gjitha subjektet që kryejnë veprimtari dhe ofrojnë shërbime në sektorin e transportit hekurudhor në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë mallrat dhe udhëtarët që qarkullojnë në këtë rrjet.



Neni 5 Përkufizime

Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrues i infrastrukturës” është çdo organ apo kompani përgjegjëse në veçanti për krijimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, duke përfshirë administrimin e trafikut e të komandë-kontrollit dhe sinjalizimit. Funkcionet e administruesit të infrastrukturës në një rrjet ose në një pjesë të një rrjeti mund të ndahen në organe ose kompani të ndryshme.

2. “Aksident” është një ngjarje e padëshiruar ose e papritur, e paplanifikuar ose një zinxhir specifik i këtyre ngjarjeve, që kanë pasoja të dëmshme. Aksidentet ndahen në kategoritë e mëposhtme: përplasjet, përmbysjet (daljet nga binarët hekurudhorë), aksidentet në kalimet në nivel, aksidentet ndaj personave që përfshijnë mjetet hekurudhore në lëvizje, zjarret dhe të tjera. Kur çdo përplasje treni ose dalje nga shinat në lëvizje ka shkaktuar të paktën vdekjen e një personi ose lëndime të rënda deri në pesë apo më shumë personave ose dëme të mëdha të mjeteve lëvizëse, infrastrukturës a mjedisit dhe çdo aksident tjetër i ngjashëm, që ka pasoja të dukshme mbi rregullat e sigurisë hekurudhore ose administrimin e sigurisë hekurudhore, nënkupton aksident të rëndë.

3. “Agjencia” është Agjencia e Bashkimit Europian për Hekurudhat.

4. “Aplikimi *ad hoc*” është kërkesë për rrugëkalime individuale të trenave, si nevojë e një kapaciteti shtesë në orarin e përcaktuar të lëvizjes së trenave.

5. “Aplikues për kapacitet të infrastrukturës” është një sipërmarrje hekurudhore ose një grupim ndërkombëtar i sipërmarrjeve hekurudhore apo personave të tjerë, fizikë e juridikë, siç është çdo autoritet publik apo grup i autoriteteve publike të shtetit, që ka fuqinë për të ndërhyrë në transportin publik të udhëtarëve në një zonë të caktuar gjeografike ose çdo organ i caktuar me autoritet të tillë dhe sipërmarrësit hekurudhorë, operatorët e mallrave dhe operatorët e kombinuar të transportit, me një shërbim publik ose interes tregtar në procedurat ligjore për përfitim të kapaciteteve të infrastrukturës.

6. “Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore” është organi kombëtar i sigurisë, të cilit i besohen detyrat lidhur me sigurinë hekurudhore ose një organ, të cilit i besohen detyrat e sigurisë nga disa shtete, në mënyrë që të sigurohet një regjim i unifikuar i sigurisë hekurudhore.

7. “Autoriteti Rregullator Hekurudhor” është organi përgjegjës për rregullimin e transportit hekurudhor. Mënyra e organizimit, vendimet për financim, struktura ligjore dhe vendimmarrja e këtij autoriteti janë të pavarura nga çdo subjekt shtetëror apo privat, duke përfshirë aplikuesit për kapacitete të infrastrukturës, administruesit e infrastrukturës, organin që vendos tarifën apo organin që bën ndarjen e kapaciteteve infrastrukturore.

8. “Autorizimi i sigurisë” është një dokument që i jepet nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore organit apo kompanisë përgjegjëse në rolin e një administruesi të infrastrukturës, pasi ai ka realizuar ngritjen e sistemeve të administrimit të sigurisë (SMS) dhe i jep atij të drejtën të administrojë dhe të shfrytëzojë infrastrukturën hekurudhore.

9. “Brez i vijës hekurudhore” është toka në të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi minimale 5 metra, duke u nisur nga fundi i skarpatës së trasesë, kur nuk ka kanale, dhe nga fundi i kanaleve mbrojtëse dhe kulluese.

10. “Brez mbrojtës i vijës hekurudhore” është brezi i tokës nga të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi 100 metra, nisur nga ekstremi i jashtëm i brezit të vijës hekurudhore.

11. “Certifikatë e sigurisë” është një dokument i lëshuar nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore që dëshmon se sipërmarrësi hekurudhor ka krijuar sistemet e administrimit të sigurisë (SMS) dhe se ai është në gjendje për të vepruar në mënyrë të sigurt në zonën e kërkuar të operimit, me të cilin ky sipërmarrës përmbush kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) dhe kriteret e tjera ligjore mbi sigurinë hekurudhore në drejtim të kontrollit të rrezikut dhe ofrimit në mënyrë të sigurt të shërbimeve të transportit në rrjetin hekurudhor.

12. “Certifikatë e drejtuesit (makinistit) të trenit” është certifikata plotësuese e harmonizuar që tregon infrastrukturën, në të cilën zotëruesi i kësaj certifikate është i autorizuar të udhëtojë, dhe mjetin e transportit hekurudhor që zotëruesi është i autorizuar të drejtojë.

13. “Degëzim hekurudhor” është vija hekurudhore që lidh stacionin ose vijën hekurudhore



kryesore me vijat e brendshme hekurudhore, që ndodhen në territorin e subjektit shtetëror apo privat që kryen veprimtarinë hekurudhore.

14. “Deklaratë e rrjetit” është dokumenti që përcakton në mënyrë të detajuar rregullat e përgjithshme, afatet, procedurat dhe kriteret lidhur me sistemin e tarifimit, si dhe skemat e ndarjes së kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore. Ky dokument përmban gjithashtu informacionet e tjera të nevojshme për të mundësuar aplikimin për përdorim të infrastrukturës hekurudhore.

15. “Drejtuesi i trenit” (makinisti) është një person i aftë dhe i autorizuar për të drejtuar trenat, duke përfshirë lokomotivat e manovrimit, trenat e punës, mjetet hekurudhore të mirëmbajtjes ose trenat për transportin e udhëtarëve ose mallrave në vijat hekurudhore në mënyrë të pavarur, të përgjegjshme dhe të sigurt.

16. “Detyrim i shërbimit publik” është kërkesa e përkufizuar ose e përcaktuar nga një autoritet kompetent për të siguruar shërbimet e transportit publik të udhëtarëve në interes të përgjithshëm dhe që një sipërmarrës hekurudhor, duke pasur parasysh interesat e tij tregtarë, nuk do t’i merrte përsipër ose nuk do t’i merrte përsipër në të njëjtën masë ose në të njëjtat kushte pa kompensim.

17. “Grafik lëvizjeje ose orar i shërbimit” janë të dhënat që përcaktojnë lëvizjet e planifikuara të trenave dhe mjeteve hekurudhore, që do të kryhen në infrastrukturën hekurudhore gjatë një periudhe të përcaktuar.

18. “E drejtë ekskluzive” është e drejta që i jepet një operatori të shërbimit publik për të ofruar shërbimet e transportit publik të udhëtarëve në një vijë hekurudhore të caktuar, në një rrjet të veçantë ose në një zonë të caktuar, duke përjashtuar çdo operator tjetër të shërbimit publik.

19. “Hapësirë ajrore hekurudhore” është hapësira mbi linjën hekurudhore, në lartësi 12 metra nga niveli i kokës së shinës, në të gjithë gjerësinë e brezit të vijës hekurudhore, ndërsa në kryqëzimet me linjat elektrike mbi 220 kilovolt hapësira është 14 m.

20. “Hapësirë territoriale hekurudhore” është truall në pronësi të sektorit të transportit hekurudhor.

21. “Hapësirë nëntokësore hekurudhore” është hapësira nën linjën hekurudhore, deri në pikën që nuk cenohet siguria hekurudhore.

22. “Investigim” është një proces, i cili përfshin mbledhjen dhe analizën e informacionit, nxjerrjen e konkluzioneve, përfshirë përcaktimin e shkaqeve, si dhe, kur është e nevojshme, bërjen e rekomandimeve të sigurisë hekurudhore, me qëllim parandalimin e aksidentit apo incidentit.

23. “Investiguesi kryesor” është personi përgjegjës për organizimin, kryerjen dhe kontrollin e një investigimi për aksidentet dhe incidentet në hekurudhë.

24. “Incident” është një ngjarje tjetër përveç aksidentit apo aksidentit të rëndë, që prek sigurinë e operacioneve hekurudhore.

25. “Impiant shërbimi” është tërësia e objekteve, që përfshijnë truallin, ndërtesat dhe pajisjet, funksioni i të cilave posaçërisht, në tërësi ose pjesërisht, është për të lejuar një ose më shumë shërbime të përcaktuara në rregulloret përkatëse për impiantet e shërbimit.

26. “Infrastrukturë hekurudhore” është tërësia e vijave hekurudhore, degëzimeve hekurudhore, pajisjeve dhe instalimeve të ndërlidhjes, të sinjalizimit dhe pajimeve elektrike, stacioneve, të domosdoshme për qarkullimin e mjeteve hekurudhore dhe sigurinë e trafikut, drejtimi dhe administrimi i të cilave i është caktuar ligjërisht një administruesi të infrastrukturës.

27. “Infrastrukturë e mbingarkuar (e tejngopur)” është seksioni i infrastrukturës, për të cilin kërkesat për kapacitete të infrastrukturës nuk mund të plotësohen tërësisht gjatë disa periudhave të caktuara edhe pas koordinimit të kërkesave të ndryshme për kapacitete të infrastrukturës hekurudhore.

28. “Itinerari” është gjurma e trenit në një rrugëkalim.

29. “Kalim hekurudhor” është sipërfaqja ku vija hekurudhore ndërpritet në të njëjtin nivel me rrugën automobilistike.

30. “Nënkalinim dhe mbikalim hekurudhor” është ndërprerja e vijës hekurudhore jo në të njëjtin nivel me rrugën automobilistike.

31. “Kapacitet i infrastrukturës hekurudhore” është numri i mundshëm i rrugëkalimeve të trenit në një periudhë kohore për një segment të caktuar hekurudhor.

32. “Kërkesa thelbësore” janë kushtet që plotësohen nga sistemi hekurudhor, nënsistemet dhe përbërësit e ndërveprimit, përfshirë elementet bashkuese të nënsistemeve.



33. “Kontratë transporti” është një kontratë transporti kundrejt shpërblimit ose pa pagesë, mes një sipërmarrjeje hekurudhore ose një shitësi të biletave dhe pasagjerëve, për ofrimin e një ose më shumë shërbimeve të transportit. Bileta duhet të jetë në dukje prova për lidhjen dhe përmbajtjen e kontratës së transportit.

34. “Kusht teknik europian” është specifikimi i përbashkët teknik, kombëtar, europian ose ndërkombëtar.

35. “Kushtet teknike të ndërveprimit” (TSI) janë specifikimet e miratuara, me të cilat mbulohet çdo nënsistem ose pjesë e tij, me qëllim plotësimin e kërkesave thelbësore dhe për të siguruar ndërveprimin e sistemit hekurudhor.

36. “Licencë e sipërmarrësit hekurudhor” është leja e dhënë nga Autoriteti Licencues Hekurudhor për një sipërmarrës hekurudhor, me anë të së cilës konfirmohet aftësia e subjektit për të ofruar shërbime të transportit hekurudhor. Kjo licencë mund të jetë e kufizuar në ofrimin e llojeve të veçanta të shërbimeve.

37. “Licencë për administrimin e infrastrukturës hekurudhore” është dokumenti publik i lëshuar nga autoriteti kompetent, me anë të të cilit personi juridik ngarkohet për drejtimin dhe administrimin e infrastrukturës hekurudhore.

38. “Ministri” është ministri përgjegjës në fushën e transportit hekurudhor.

39. “Ministria” është ministria përgjegjëse që mbulon veprimtarinë e transporteve dhe ka fushë të veprimtarisë bashkërendimin e drejtimit e të kontrollit të veprimtarisë hekurudhore.

40. “Metodat e përbashkëta të sigurisë” (CSM) janë mënyrat e përshkrimit e të vlerësimit të niveleve të sigurisë dhe mënyrat e përmbushjes së treguesve të përbashkët të sigurisë (CSI) e të përputhjes me kërkesat e tjera të sigurisë hekurudhore.

41. “Mjet” është mjeti hekurudhor i përshtatshëm për qarkullim mbi rrotat e veta në vijat hekurudhore me ose pa tërheqje. Mjeti hekurudhor është i përbërë nga një ose më shumë nënsisteme strukturore dhe funksionale ose pjesë të këtyre nënsistemeve.

42. “Ndarje” është caktimi i kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore nga administruesi i infrastrukturës.

43. “Ndërveprim” është aftësia e sistemit hekurudhor për të lejuar lëvizjen e sigurt dhe të

pandërprerë të trenave që plotësojnë nivelet e kërkuara të performancës.

44. “Nënsistem” është rezultati i ndarjes së sistemit hekurudhor në nënsisteme të natyrës strukturore ose funksionale, për të cilat duhet të përcaktohen kërkesat thelbësore.

45. “Ngjarje” është çdo sjellje njerëzore (veprim apo mosveprim), e lidhur me shfrytëzimin e trenave dhe që ndikojnë në sigurinë e shfrytëzimit.

46. “Ngarkesë për aks” është pesha e mjetit hekurudhor bosh ose me ngarkesë, e shprehur në ton, pjesëtuar me numrin e akseve të tij.

47. “Objektivat e përbashkët të sigurisë” (CST) janë nivelet minimale të sigurisë që duhet të arrihen nga sistemi në tërësi e, aty ku është e mundur, nga pjesë të ndryshme të sistemit hekurudhor.

48. “Operator i shërbimeve publike” është transportuesi ose grup transportuesish shtetërorë ose privatë, që ofrojnë shërbime të transportit publik të udhëtarëve.

49. “Orar i lëvizjes së trenave” (grafik i lëvizjes së trenave) janë të dhënat që përcaktojnë të gjitha lëvizjet e programuara të trenave dhe të mjeteve lëvizëse në infrastrukturën hekurudhore, gjatë periudhës së vlefshmërisë së orarit të lëvizjes së trenave.

50. “Operator i impianteve të shërbimit” është çdo subjekt juridik, shtetëror ose privat, përgjegjës për administrimin e impianteve të shërbimit ose që u siguron shërbime sipërmarrësve hekurudhorë.

51. “Përbërësit e ndërveprimit” janë çdo përbërës elementar, grup përbërësish, disa pjesë ose një tërësi pjesësh të pajimeve të përfshira ose që synohen për t’u përfshirë në një nënsistem, nga të cilët varet direkt ose indirekt ndërveprimi i sistemit hekurudhor, përfshirë edhe objektet materiale dhe jomateriale.

52. “Plan i zgjerimit të kapaciteteve të infrastrukturës” është masa ose një seri masash të bashkuara në kalendarin e zbatimit për lehtësimin e kapaciteteve të infrastrukturës në seksionin e deklaruar si “infrastrukturë e mbingarkuar”.

53. “Projekt në një fazë të avancuar të zhvillimit” është projekti, planifikimi dhe ndërtimi i të cilit ka arritur nivelin, ku ndryshimi i specifikimeve teknike është i papranueshëm. Kjo pengesë mund të jetë e një natyre ligjore, kontraktore, ekonomike, financiare, sociale ose mjedisore dhe duhet të jetë e arsyetuar.



54. “Qendër formimi profesional” është një subjekt i akredituar ose i njohur nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore për realizimin e kurseve të formimit profesional.

55. “Rindërtim” është çdo punim i modifikimit të rëndësishëm mbi një nënsistem ose pjesë të nënsistemit, i cili rezulton në një ndryshim në dosjen teknike që shoqëron deklarin e verifikimit, nëse kjo ekziston, dhe i cili përmirëson performancën e përgjithshme të nënsistemit.

56. “Rinovim” është çdo punim i zëvendësimit të rëndësishëm mbi një nënsistem ose pjesë të nënsistemit, i cili nuk ndryshon performancën e përgjithshme të nënsistemit.

57. “Rregullat kombëtare të sigurisë” janë të gjitha rregullat e detyrueshme të miratuara, pavarësisht nga organi që i lëshon ato, që përmbajnë kërkesat e sigurisë hekurudhore apo kërkesat teknike, të ndryshme nga ato të përcaktuara nga BE-ja ose nga rregullat ndërkombëtare, të cilat janë të zbatueshme në Shqipëri për sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës ose palë të treta.

58. “Rrjet” janë linjat, stacionet, terminalët dhe të gjitha llojet e pajisjeve fikse, të nevojshme për të siguruar funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të sistemit hekurudhor.

59. “Rrugëkalim i trenit” është kapaciteti i infrastrukturës hekurudhore, i domosdoshëm për të qarkulluar një tren, ndërmjet dy vendeve në një moment të dhënë.

60. “Itinerar alternativ” është një tjetër itinerar mes të njëjtit vend të origjinës dhe të destinacionit ku ka zëvendësueshmëri mes dy itinerareve për operimin e shërbimit të mallrave ose të pasagjerëve që kryhen nga sipërmarrja hekurudhore.

61. “Komandë-kontroll-sinjalizim” (CCI) është tërësia e pajisjeve, aparaturave, programeve dhe protokolleve të aplikuara në sistemet e komandimit, komunikimit dhe transmetimit të informacioneve dhe të dhënave.

62. “Sistemet e administrimit të sigurisë” (SMS) janë organizimi, marrëveshjet dhe procedurat e krijuara nga një administrues i infrastrukturës hekurudhore apo një sipërmarrje hekurudhore për të siguruar administrimin e sigurt të operacioneve të veta.

63. “Sistem hekurudhor” është infrastruktura e përbërë nga linjat dhe instalimet fikse të rrjetit hekurudhor, si dhe mjetet hekurudhore të të gjitha

kategorive dhe origjinave që udhëtojnë në atë infrastrukturë.

64. “Sipërmarrës hekurudhor” është çdo subjekt publik apo privat, i licencuar sipas procedurave të këtij Kodi, dhe çdo sipërmarrje tjetër, publike apo private, aktiviteti i së cilës synon të sigurojë transportin e mallrave dhe/ose udhëtarëve me hekurudhë, mjaft që sipërmarrja të sigurojë tërheqjen (e mjeteve), përfshirë gjithashtu edhe sipërmarrjet që ofrojnë vetëm tërheqjen (e mjeteve hekurudhore).

65. “Standard i harmonizuar” është çdo standard evropian i miratuar mbi bazën e një kërkese të bërë nga BE-ja për zbatimin e legjislacionit evropian të harmonizuar.

66. “Transport hekurudhor” është një veprimtari që përfshin transportin e udhëtarëve dhe/ose mallrave, si dhe/ose tërheqjen e mjeteve hekurudhore.

67. “Transportues hekurudhor” është një ose më shumë sipërmarrës hekurudhorë, i cili/të cilët kanë lidhur kontratë transporti me udhëtarin/udhëtarët dhe të cilët bartin përgjegjësi në bazë të kësaj kontrate.

68. “Transportues zëvendësues” është transportuesi hekurudhor që nuk ka përfunduar kontratën e transportit me udhëtarin, por të cilit transportuesi hekurudhor, palë në kontratë, i ka besuar, në tërësi ose pjesërisht, kryerjen e transportit hekurudhor.

69. “Transport i kombinuar” është transporti intermodal, përshkimi kryesor i të cilit kryhet me hekurudhë, me linjat e brendshme ujore ose me transport detar dhe vetëm përshkimi fillestar dhe/ose fundor kryhet me transport rrugor, sa më shkurt të jetë e mundur.

70. “Territor hekurudhor” është sipërfaqja e veçuar e truallit ose e tokës, e destinuar për shfrytëzimin ose mbrojtjen e vijave hekurudhore, së bashku me ndërtimet, pajisjet dhe instalimet, që u shërbejnë transportit hekurudhor dhe stacionimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve hekurudhore.

71. “Transit” është kalimi ndërkufitar shtetëror i trenave, pa ngarkim/shkarkim të mallrave, pa hipje dhe zbritje të udhëtarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

72. “Tren” është vargu i formuar dhe i lidhur i vagonëve hekurudhorë, i tërhequr nga një ose disa mjete tërheqëse, që qarkullon në një segment. Një



lokomotivë që qarkullon e vetme gjithashtu konsiderohet si një tren.

73. “Tregues të përbashkët të sigurisë” (CSI) janë treguesit që vlerësojnë nivelin e arritur të sigurisë nëpërmjet indikatorëve të sigurisë dhe shërbejnë për ndërtimin e metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM).

74. “Vijë hekurudhore” është pjesa e infrastrukturës hekurudhore me elementet përbërëse të përcaktuara në këtë Kod, mbi të cilën realizohet qarkullimi i mjeteve hekurudhore.

Termtat e tjerë të përdorur, por të papërcaktuar në këtë Kod, kanë kuptimin e dispozitave ligjore të fushës përkatëse dhe në mungesë të tyre marrin kuptimin fillestar të fjalës ose të zakonit të vendit.

Neni 6 Subjektet

Subjektet në përputhje me këtë Kod janë:

- a) ministri përgjegjës për transportet;
- b) Autoriteti Rregullator Hekurudhor;
- c) Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore;
- ç) Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore;
- d) Autoriteti Licencues Hekurudhor;
- dh) administruesi i infrastrukturës,
- e) sipërmarrësit hekurudhorë;
- ë) operatorët e impianteve të shërbimeve;
- f) operatorët e shërbimit publik.
- g) udhëtarët hekurudhorë.

PJESA E DYTË ZHVILLIMI DHE ADMINISTRIMI I SISTEMIT HEKURUDHOR

KREU I ZHVILLIMI I SEKTORIT HEKURUDHOR

Seksioni 1 Pavarësia e administrimit

Neni 7

Pavarësia e sipërmarrjeve hekurudhore dhe administruesve të infrastrukturës

1. Sipërmarrësit hekurudhorë, në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë apo të kontrolluar nga ministria përgjegjëse për veprimtarinë e transportit, për sa i përket drejtimit, administrimit dhe kontrollit të brendshëm mbi çështjet administrative, ekonomike dhe të kontabilitetit, kanë status të pavarur, në përputhje të të cilit ata

mbajnë asetet e pronësisë, buxhetet dhe llogaritë, të ndara nga ato të ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë e transportit.

2. Duke respektuar rregullat mbi ndarjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe formatin e pagesave për përdorimin e tyre, sipas rregullave specifike të vendosura nga ky Kod, administruesi i infrastrukturës është përgjegjës për drejtimin, administrimin dhe kontrollin e brendshëm të kësaj infrastrukture.

Neni 8

Administrimi i sipërmarrësve hekurudhorë sipas parimeve tregtare

1. Sipërmarrësit hekurudhorë ushtrojnë aktivitetet e tyre duke iu përshtatur tregut dhe i administrojnë këto aktivitete nën përgjegjësinë e organeve të tyre drejtuese, në interes të ofrimit të shërbimeve efikase dhe të përshtatshme me kosto sa më të ulët që është e mundshme për cilësinë e shërbimit të kërkuar.

2. Sipërmarrësit hekurudhorë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtare në përputhje me parimet e legjislacionit shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare, pavarësisht nga pronësia e tyre. Kjo zbatohet edhe për detyrimet e shërbimit publik, të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për transportet dhe për kontratat e shërbimeve publike.

Seksioni 2

Ndarja e administrimit të infrastrukturës nga llojet e ndryshme të operacioneve të transportit në të

Neni 9

Ndarja e llogarive

1. Sipërmarrësit hekurudhorë, që kryejnë njëkohësisht edhe administrimin e infrastrukturës, edhe operacionet e transportit, fitimet dhe humbjet i mbajnë në llogari të ndara dhe bilancet e tyre publikohen, përkatësisht, për biznesin në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit, nga njëra anë, dhe për biznesin në lidhje me administrimin e infrastrukturës hekurudhore, nga ana tjetër.

Fondet publike që përfitojnë nga njëra prej dy fushave të veprimtarisë nuk transferohen në fushën tjetër.

2. Zbatimi i pikës 1, të këtij neni, kërkon që një sipërmarrës hekurudhor, që disponon njëkohësisht infrastrukturën dhe shërbimet e transportit, t'i



administrojë ato me njësi të ndara brenda së njëjtës sipërmarrje ose nga njësi krejt të veçanta.

3. Sipërmarrësit hekurudhorë, që kryejnë vetëm transportin hekurudhor, fitimet dhe humbjet, llogaritë e ndara dhe bilancet i mbajnë dhe i publikojnë të ndara, ato për ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor të mallrave nga ato që ofrojnë shërbimin e transportit të udhëtarëve.

Fondet publike të dhëna për aktivitetet që lidhen me ofrimin e shërbimeve të transportit si shërbim publik nuk transferohen në aktivitetet që lidhen me sigurimin e shërbimeve të tjera të transportit apo ndonjë biznesi tjetër.

4. Llogaritë për fusha të ndryshme të aktivitetit, të përmendura në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, mbahen të ndara në mënyrë që të lejohet kontrolli i tyre dhe ndalimi i transferimit të fondeve publike të paguara për njërin nga fushat e veprimtarisë në tjetrën, si dhe kontrolli i përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e përdorimit të infrastrukturës dhe tepricat nga aktivitetet e tjera tregtare.

Neni 10

Pavarësia e funksioneve kryesore të administruesit të infrastrukturës

1. Administruesi i infrastrukturës ushtron në mënyrë të pavarur funksionet kryesore rregullatore, si:

a) vendimmarrjen për ndarjen e rrugëkalimeve të trenit, përfshirë edhe përcaktimin e vlerësimit e disponueshmërisë, edhe ndarjen e rrugëkalimeve individuale të trenit;

b) marrjen e vendimeve për tarifatat e infrastrukturës, përfshirë edhe përcaktimin dhe mënyrën e mbledhjes së tyre, pa rënë ndesh me dispozitat e këtij Kodi.

2. Administruesi i infrastrukturës është përgjegjës për të siguruar kushte për një hyrje të barabartë dhe jodiskriminuese në infrastrukturë.

Ministria përgjegjëse për transportet ka përgjegjësinë për të kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore, përmes investimeve, mirëmbajtjes dhe financimit, në funksion të strategjisë së zhvillimit në këtë fushë.

Seksioni 3

Planifikimi i zhvillimit

Neni 11

Planifikimi i zhvillimit të infrastrukturës

1. Ministria përgjegjëse për transportet propozon për miratim në Këshillin e Ministrave strategjinë 5-vjeçare për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore.

2. Këshilli i Ministrave siguron që në strategjinë e zhvillimit të infrastrukturës, në kushte normale të biznesit, në llogaritë e fitimit dhe humbjes të një administruesi të infrastrukturës të balancohen të ardhurat nga tarifatat e infrastrukturës, të ardhurat nga subvencioni, të ardhurat nga aktivitetet e tjera tregtare, të ardhurat e pakthyeshme nga burime private dhe financimet shtetërore, nga njëra anë, me shpenzimet e infrastrukturës, në anën tjetër.

Neni 12

Transparenca e lehtësimit të borxheve

1. Këshilli i Ministrave ngre mekanizmin dhe përshtat politikat për të ndihmuar uljen e borxhit të sipërmarrjeve hekurudhore dhe/ose administruesit të infrastrukturës, në pronësi publike ose të kontrolluara, me synim përmirësimin e administrimit dhe gjendjes së tyre financiare.

2. Për qëllimet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, ngrihet një njësi e veçantë brenda departamentit të kontabilitetit të sipërmarrjeve hekurudhore dhe/ose administruesit të infrastrukturës për amortizimin e borxhit të krijuar.

Në bilancin e njësisë së borxhit pasqyrohen të gjitha kreditë e krijuara nga sipërmarrja hekurudhore dhe/ose administruesi i infrastrukturës, për të financuar investimet, si dhe për mbulimin e shpenzimeve operative për transportin hekurudhor apo nga administrimi i infrastrukturës hekurudhore, për aq kohë sa këto shpenzime mbeten të pambuluara. Borxhet që rrjedhin nga shërbimet ndihmëse apo të filialeve nuk merren parasysh.

3. Pikat 1 dhe 2, të këtij neni, aplikohen vetëm për borxhet, të shkaktuara në sipërmarrësit hekurudhorë dhe/ose administruesit e infrastrukturës me pronësi publike apo të kontrolluara, nga data e hapjes së tregut për të gjitha shërbimet e transportit hekurudhor dhe/ose administruesin e infrastrukturës nga hyrja në fuqi e këtij Kodi.



4. Ministria përgjegjëse për transportet merr përsipër rregullimin dhe administrimin e të gjitha borxheve të akumuluar në sistemin hekurudhor shqiptar deri në hyrjen në fuqi të këtij Kodi.

Seksioni 4

Aksesi në infrastrukturë dhe shërbime hekurudhore

Neni 13

Kushtet e qasjes në infrastrukturën hekurudhore

1. Sipërmarrësve hekurudhorë u jepet, në kushte të barabarta, jodiskriminuese dhe transparente, e drejta për qasje në infrastrukturën hekurudhore, për qëllimin e kryerjes së transportit të mallrave dhe/ose udhëtarëve me hekurudhë. Kjo e drejtë përfshin qasjen në infrastrukturën që lidh portet detare dhe pjesët e territorit në brendësi dhe të impianteve të tjera të shërbimeve, si:

- a) terminalët e mallrave;
- b) sheshet e formimit apo devijimit të trenit;
- c) vendet e magazinimit;

ç) impiantet e mirëmbajtjes, me përjashtim të objekteve të mirëmbajtjes dedikuar për trenat me shpejtësi të lartë ose të llojeve të tjera të mjeteve lëvizëse që kërkojnë impiante apo objekte të veçanta;

d) objektet apo impiantet teknike, përfshirë pastrimin dhe larjen e mjeteve hekurudhore;

dh) portet dhe objektet e territorit në brendësi, që janë të lidhura me veprimtaritë hekurudhore;

e) impiantet ndihmëse;

ë) impiantet apo objektet për rimbushje me karburant dhe furnizimit me karburant, çmimet për të cilat pasqyrohen në fatura shtesë.

2. Sipërmarrësit hekurudhorë të një shërbimi transporti vendas dhe ndërkombëtar të udhëtarëve kanë të drejtë të marrin dhe të zbresin udhëtarë në çdo stacion kryesor përgjatë itinerarit për zbritjen deri në stacionin e mbërritjes, ashtu siç përcaktohet në këtë Kod.

Kjo e drejtë përfshin dhe qasjen në infrastrukturën që lidh portet e aeroportet edhe në brendësi të impianteve të shërbimeve, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, si dhe në stacionet e udhëtarëve, ndërtesat e tyre e objekte të tjera, përfshirë edhe vendet e marrjes së informacionit të udhëtimit e të shërbimit të biletave të udhëtimit.

3. Zbatimi i paragrafit të parë, të pikës 2, të këtij neni, përcaktohet sipas kritereve të mosprishjes së ekuilibrit financiar të sipërmarrjeve hekurudhore që vepronë në treg, në rast të kundërt ndërhyjnë Autoriteti Rregullator Hekurudhor, sipas dispozitave të këtij Kodi.

Neni 14

Kufizimi i së drejtës për të marrë dhe për të zbritur udhëtarë

1. Kufizohet e drejta për akses, parashikuar në nenin 13, të këtij Kodi, për shërbimet ndërmjet vendit të nisjes dhe vendit të mbërritjes, kur kemi mbulim të segmentit nga një ose më shumë kontrata të shërbimeve publike, të cilat janë në përputhje me Kodin. Kufizimi i tillë nuk do të ketë efektin e kufizimit të së drejtës për të marrë dhe për të zbritur udhëtarë në çdo stacion që ndodhet përgjatë itinerarit të një shërbimi transporti ndërkombëtar, përgjatë territorit shqiptar, përveç kur ushtrimi i kësaj të drejte komprometon ekuilibrin ekonomik të një kontrate të shërbimit publik.

2. Rrezikimi i ekuilibrit ekonomiko-financiar të një kontrate të shërbimit publik përcaktohet nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor, në bazë të një analize objektive ekonomike dhe sipas kritereve të paracaktuara, pas një kërkesë të ndonjë prej subjekteve të mëposhtme:

a) autoritetit kompetent që jep kontratën e shërbimit publik dhe çdo autoriteti tjetër kompetent të lidhur me të drejtën për të kufizuar qasjen, sipas këtij neni;

b) administruesit të infrastrukturës;

c) sipërmarrjeve hekurudhore që zbatojnë kontratën e shërbimit publik;

ç) sipërmarrjeve hekurudhore që kërkojnë qasje në infrastrukturën hekurudhore.

Subjektet e sipërpërmendura i sigurojnë Autoritetit Rregullator Hekurudhor informacionin e nevojshëm për të marrë një vendim. Autoriteti Rregullator Hekurudhor merr parasysh informacionin e ofruar nga këto subjekte dhe, sipas rastit, kërkon informata shtesë dhe kryen konsultime me të gjitha palët e interesuara, brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës.

Autoriteti Rregullator Hekurudhor merr një vendim të arsyetuar brenda gjashtë javëve nga data e marrjes së gjithë informacionit përkatës.



3. Autoriteti Rregullator Hekurudhor jep arsyet për vendimin e tij dhe specifikon periudhën kohore, brenda së cilës, si dhe kushtet në të cilat ndonjë nga subjektet e mëposhtme mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit:

- a) autoriteti kompetent përkatës ose autoritetet kompetente;
- b) administruesi i infrastrukturës;
- c) sipërmarrësit hekurudhorë, të cilët zbatojnë kontratën e shërbimit publik;
- ç) sipërmarrësit hekurudhorë, të cilët kërkojnë akses në infrastrukturë.

4. Vendimet e përmendura në pikat 2 e 3, të këtij neni, janë objekt të shqyrtimit gjyqësor.

Neni 15

Aksesi në shërbime dhe impiante shërbimi

1. Administruesit e infrastrukturës u ofrojnë akses në infrastrukturë të gjithë sipërmarrësve hekurudhorë, në mënyrë jodiskriminuese, të drejtë dhe transparente, si paketë minimale të qasjes, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore, në zbatim të këtij Kodi.

2. Operatorët e impianteve të shërbimeve ndihmëse u ofrojnë të gjithë sipërmarrësve hekurudhorë, në një mënyrë jodiskriminuese, qasje në shërbimin e tërheqjes, akses për hyrje në linjat e në shërbimet ndihmëse, nëse ato ekzistojnë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

3. Operatori i impianteve të shërbimeve ndihmëse, i cili ndodhet nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të një entit apo subjekti që operon dhe ka një pozitë dominuese në tregun e shërbimeve të transportit hekurudhor kombëtar, duhet të jetë i pavarur në aspektin organizativ e të vendimmarrjes nga entit apo subjekti, nën kontrollin e të cilit ndodhet, në drejtim të garantimit të parimeve të një transparence të plotë dhe të mosdiskriminimit të impianteve të shërbimeve ndihmëse, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore, në zbatim të këtij Kodi.

4. Për të gjitha shërbimet ndihmëse, operatorët që i ofrojnë këto shërbime mbajnë llogari të veçanta, përfshirë bilancet dhe llogaritë e fitimit e të humbjes.

Kur impianti i shërbimit ndihmës dhe shërbimi i tij sigurohen nga administruesi i infrastrukturës ose kur operatori i shërbimit ndihmës është nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose të

tërthortë të administruesit të infrastrukturës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë pikë, ky shërbim përmbush kërkesat e përcaktuara në dispozitat e këtij Kodi.

5. Kur një operator i impiantit të shërbimit ndihmës ballafaqohet me konflikte, midis kërkesave të ndryshme, përpiqet t'i plotësojë këto kërkesa brenda një afati kohor të arsyeshëm, të caktuar nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor, sipas dispozitave të këtij Kodi. Në qoftë se nuk ka alternativë të mundshme në dispozicion dhe nuk është e mundur për të akomoduar të gjitha kërkesat për kapacitetin për impiantin apo objektin përkatës, në bazë të nevojave të demonstruara, aplikuesi ankohet tek Autoriteti Rregullator Hekurudhor, sipas dispozitave të këtij Kodi, i cili ekzaminon rastin dhe merr masa, kur është e nevojshme, për të siguruar që një pjesë e përshtatshme e kapacitetit t'i jepet atij aplikuesi.

6. Kur një impiant i shërbimit ndihmës nuk ka qenë në përdorim për të paktën dy vjet rresht dhe interesi nga sipërmarrësit hekurudhorë për qasje në këtë impiant apo objekt është shprehur, operatori pronar i këtij shërbimi, impiant shërbimi, publikon funksionimin e impiantit për dhënien me qira si një strukturë të shërbimit hekurudhor, si një e tërë ose pjesërisht, për të mos krijuar pengesë të përdorimit të tij në rast kërkesë për përdorim.

7. Operatori i impiantit të shërbimit ndihmës ofron në mënyrë jodiskriminuese gjithashtu ndonjë nga shërbimet shtesë, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, në zbatim të këtij Kodi.

8. Shërbimet ndihmëse përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Seksioni 5

Marrëveshjet ndërkuftare

Neni 16

Parimet e përgjithshme për marrëveshjet ndërkuftare

1. Dispozitat e përfshira në marrëveshjet ndërkuftare (marrëveshjet rajonale ndërqeveritare) nuk diskriminojnë sipërmarrësit hekurudhorë vendas apo nuk kufizojnë lirinë e veprimit të tyre për të përfutur shërbime ndërkuftare.

2. Të gjitha subjektet, të përcaktuara sipas këtij Kodi, njohin dhe zbatojnë të gjitha marrëveshjet ndërkuftare (ndërqeveritare) të arritura përpara se ky Kod të hyjë në fuqi.



3. Nëse marrëveshjet ndërkufitare bien ndesh me parimet e mosdiskriminimit dhe të transparencës, të pasqyruara në këtë Kod, subjektet e prekura kanë të drejtë t'u drejtohen autoriteteve kompetente për rinegociim të marrëveshjes.

4. Autoritetet kompetente marrin në shqyrtim këtë kërkesë dhe japin përgjigjen e tyre të arsyetuar për vendimin që marrin.

KREU II LICENCIMI I SIPËRMARRËSIT HEKURUDHOR

Seksioni 1 Autoriteti licencues

Neni 17

Autoriteti Licencues Hekurudhor

1. Autoriteti Licencues Hekurudhor krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Autoriteti Licencues Hekurudhor nuk ofron vetë shërbime të transportit hekurudhor dhe është i pavarur nga subjektet që njihen me statusin e sipërmarrësit hekurudhor.

Seksioni 2 Kushtet për marrjen e licencës

Neni 18

Kërkesa të përgjithshme

1. Sipërmarrësi hekurudhor ka të drejtë të aplikojë për licencë për ofrim shërbimesh në hekurudhë në Autoritetin Licencues Hekurudhor.

2. Autoriteti Licencues Hekurudhor lëshon licenca ose zgjat vlefshmërinë e tyre, në përputhje me parashikimet e këtij kreu.

3. Një sipërmarrës hekurudhor, që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë kre, autorizohet nga Autoriteti Licencues Hekurudhor për të marrë një licencë.

4. Asnjë sipërmarrës hekurudhor nuk lejohet të ofrojë shërbime të transportit hekurudhor, të mbuluara nga ky kre, nëse nuk është pajisur me licencën përkatëse për shërbimet që ofrohen.

Pavarësisht sa më lart, vetëm zotërimi i një licence nuk i jep të drejtën zotëruesit të saj të ketë qasje në infrastrukturën hekurudhore.

Neni 19

Kushtet për marrjen e licencës

1. Sipërmarrësit hekurudhorë përmbushin në çdo kohë, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi,

kërkesat e mëposhtme për pajisjen me licencë, në lidhje me:

- a) reputacionin e mirë;
- b) përshtatshmërinë financiare;
- c) kompetencën profesionale;
- ç) mbulimin e përgjegjësive civile.

2. Çdo sipërmarrës hekurudhor, i cili aplikon për licencë, ofron gjithë informacionin e duhur në lidhje me përmbushjen e kërkesave të sipërpërmendura.

Neni 20

Kërkesa në lidhje me reputacionin e mirë

Sipërmarrësit hekurudhorë dhe përfaqësuesit e tyre duhet të vërtetojnë se:

- a) nuk kanë qenë të dënuar më parë për vepra penale, përfshirë ato të një natyre tregtare;
- b) nuk kanë shpallur falimentin;
- c) nuk kanë qenë të dënuar për kundërvajtje të rënda, të parashikuara në legjislacionin në fuqi;
- ç) nuk kanë qenë të dënuar më parë për mospërmbushje të detyrimeve tatimore, doganore, mosshlyerjen e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 21

Kërkesa në lidhje me përshtatshmërinë financiare

1. Sipërmarrësit hekurudhorë dhe përfaqësuesit e tyre duhet të vërtetojnë se përmbushin kriteret e përshtatshmërisë financiare.

2. Autoriteti Licencues Hekurudhor verifikon përshtatshmërinë financiare, veçanërisht me anë të llogarive vjetore të sipërmarrjeve hekurudhore ose, në rastin e sipërmarrësve që aplikojnë për licencë, të cilat nuk janë në gjendje të paraqesin llogaritë vjetore, me anë të një bilanci aktual.

Çdo sipërmarrës hekurudhor, që aplikon për licencë, depoziton pranë Autoritetit Licencues Hekurudhor informacionin për:

- a) fondet në dispozicion për realizmin e aktivitetit, për të cilin kërkohet të pajiset me licencë, përfshirë bilancin bankar, kredi/hua bankare me kontratë;
- b) fondet dhe asetet e trupëzuara, të vendosura si garanci;
- c) fonde për mbulimin e shpenzimeve të blerjes së mjeteve, tokës, ndërtesave, instalimeve dhe inventarëve;



ç) fondet për mbulimin e tarifave për përdorimin e aseteve të ofruara;

d) informacionin për kapitalin që subjekti që aplikon për licencë ka në dispozicion për të kryer aktivitetin (nga i cili është zbritur shuma e detyrimeve që mund të ketë ky subjekt ndaj të tretëve);

dh) shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

3. Autoriteti Licencues Hekurudhor refuzon dhënien e licencës nëse vërtetohet se sipërmarrësi hekurudhor, që aplikon për licencë, ka pagesa të prapambetura të taksave, tatimeve ose sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

4. Autoriteti Licencues Hekurudhor kërkon dorëzimin e një raporti auditimi, të përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, dhe dokumente të tjera mbështetëse. Këto dokumente përmbajnë informacionin e shënuar në pikën 2 të këtij neni.

5. Për përcaktimin e vlerës së nevojshme, sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 2, të këtij neni, Autoriteti Licencues Hekurudhor merr deklaratën përkatëse në lidhje me aktivitetin e kërkuar për licencim.

Neni 22

Kërkesa në lidhje me aftësinë profesionale

1. Sipërmarrësit hekurudhorë dhe përfaqësuesit e tyre duhet të vërtetojnë se përmbushin kërkesat mbi aftësinë profesionale dhe se e demonstrojnë me anë të njohurive, përvojës së nevojshme për të ushtruar kontroll të sigurt, të besueshëm për aktivitetet e specifikuar në licencën e kërkuar.

2. Vërtetimi i aftësisë profesionale të sipërmarrësve hekurudhorë bëhet nëpërmjet pajisjes me certifikatat dhe autorizimet përkatëse për sigurinë hekurudhore që lëshohen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

Neni 23

Kërkesa në lidhje me mbulimin e përgjegjësive civile

1. Sipërmarrësit hekurudhorë ofrojnë garanci për mbulimin e përgjegjësive të tyre civile në rast aksidenti dhe incidenti në hekurudhë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Pavarësisht nga ky detyrim, mund të merren parasysh veçantitë dhe rreziqet, sipas llojeve të

ndryshme të shërbimeve dhe në veçanti në operacione hekurudhore për qëllime të trashëgimisë kulturore.

Seksioni 3

Vlefshmëria e licencës

Neni 24

Vlefshmëria territoriale dhe kohore e licencës

1. Licenca është e vlefshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në shtetet, për të cilat parashikohet në marrëveshjet ndërqeveritare.

2. Licenca është e vlefshme për aq kohë sa sipërmarrësit hekurudhorë përmbushin detyrimet e përcaktuara në këtë kre.

Neni 25

Licenca e përkohshme, miratimi, pezullimi dhe revokimi

1. Autoriteti Licencues Hekurudhor, në rast dyshimesh serioze për mospërmbushje të kriterëve të licencimit, të përcaktuara në këtë kre, ushtron kontrollon mbi sipërmarrësit hekurudhorë.

2. Autoriteti Licencues Hekurudhor u pezullon ose u revokon licencën e dhënë sipërmarrësve hekurudhorë, kur vërtetohet mospërmbushja e kërkesave të licencimit.

3. Pavarësisht nga pika 2, e këtij neni, kur licenca është pezulluar ose revokuar, për shkak të mospërputhjes me kërkesat për përshtatshmërinë financiare, Autoriteti Licencues Hekurudhor mund të japë një licencë të përkohshme në pritje të riorganizimit dhe plotësimit të kriterëve për licencim nga sipërmarrjet hekurudhore, me kusht që të mos jetë rrezikuar siguria hekurudhore.

Licenca e përkohshme lëshohet për një afat jo më shumë se gjashtë muaj nga data e lëshimit të saj.

4. Kur një sipërmarrës hekurudhor ka pushuar aktivitetin për gjashtë muaj apo nuk ka filluar veprimtarinë brenda gjashtë muajve nga data e marrjes së licencës, Autoriteti Licencues Hekurudhor vendos që aplikuesi të ridepozitojë kërkesën për miratim licencimi, në rast të kundërt ky autoritet ia pezullon licencën.

5. Në rast të një ndryshimi që prek formën ligjore të një subjekti që aplikon për licencim, në veçanti, në rast të bashkimit ose ndarjes së subjektit, Autoriteti Licencues Hekurudhor vendos



që kërkesa për licencim të paraqitet përsëri për miratim. Subjektet në fjalë kanë të drejtë të vazhdojnë veprimtarinë e tyre tregtare, vetëm nëse vërtetohet nga Autoriteti Licencues Hekurudhor se ndryshimi i formës ligjore të organizimit të sipërmarrësve hekurudhorë nuk prek asnjë nga kriteret e përcaktuara dhe të përmbushura në momentin e marrjes së licencës, me përjashtim të rastit kur ky Autoritet konstaton shkeljen e kriterëve të sigurisë hekurudhore dhe vendos pezullimin e licencës me akt të arsyetuar.

6. Sipërmarrësit hekurudhorë, të cilët kanë për qëllim të ndryshojnë ose të zgjerojnë aktivitetin e tyre tregtar, paraqesin licencën pranë Autoritetit Licencues Hekurudhor për rishqyrtim.

7. Autoriteti Licencues Hekurudhor revokon licencën e subjektit hekurudhor të licencuar, ndaj të cilit kanë filluar procedurat e falimentimit, në qoftë se ky autoritet është i bindur se nuk ka perspektivë realiste për ristrukturimin e kënaqshëm financiar brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

8. Kur Autoriteti Licencues Hekurudhor, për një arsye të caktuar, pezullon, anulon apo ndryshon një licencë, ai menjëherë informon Agjencinë e Bashkimit European për Hekurudhat.

Neni 26

Procedura për dhënien e licencave

1. Në zbatimin e këtij Kodi, posaçërisht seksionit 2, të këtij kreu, Autoriteti Licencues Hekurudhor miraton dhe publikon procedurat për dhënien e licencave.

2. Autoriteti Licencues Hekurudhor merr vendim sa më shpejt të jetë e mundur për kërkesat për t'u pajisur me licencë, të depozituara nga sipërmarrësit hekurudhorë, por jo më shumë se një afat tremujor pas plotësimit të të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë kre.

3. Refuzimi i Autoritetit Licencues Hekurudhor për të pajisur me licencë subjektet, sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij neni, duhet të jetë i arsyetuar.

4. Vendimet e Autoritetit Licencues Hekurudhor i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.

KREU III VENDOSJA E ÇMIMEVE PËR SHFRYTËZIM DHE NDARJA E KAPACITETEVE TË INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Seksioni 1 Parime të përgjithshme

Neni 27

Shfrytëzimi efektiv i kapacitetit të infrastrukturës

Administruesi i infrastrukturës zbaton skemat më optimale të ndarjes dhe të përdorimit (shfrytëzimit) të saj, të cilat bazohen në parimet e përcaktuara në këtë Kod, për të realizuar një shfrytëzim optimal efektiv dhe me kosto sa më të ulët.

Neni 28

Deklarata e rrjetit

1. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore, pas konsultimit me palët e interesuara, harton dhe publikon “Deklaratën e rrjetit”, e cila, përveç gjuhës shqipe, duhet të botohet edhe në dy prej gjuhëve të Bashkimit European. Përmbajtja e “Deklaratës së rrjetit” publikohet pa pagesë edhe në format elektronik në faqen zyrtare të internetit të administruesit të infrastrukturës.

1.1. “Deklarata e rrjetit” përcakton natyrën e infrastrukturës që është e disponueshme për sipërmarrësit hekurudhorë dhe përmban të dhëna që përcaktojnë kushtet për të drejtën e qasjes në infrastrukturën përkatëse hekurudhore.

1.2. “Deklarata e rrjetit” përmban të dhëna që përcaktojnë kushtet për të drejtën e hyrjes në impiantet e shërbimit të lidhur në rrjetin e administruesit të infrastrukturës dhe të shfrytëzimit të shërbimeve lehtësuese nga këto impiante.

1.3. “Deklarata e rrjetit” mbahet e përditësuar dhe ndryshohet sipas nevojës.

1.4. “Deklarata e rrjetit” publikohet jo më pak se katër muaj para afatit për kërkesat për kapacitet infrastrukturor.

2. “Deklarata e rrjetit” përmban informacionin e mëposhtëm:

2.1. Një seksion që përcakton natyrën e infrastrukturës që është në dispozicion për sipërmarrësit hekurudhorë dhe kushtet e qasjes në këtë infrastrukturë. Informacioni bëhet në



përputhje me regjistrin e infrastrukturës hekurudhore dhe përditësohet çdo vit.

2.2. Një seksion mbi tarifatat e shërbimit dhe parimet e zbatimit të tyre. Ky seksion përmban skemën e përcaktimit të tarifës së shërbimit, si dhe informacion të mjaftueshëm për të gjitha shërbimet e ofruara dhe pagesat për to, të listuara në dispozitat e këtij Kodi, me shtjellimin e kushteve të qasjes në infrastrukturë dhe në shërbimet ndihmëse. Këtu parashtrohen edhe tarifatat që parashikohen të ndryshojnë për pesë vitet e ardhshme, metodologjia, rregullat që përdoren për zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me parimet, zbatimin dhe përjashtimin nga tarifatat për ofrim shërbimesh apo përdorim të infrastrukturës.

2.3. Një seksion mbi parimet dhe kriteret për ndarjen e kapaciteteve. Ky seksion përcakton karakteristikat e kapaciteteve të përgjithshme të infrastrukturës që është në dispozicion për sipërmarrësit hekurudhorë dhe çdo kufizim në lidhje me përdorimin e saj, duke përfshirë edhe kërkesat për kapacitete të mundshme për mirëmbajtje. Këtu specifikohen procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procesin e ndarjes së kapaciteteve, të cilat përmbajnë kriteret specifike e në mënyrë të veçantë:

a) procedurat, sipas të cilave aplikuesit mund të kërkojnë kapacitet nga administruesi i infrastrukturës;

b) kërkesat që duhet të plotësojnë aplikuesit;

c) koha për proceset e aplikimit dhe të ndarjes së kapacitetit, procedurat për përfitim të informacionit mbi planifikimin e mirëmbajtjes të programuar ose jo;

ç) rregullat për procesin e koordinimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si pjesë e këtij procesi;

d) procedurat që duhet të ndiqen dhe kriteret e përdorura për ndarje kapacitetesh kur infrastruktura është e tejnëgjatë;

dh) detajet mbi kufizimet për përdorimin e infrastrukturës;

e) kushtet që marrin parasysh nivelet e mëparshme të shfrytëzimit të kapaciteteve në përcaktimin e prioriteteve për ndarje të këtyre kapaciteteve.

2.4. Administruesi i infrastrukturës publikon informacion të detajuar rreth procedurave të ndarjes së kapaciteteve për një itinerar hekurudhor ndërkombëtar.

2.5. Një seksion me informacion në lidhje me aplikimin për licencë, sipas dispozitave të këtij Kodi.

2.6. Një seksion me informacion udhëzues për parimet bazë të sistemit të përmirësimit të parametrave tekniko-shfrytëzues, sipas dispozitave të këtij Kodi.

2.7. Një seksion për informacion mbi aksesin (qasjen në infrastrukturë) dhe pagesat për përdorim dhe ofrim shërbimi, sipas dispozitave të këtij Kodi.

2.8. Operatorët e impianteve të shërbimit, të cilët nuk janë të kontrolluar nga administruesi i infrastrukturës, ofrojnë informacion mbi tarifatat për qasje në impiant dhe për ofrimin e shërbimeve, si dhe informacion mbi kushtet teknike të qasjes që duhet të përfshihen në “Deklaratën e rjetit”, ose të tregojnë një faqe interneti, ku ky informacion është vënë në dispozicion falas në format elektronik.

2.9. Një marrëveshje model për përfundimin e marrëveshjeve kuadër mes një administruesi të infrastrukturës dhe një kërkuesi (aplikuesi), e cila ruan formën dhe përditësohet sipas formateve të dhëna dhe të përdorura në BE.

Neni 29

Marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve hekurudhore dhe administruesve të infrastrukturës

1. Çdo sipërmarrës hekurudhor i angazhuar për të ofruar shërbime në fushën e transportit hekurudhor lidh marrëveshjet e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, në sektorin shtetëror ose privat me administruesit e infrastrukturës hekurudhore në përdorim.

2. Kushtet e vendosura në këto marrëveshje janë në përputhje me kërkesat për mosdiskriminim dhe transparencë, të rregulluara në këtë Kod.

Seksioni 2

Sistemi i tarifave të infrastrukturës dhe shërbimeve hekurudhore

Neni 30

Përcaktimi dhe arkëtimi i tarifave

1. Skema e tarifave të përdorimit të infrastrukturës hekurudhore, që zbatohet ndaj të gjithë kërkuesve të kapaciteteve infrastrukturore hekurudhore, përcaktohet dhe miratohet nga ministria përgjegjëse për transportin, në bashkëpunim me autoritetet kompetente në vend,



brenda një afati kohor, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të këtij Kodi. Skema dhe rregullat e tarifave publikohen në “Deklaratën e rrjetit”, si dhe në faqen zyrtare të internetit të administruesve të infrastrukturës hekurudhore.

2. Në skemën e tarifave, hartuar sipas dispozitave në zbatim të këtij Kodi, administruesi i infrastrukturës hekurudhore përcakton dhe arkëton tarifën përkatëse për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore.

3. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore garanton zbatimin e skemës së tarifimit mbi të njëjtat parime në të gjithë rrjetin që administron, përveç rasteve të trajtuara nga neni 33 i këtij Kodi.

4. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore zbaton të njëjtën skemë tarifuese për shërbime apo përdorime të segmenteve të njëjta për sipërmarrës të ndryshëm hekurudhorë që kryejnë aktivitete tregtare të ngjashme dhe tarifën që zbatohen përputhen me rregullat e vendosura në “Deklaratën e rrjetit”.

5. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore respekton fshehtësinë e informacionit tregtar të vënë në dispozicion nga kërkuesit e kapaciteteve infrastrukturore hekurudhore.

Neni 31

Kostot dhe llogaritë e infrastrukturës

1. Administruesit e infrastrukturës, duke marrë parasysh sigurinë dhe për të ruajtur e përmirësuar cilësinë e shërbimit të infrastrukturës, stimulohen për të zvogëluar koston e sigurimit të infrastrukturës dhe nivelin e tarifave të qasjes në të.

2. Pa rënë ndesh me kompetencat e tyre në lidhje me planifikimin e infrastrukturës hekurudhore dhe financimin dhe në përputhje me parimet buxhetore, autoriteti kompetent nënshkruan një marrëveshje kontraktore për një periudhë prej jo më pak se pesë vjetësh.

Marrëveshja kontraktore specifikohet sipas përcaktimeve të këtij neni dhe përfshin elementet e mëposhtme:

a) qëllimin e marrëveshjes sa u përket infrastrukturës dhe shërbimeve të impianteve, të strukturuar në përputhje me nenet 13 dhe 15 të këtij Kodi. Ajo mbulon të gjitha aspektet e administrimit të infrastrukturës, përfshirë mirëmbajtjen dhe ripërtëritjen e infrastrukturës tashmë në veprim. Kur është e përshtatshme, mbulohet dhe ndërtimi i infrastrukturës së re;

b) strukturën e pagesave apo fondeve të dhëna për shërbimet e infrastrukturës, të renditura në nenet 13 dhe 15, të këtij Kodi, për mirëmbajtje e rinovim, duke i ndarë nga mirëmbajtja e zakonshme apo rinovimet e prapambetura. Synohet të mbulohet struktura e pagesave apo fondeve për infrastrukturë të re;

c) objektivat e përdorshëm të parametrave tekniko-shfrytëzues, në formën e treguesve dhe kritereve të cilësisë që mbulojnë elemente të tilla, si:

i) performancën e trenit, në aspektin e shpejtësisë në linjë, besueshmërisë dhe kënaqjes së konsumatorëve;

ii) kapacitetin e rrjetit;

iii) administrimin e aseteve;

iv) volumet e aktiviteteve;

v) nivelet e sigurisë hekurudhore;

vi) mbrojtjen e mjedisit;

ç) sasinë e lëndëve apo aseteve të grumbulluara, të mundshme për mirëmbajtje, dhe asetet që duhet të dalin jashtë përdorimit;

d) stimujt e referuar në pikën 1, të këtij neni, me përjashtim të atyre stimujve të zbatuar nëpërmjet masave rregullatore, në përputhje me pikën 3 të këtij neni;

dh) detyrimet minimale mbi raportimin e administruesit të infrastrukturës, shpeshtësinë e raportimit, përfshirë informacionin që do të publikohet çdo vit;

e) kohëzgjatjen e marrëveshjes, e cila të jetë në përputhje me kohëzgjatjen e administrimit të infrastrukturës, planit të biznesit, koncesionit apo licencës, sipas rastit, dhe kuadrit tarifues dhe rregullave të tjera në zbatim të legjislacionit në fuqi;

ë) rregullat për trajtimin e ndërprerjeve të mëdha gjatë operacioneve në situata të emergjencës, përfshirë planet e emergjencës dhe ndërprerjet e marrëveshjeve kontraktore, dhe informacionin në kohë për përdoruesit;

f) masat korrigjuese që duhen marrë, nëse secila prej palëve kryen shkelje të detyrimeve të saj kontraktore ose në rrethana të jashtëzakonshme që ndikojnë në vënien në dispozicion të fondeve publike. Kjo përfshin kushtet dhe procedurat e rinegociimit përpara përfundimit të marrëveshjes.

3. Autoriteti kompetent zbaton stimujt e përmendur në pikën 1, të këtij neni, me anë të marrëveshjes së përmendur në pikën 2, të këtij neni, nëpërmjet masave rregullatore, sipas legjislacionit në fuqi.



4. Zbatimi i stimujve të përmendur në pikën 1, të këtij neni, nëpërmjet masave rregullatore, bazohet në një analizë të reduktimit të kostos së arritshme. Kjo bëhet pa cenuar kompetencat e Autoritetit Rregullator Hekurudhor për të shqyrtuar kostot.

5. Kushtet e marrëveshjes kontraktore, të përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe struktura e pagesave, për të cilën është rënë dakord për të siguruar fonde për administrimin e infrastrukturës, bëhen për të mbuluar tërë periudhën e kontratës.

6. Autoriteti kompetent siguron që aplikuesit dhe aplikuesit e mundshëm të informohen nga organi kompetent dhe administruesi i infrastrukturës për t'u dhënë mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi përmbajtjen e marrëveshjes para se të nënshkruhet. Marrëveshja kontraktore publikohet brenda një muaji pas nënshkrimit.

Administruesi i infrastrukturës garanton qëndrueshmëri ndërmjet dispozitave të marrëveshjes kontraktore dhe planit të tij të biznesit.

7. Administruesi i infrastrukturës mban një regjistër të pasurisë së tij dhe të pasurive që ai administron për të vlerësuar financimin e nevojshëm për rindërtimin ose rinovimin e pasurive të tij. Kjo shoqërohet me detajet e shpenzimeve mbi rinovimin dhe përmirësimin e infrastrukturës.

8. Administruesi i infrastrukturës harton një metodë për shpërndarjen e kostove për kategoritë e ndryshme të shërbimeve të ofruara për sipërmarrësit hekurudhorë, të cilën e miraton paraprakisht autoriteti kompetent. Kjo metodë përditësohet herë pas here në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare.

Neni 32

Parimet e tarifimit

1. Tarifat për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore dhe të impianteve të shërbimit i paguhen administruesit të infrastrukturës dhe operatorit të impiantit të shërbimit.

2. Administruesi i infrastrukturës dhe operatorët e impianteve të shërbimit lejojnë Autoritetin Rregullator Hekurudhor të kryejë funksionet e veta, sipas përcaktimit të nenit 55, të këtij Kodi, duke u ofruar të gjithë informacionin që u kërkohet. Administruesi i infrastrukturës dhe operatorët e

impianteve të shërbimit në këtë drejtim tregojnë se tarifat e shërbimit, të faturuara për sipërmarrësit hekurudhorë, janë në përputhje me të gjitha metodologjitë dhe rregullat e shtjelluara në këtë seksion.

3. Pa cenuar pikat 4 ose 5, të këtij neni, dhe nenin 33, të këtij Kodi, tarifat për paketën minimale të qasjes në infrastrukturë që lidhen me impiantet e shërbimeve përcaktohen mbi koston e drejtpërdrejtë që shkaktohet si rezultat i operimit të shërbimit të trenit.

Në përputhje me përcaktimet ndërkombëtare në këtë fushë, të strukturimit të kostos, hartohen modalitete nga administruesi i infrastrukturës për llogaritjen e kostos së drejtpërdrejtë që shkaktohet si rezultat i operimit të trenit. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor.

Administruesi i infrastrukturës përshtat gradualisht këto modalitete gjatë një periudhe jo më shumë se katër vjet pas hyrjes në fuqi të këtyre akteve zbatuese.

4. Tarifat e infrastrukturës së referuar në pikën 3, të këtij neni, përfshijnë një tarifë, e cila pasqyron mungesën e kapacitetit të seksionit të identifikueshëm të infrastrukturës gjatë periudhave të tejngopura (ngjeshura).

5. Tarifat e infrastrukturës së referuar në pikën 3, të këtij neni, ndryshohen për të marrë parasysh koston e efekteve mjedisore të shkaktuara nga operimi i trenit. Çdo ndryshim i tillë diferencohet në bazë të madhësisë së efektit të shkaktuar.

Nëse tarifa e kostove mjedisore rezulton në rritje të të ardhurave të përgjithshme për administruesin e infrastrukturës, lejohet të aplikohet vetëm në qoftë se kjo tarifë zbatohet edhe për transportin rrugor të mallrave.

6. Tarifat për qasje brenda impianteve të shërbimit, të përcaktuara në nenin 15, të këtij Kodi, dhe ofrimi i shërbimeve në impiante të tilla nuk tejkalojnë koston direkte, plus një fitim të arsyeshëm.

7. Kur shërbimet e renditura në pikat 3 dhe 4, të nenit 15, të këtij Kodi, si shërbime shtesë dhe shërbime ndihmëse janë ofruar vetëm nga një furnizues, tarifa e imponuar për një shërbim të tillë nuk tejkalon koston direkte, plus një fitim të arsyeshëm.

8. Pagesat vendosen për kapacitetin e përdorur për qëllime të mirëmbajtjes së infrastrukturës.



Tarifa të tilla nuk tejkalojnë humbjen e të ardhurave neto që administruesit të infrastrukturës i shkaktohet nga mirëmbajtja.

9. Operatori i impianteve për furnizimin e shërbimeve të përmendura në nenin 15, të këtij Kodi, e informon administruesin e infrastrukturës mbi tarifën që t'i përfshijë në “Deklaratën e rrejtë”, në përputhje me nenin 28, pika 2.8, të këtij Kodi.

Neni 33

Përfshirjet për parimet e tarifimit

1. Për mbulimin e plotë të shpenzimeve të bëra nga administruesi i infrastrukturës dhe nëse tregu mund të përballojë, vendoset një tarifë shtesë, në bazë të parimeve efikase, transparente dhe jodiskriminuese, duke garantuar konkurrencën optimale të segmentit të tregut hekurudhor. Kjo rritje pagese do ta respektojë rritjen e produktivitetit të arritur nga sipërmarrësit hekurudhorë.

1.1. Niveli i tarifave nuk përjashton përdorimin e infrastrukturës nga segmentet e tregut që paguajnë të paktën koston e drejtpërdrejtë, si rezultat i operimit të shërbimit hekurudhor, plus një normë kthimi që tregu e përballon.

1.2. Para miratimit të një tarife të tillë, administruesi i infrastrukturës vlerëson së pari rëndësinë e segmenteve të caktuara si prioritare në treg, si:

- a) shërbimet për udhëtarë kundrejt shërbimeve të mallrave;
- b) trenat që transportojnë mallra të rrezikshme kundrejt trenave të tjerë të mallrave;
- c) shërbimi i brendshëm kundrejt shërbimeve ndërkombëtare;
- ç) transporti i kombinuar kundrejt trenave të drejtpërdrejtë;
- d) transporti urban apo rajonal kundrejt shërbimeve ndërqytetëse të udhëtarëve;
- dh) bllok trenash kundrejt trenave me ngarkesë apo me pak vagonë;
- e) treni i rregullt kundrejt shërbimeve të rastit të trenit.

1.3. Lista e segmenteve të tregut të përcaktuar nga administruesit e infrastrukturës përmban së paku tri segmente: atë të shërbimit të mallrave, shërbimit të udhëtarëve, në kuadër të një kontrate të shërbimit publik, dhe shërbime të tjera të udhëtarëve.

1.4. Administruesit e infrastrukturës bëjnë

dallimin për segmentet e tregut, sipas mallit apo udhëtarëve të transportuar.

1.5. Segmentet e tregut, në të cilin sipërmarrësit hekurudhorë nuk veprojnë aktualisht, por mund të rasisë që të ofrojnë shërbime gjatë periudhës së vlefshmërisë së sistemit të pagesave, sipas pikës 1, të këtij neni, administruesi i infrastrukturës nuk i përfshin në shtesën e tarifimit për këto segmente të tregut.

1.6. Lista e segmenteve të tregut publikohet në “Deklaratën e rrejtë” dhe rishikohet të paktën çdo pesë vjet. Autoriteti Rregullator Hekurudhor e kontrollon listën e segmenteve të tregut, në përputhje me nenin 55 të këtij Kodi.

2. Për projektet specifike të ardhshme të investimeve, administruesi i infrastrukturës përcakton tarifa më të larta, në bazë të kostove afatgjata të projekteve të tilla. Një rregullim i tillë i tarifës përfshin marrëveshje mbi ndarjen e rrezikut të lidhur me investimet e reja.

3. Për të parandaluar diskriminimin, Autoriteti Rregullator Hekurudhor siguron që tarifën mesatare dhe margjinale nga çdo administrues i infrastrukturës të jenë në përputhje me parimet e shprehura në nenin e këtij seksioni. Administruesi i infrastrukturës tregon në “Deklaratën e rrejtë” që sistemi i tarifimit plotëson këto kërkesa për atë që bëhet pa zbuluar informacione sekrete të biznesit.

4. Nëse administruesi i infrastrukturës ka për qëllim të ndryshojë elementet thelbësore të sistemit të tarifimit, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, ai i bën ato publike të paktën tre muaj përpara afatit për publikimin e “Deklaratës së rrejtë” në bazë të nenit 28, pika 1.4, të këtij Kodi.

Neni 34

Zbritje të tarifës

1. Pavarësisht nga parimi i kostos direkte, e përcaktuar në nenin 32, pika 3, të këtij Kodi, çdo zbritje tarife, e vendosur nga administruesi i infrastrukturës për çdo shërbim, bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë nen.

2. Me përjashtim të pikës 3, të këtij neni, zbritjet që aplikohen duke ruajtur gjithmonë koston reale administrative të administruesit të infrastrukturës, aplikohen mbi pjesën e fitimit që krijohet si rezultat i investimeve të teknologjive të reja për zbatimin, në sistemin hekurudhor, të kushteve teknike për ndërveprim (TSI) në lidhje me komandë -



kontrollin dhe sinjalizimin e nënsistemeve (CCI).

3. Administruesi i infrastrukturës aplikon skema të zbritjes së çmimit për përdoruesit e infrastrukturës, duke inkurajuar:

a) përdorimin e linjave të reja apo të atyre që përdoren nën kapacitet;

b) uljen e kohës së përdorimit të një segmenti hekurudhor të caktuar.

4. Zbritjet e çmimit lidhen vetëm me tarifën e vendosura për një seksion të caktuar të infrastrukturës.

5. Skema të ngjashme të zbritjes zbatohen për shërbime të ngjashme.

Neni 35

Dëmshpërblimi për rastet e aksidenteve

1. Dëmet njerëzore, mjedisore, infrastrukturore, të shkaktuara në raste aksidentesh, vlerësohen dhe kompensohen sipas legjislacionit në fuqi.

2. Metodologjia e përdorur dhe përlllogaritjet e kryera bëhen të njohura publikisht.

3. Në veçanti, kjo bën të mundur paraqitjen e kostove të veçanta e të pazbritshme të infrastrukturës konkurruese të transportit, që janë shmangur dhe për të siguruar se skema është dhënë në kushte jodiskriminuese ndaj sipërmarrjeve.

Neni 36

Skema e performancës

1. Sistemi i tarifimit të infrastrukturës nxit sipërmarrësit hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës të ulin sa më shumë dëmtimet dhe të përmirësojnë performancën e rrjetit hekurudhor nëpërmjet një skeme të përmirësimit të parametrave tekniko-shfrytëzues.

Ky sistem përfshin sanksionet për veprimet që ndërpresin shfrytëzimin e rrjetit, kompensimet që jepen për sipërmarrjet, të cilat pësojnë ndërprerje në punën e tyre dhe shpërblimet, të cilat akordohen për tejkalim të pritshmërisë.

2. Parimet bazë të sistemit të përmirësimit të parametrave tekniko-shfrytëzues janë pjesë e “Deklaratës së rrjetit”.

Neni 37

Tarifat e rezervimit

Administruesit e infrastrukturës mund të ngarkojnë një tarifë të përshtatshme për kapacitetin që është ndarë, por nuk përdoret. Kjo tarifë e mospërdorimit siguron bonuse (shpërblime) për

përdorimin efikas të kapaciteteve. Tarifa e një pagese të tillë mbi aplikuesin, të cilit i është shpërndarë një rrugëkalim i trenit, do të jetë e detyrueshme në rast të dështimit të tij të zakonshëm për të përdorur rrugëkalime të caktuara ose pjesë të tyre. Për ekzekutimin e kësaj tarife, administruesit e infrastrukturës do të publikojnë në deklaratën e tyre të rrjetit kriteret për të përcaktuar këtë dështim për përdorim. Autoriteti Rregullator Hekurudhor i kontrollon këto kriteret, në përputhje me nenin 56 të këtij Kodi. Pagesat për këtë tarifë bëhen nga aplikuesi ose nga sipërmarrja hekurudhore, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi. Administruesi i infrastrukturës do të jetë gjithmonë në gjendje të informojë çdo palë të interesuar për kapacitetin e infrastrukturës që tashmë është ndarë për sipërmarrjet hekurudhore përdoruese.

Neni 38

Bashkëpunimi në lidhje me sistemet e tarifimit mbi shumë rrjete

1. Administruesi i infrastrukturës bashkëpunon me homologët, me infrastrukturën e të cilëve ai lidhet, në rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare, për të mundësuar zbatimin e sistemeve të efektshme të tarifave, duke bashkërenduar tarifimin e shfrytëzimit për trenat që kalojnë mbi më shumë sesa një rrjet infrastrukture.

2. Në këtë bashkëpunim arrihet sigurimi i konkurrencës optimale të shërbimeve ndërkombëtare të transportit hekurudhor dhe përdorimi i efektshëm i rrjeteve hekurudhore. Për këtë qëllim ata vendosin procedurat e duhura, në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Për qëllimet e pikës 1, të këtij neni, administruesi i infrastrukturës hekurudhore bashkëpunon për zbatimin e efektshëm të uljeve të tarifave, sipas nenit 33, si dhe të skemave të përmirësimit të parametrave teknikë, sipas nenit 36, të këtij Kodi, për kalimin e qarkullimit në më shumë se një rrjet të sistemit hekurudhor europian.



Seksioni 3

Shpërndarja e kapacitetit të infrastrukturës

Neni 39

Të drejtat për kapacitete

1. Kapacitetet e infrastrukturës përcaktohen dhe jepen në përdorim nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore.

2. Nënkontraktimi i kapaciteteve infrastrukturore është i ndaluar. Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, nuk konsiderohen nënkontraktim i kapacitetit infrastrukturor hekurudhor rastet kur përfutuesi i kapacitetit infrastrukturor hekurudhor nuk ka si objekt kryesor të veprimtarisë së tij tregtare veprimtarinë në sektorin hekurudhor.

3. E drejta për të përdorur kapacitete të veçanta të infrastrukturës në formën e një itinerari të trenit u jepet kërkuësve të kapacitetit për një kohëzgjatje maksimale që përkon me kohëzgjatjen e orarit të punës.

4. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore dhe një kërkuës kapaciteti i infrastrukturës lidhin një marrëveshje kuadër, në përputhje me nenin 43, të këtij Kodi, për përdorimin e kapacitetit në infrastrukturën hekurudhore përkatëse për një kohë më të gjatë sesa periudha e orarit të grafikut të orareve të punës.

5. Të drejtat edhe detyrimet përkatëse të administruesit të infrastrukturës hekurudhore dhe të kërkuësve të kapacitetit infrastrukturor, në lidhje me ndarjen e kapaciteteve infrastrukturore hekurudhore, përcaktohen nga marrëveshja kuadër, e përgatitur në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.

6. Kërkuësit e kapaciteteve infrastrukturore, të cilët synojnë të kërkojnë marrjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore, me qëllim shfrytëzimin e një shërbimi ndërkombëtar të udhëtarëve, kanë detyrimin të njoftojnë administruesin e infrastrukturës hekurudhore dhe Autoritetin Rregullator Hekurudhor përkatësisht për sa më lart. Në procesin e dhënies së kapacitetit në një rast të tillë, vlerësimi i dhënies së kapacitetit bëhet në zbatim të nenit 14 të këtij Kodi.

7. Në mënyrë që të vlerësohet nëse qëllimi i shërbimit ndërkombëtar është për të transportuar udhëtarë në një itinerar mes stacioneve të vendosura në shtete të ndryshme dhe cili është ndikimi i mundshëm ekonomik në kontratat ekzistuese të shërbimit publik, Autoriteti Rregullator Hekurudhor duhet të sigurojë që të jetë

i informuar çdo autoritet kompetent që ka dhënë një shërbim hekurudhor udhëtarësh në atë itinerar të përcaktuar në kontratën e shërbimit publik, çdo autoritet tjetër i interesuar kompetent me të drejtën për të kufizuar qasjen në bazë të nenit 11, të këtij Kodi, dhe çdo sipërmarrje hekurudhore që zbaton kontratën e shërbimit publik në itinerarin e atij shërbimi ndërkombëtar udhëtarësh.

Neni 40

Ndarja e kapaciteteve

1. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore është përgjegjës për zbatimin e skemës së ndarjes së kapaciteteve të shfrytëzimit të infrastrukturës të hartuar prej tij. Ai siguron që ky proces është transparent dhe jodiskriminues, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe aktet ligjore dhe nënligjore, në zbatim të tij.

2. Administruesit e infrastrukturës hekurudhore respektojnë parimet e ruajtjes së konfidencialitetit tregtar, në lidhje me informacionin që i është vënë në dispozicion nga kërkuësit e kapaciteteve infrastrukturore.

Neni 41

Bashkëpunimi në ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës mbi shumë rrjete

1. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore bashkëpunon me homologët e vendeve kufitare, me të cilët infrastruktura hekurudhore ka vazhdimësi.

2. Marrëveshja midis administruesit të infrastrukturës hekurudhore me homologët e vendeve kufitare dhe rajonale hartohet në përputhje me marrëveshjet ndërqeveritare përkatëse në këtë fushë. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje hartohen rregullore për procedurat e ndarjes së kapaciteteve.

Neni 42

Kërkuësit e kapaciteteve infrastrukturore hekurudhore

1. Kërkesat për kapacitete të infrastrukturës hekurudhore bëhen nga kërkuësit e kapaciteteve infrastrukturore hekurudhore drejtpërdrejt tek administruesi i infrastrukturës hekurudhore, pa cenuar përcaktimet e nenit 29, të këtij Kodi, ose nëpërmjet një sipërmarrësi hekurudhor, i cili lidh një marrëveshje me administruesin e infrastrukturës



hekurudhore, siç parashikohet nga neni 43 i këtij Kodi.

2. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore vendos kriteret që kërkuesi i kapacitetit infrastrukturor hekurudhor duhet të përmbushë, përfshirë edhe pritshmërinë e tij financiare dhe aftësinë e tij për përdorimin e infrastrukturës në mënyrë të mbrojtur.

Këto kriteret përcaktohen në “Deklaratën e rrjetit” dhe janë të përshtatshme, transparente e jodiskriminuese.

Neni 43

Marrëveshjet kuadër

1. Marrëveshja kuadër lidhet ndërmjet administruesit të infrastrukturës hekurudhore dhe një kërkuesi të kapacitetit të infrastrukturës hekurudhore. Kjo marrëveshje përcakton karakteristikat e kapacitetit të infrastrukturës së kërkuar nga kërkuesi i kapacitetit, si dhe ato që i akordohen për gjithë kohëzgjatjen, e cila tejkalon periudhën e orarit të punës.

2. Marrëveshja kuadër nuk përcakton hollësisht një itinerar treni, por është e tillë që të përmbushë nevojat legjitime tregtare të një kërkuesi të kapacitetit.

3. Marrëveshja kuadër miratohet paraprakisht nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor. Autoriteti Rregullator Hekurudhor, para miratimit të çdo marrëveshjeje apo kontrate ose dhënieje të të drejtave ekskluzive, merr paraprakisht edhe mendimin e Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës.

4. Marrëveshjet kuadër nuk bëhen pengesë për përdorimin e infrastrukturës përkatëse nga kërkuesi i kapacitetit ose shërbimeve të tjera.

5. Kushtet e marrëveshjeve kuadër ndryshohen ose kufizohen për të lejuar një përdorim më të mirë të infrastrukturës hekurudhore.

6. Marrëveshjet kuadër përmbajnë sanksione të nevojshme në lidhje me zgjidhjen ose anulimin e tyre.

7. Marrëveshjet kuadër, në parim, lidhen për një periudhë kohore prej 5 vjetësh, të rinovueshme në periudha të barabarta me kohëzgjatjen e tyre fillestare, si më poshtë:

a) administruesi i infrastrukturës hekurudhore, në raste të veçanta, akordon periudha kohore më të shkurtra ose më të gjata;

b) çdo periudhë mbi 5 vjet duhet të bazohet në legjislacionin në fuqi për marrëveshje apo kontrata tregtare ekzistuese, investime të veçanta ose risqe.

8. Për shërbimet, që përdorin infrastrukturën e veçantë, në përputhje me nenet 49, 50 dhe 51, të këtij Kodi, infrastrukturën që kërkon investime të rëndësishme dhe afatgjata, marrëveshjet kuadër lidhen për një periudhë 15-vjeçare, kur kjo argumentohet si duhet nga kërkuesi i kapacitetit.

Çdo periudhë më e gjatë se 15 vjet është e lejueshme vetëm në raste të jashtëzakonshme, në veçanti kur ka investim afatgjatë në shkallë të gjerë dhe sidomos kur ky investim është i mbuluar nga angazhimet kontraktore, përfshirë një plan shumëvjeçar amortizimi.

Në raste të tilla të jashtëzakonshme, marrëveshja kuadër përcakton karakteristika të detajuara të kapacitetit infrastrukturor, i cili duhet të sigurohet për kërkuesin për kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër.

Këto karakteristika përfshijnë shpeshtësinë, volumin dhe cilësinë e rrugëkalimeve të trenit.

Administruesi i infrastrukturës hekurudhore zvogëlon kapacitetin e rezervuar, i cili për një periudhë prej të paktën një muaji, është përdorur më pak se niveli i pragut të parashikuar në kontratën e nënshkruar.

9. Duke respektuar konfidencialitetin tregtar, marrëveshja kuadër duhet të bëhet e disponueshme për secilën palë të interesuar.

Neni 44

Skema e procesit të ndarjes

Administruesi i infrastrukturës hekurudhore i përmbahet skemës së ndarjes së kapaciteteve dhe ndryshimeve të mëvonshme, si më poshtë:

a) orari i punës vendoset një herë në një vit kalendarik;

b) ndryshimi i orarit të punës bëhet në mesnatën e së shtunës së dytë në muajin dhjetor. Kur një ndryshim apo rregullim kryhet pas dimrit, në mënyrë të veçantë për ta marrë parasysh, sipas rastit, ndryshimet në oraret rajonale të trafikut të udhëtarëve, ai mbahet në mesnatën e së shtunës së dytë në muajin qershor dhe në intervale të tilla të tjera midis këtyre datave siç janë të nevojshme. Administruesit e infrastrukturës mund të bien dakord në data të ndryshme dhe në këtë rast ata informojnë homologët nëse mund të preket trafiku ndërkombëtar;



c) data e fundit për pranimin e kërkesave për kapacitetin që ato të përfshihen në orarin e punës do të jetë jo më shumë se 12 muaj para hyrjes në fuqi të orarit të punës;

ç) jo më vonë se 11 muaj para se të hyjë në fuqi orari i punës, administruesit e infrastrukturës sigurojnë që rrugëkalimet e përkohshme ndërkombëtare të trenave të jenë krijuar në bashkëpunim me administruesit e tjerë të infrastrukturës përkatëse. Administruesit e infrastrukturës sigurojnë që këto zbatime të respektohen sa më shumë gjatë proceseve të mëvonshme;

d) këto zbatime për të rregulluar të drejtat e aplikuesve për të evituar mosdiskriminimin kryhen me akte ligjore dhe nënligjore, në zbatim të këtij Kodi.

Neni 45

Planifikimi i kapaciteteve

1. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore plotëson, për aq sa është e mundur, të gjitha kërkesat për kapacitetin e infrastrukturës, përfshirë kërkesat për itinerare që kalojnë mbi më shumë se një rrjet, duke marrë në konsideratë, për aq sa është e mundur, të gjitha kufizimet mbi aplikuesit, përfshirë efektin ekonomik në biznesin e tyre.

2. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore mund t'i japë përparësi për shërbime të veçanta, në kuadër të procesit të planifikimit dhe koordinimit vetëm në rastet që përcaktohen në nenet 47 dhe 49 të këtij Kodi.

3. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore konsultohet me palët e interesuara në lidhje me hartimin paraprak të orarit të punës, duke u dhënë atyre të paktën një muaj afat për të paraqitur pikëpamjet e tyre. Në palët e interesuara përfshihen të gjithë ata që kanë kërkuar kapacitetin infrastrukturor dhe palët e tjera, të cilat dëshirojnë të kenë mundësinë për të komentuar se si orari i punës mund të ndikojë në aftësinë e tyre për kryerjen e procedurave ligjore të shërbimeve hekurudhore gjatë periudhës së orarit të punës.

Administruesi i infrastrukturës hekurudhore ndërmerri masat e duhura për të trajtuar kërkesat e shprehura të palëve të interesuara mbi sa më lart.

Neni 46

Procesi i bashkërendimit

1. Gjatë procesit të planifikimit, të përmendur

në nenin 45, të këtij Kodi, administruesi i infrastrukturës hekurudhore vlerëson, bashkërendon dhe përcakton ndarjen e kapaciteteve hekurudhore që të sigurojë plotësimin më të mirë të mundshëm të të gjitha kërkesave.

2. Kur lind një situatë që kërkon bashkërendim, administruesi i infrastrukturës hekurudhore ka të drejtë, brenda kufijve të arsyeshëm, t'u propozojë kërkuarve kapacitete infrastrukturorë që ndryshojnë nga kërkesat e parashtruara prej tyre.

3. Administruesi i infrastrukturës zgjidh çdo konflikt përmes këshillimit me kërkuarët e kapacitetit. Ky këshillim bazohet në dhënien e informacionit të mëposhtëm, brenda 10 ditëve, falas dhe me shkrim dhe/ose në formë elektronike:

a) itineraret e trenave, të kërkuara nga të gjithë kërkuarët e tjerë të kapacitetit mbi të njëjtat linja;

b) itineraret e trenave, të ndara paraprakisht për të gjithë kërkuarët e tjerë të kapacitetit mbi të njëjtat linja;

c) itineraret alternative të trenave, të propozuara për linjat në fjalë, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

4. Informacioni i plotë sigurohet pa zbulimin e identitetit të kërkuarve të tjerë të kapacitetit, përveçse kur kërkuarët në fjalë të kapacitetit kanë rënë dakord që të jepet identifikimi i tyre.

5. Parimet që rregullojnë procesin e bashkërendimit jepen në “Deklaratën e rrjetit”. Në veçanti, ato pasqyrojnë vështirësinë e rregullimit të itinerareve ndërkombëtare të trenave dhe ndikimin që mund të ketë çdo ndryshim tek administruesit e tjerë të infrastrukturës.

6. Kur kërkesat për kapacitete infrastrukturorë nuk plotësohen pa bashkërendim, administruesi i infrastrukturës përpiqet të mirëpresë të gjitha kërkesat nëpërmjet bashkërendimit.

7. Pa rënë ndesh me procedurat aktuale të ankimit dhe nenin 55, të këtij Kodi, në rast mosmarrëveshesh në lidhje me ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës, vihet në dispozicion një sistem për zgjidhjen e tyre të menjëhershme. Ky sistem paraqitet në “Deklaratën e rrjetit”. Kur zbatohet ky sistem, vendimi merret brenda një afati kohor prej 10 ditësh pune.

Neni 47

Infrastruktura e mbingarkuar ose e tejngopur

1. Kur në përfundim të bashkërendimit të itinerareve të kërkuara të trenave dhe këshillimit me



kërkuesit e kapacitetit, nuk kënaqen kërkesat për kapacitete të infrastrukturës, administruesi i infrastrukturës menjëherë deklaroi që ky seksion i infrastrukturës është i tejnepur.

2. Kur infrastruktura deklarohet që është e tejnepur, administruesi i infrastrukturës kryen një analizë të kapaciteteve, në përputhje me nenin 50, të këtij Kodi, përveç rasteve kur është vënë në zbatim një plan i rritjes së kapaciteteve, siç përcaktohet në nenin 51 të këtij Kodi.

3. Kur tarifata, në përputhje me nenin 32, pika 4, të këtij Kodi, nuk janë vjelë ose nuk është arritur një rezultat i kënaqshëm me vjeljen e tyre dhe infrastruktura është deklaruar e tejnepur, administruesi i infrastrukturës vendos kritere prioriteteve për ndarjen e kapaciteteve infrastrukturale.

4. Kriteret e prioriteteve marrin parasysh rëndësinë e një shërbimi ndaj publikut në lidhje me çdo shërbim tjetër që për pasojë përjashtohet.

5. Rëndësia e shërbimeve të transportit të mallrave dhe në veçanti e shërbimeve ndërkombëtare të transportit të mallrave merret parasysh në përcaktimet e kriterëve parësore.

6. Procedurat që ndiqen dhe kriteret që përdoren kur infrastruktura është e tejnepur jepen në “Deklaratën e rritjes”.

Neni 48

Kërkesat e rastit (Aplikimi *ad hoc*)

1. Administruesi i infrastrukturës u përgjigjet kërkesave të rastit për itinerare të veçanta të trenave sa më shpejt që është e mundur dhe për çdo rast brenda 5 ditësh pune. Të dhënat në lidhje me kapacitetet e papërdorura dhe të lira vihen në dispozicion të të gjithë kërkuesve të kapacitetit që dëshirojnë ta përdorin këtë kapacitet.

2. Administruesit e infrastrukturës, kur nevojitet, marrin përsipër të kryejnë vlerësimin e nevojës për kapacitete rezervë në orarin përfundimtar të punës, që t’u përgjigjen kërkesave të rastit për kapacitete të parashikuara. Në të njëjtën mënyrë vepohet edhe në rastet e infrastrukturës së tejnepur.

Neni 49

Infrastrukturat e veçanta

1. Pa rënë ndesh me përcaktimet e pikës 2, të këtij neni, kapacitetet e infrastrukturës quhen të vlefshme për përdorim në të gjitha llojet e

shërbimit që përputhen me karakteristikat e kërkuara për shfrytëzimin e itinerareve të trenave.

2. Kur ka itinerare zëvendësuese të përshtatshme, administruesi i infrastrukturës, pas këshillimit me palët e interesuara, përcakton infrastruktura të veçanta për përdorim nga lloje të veçanta të qarkullimit, të cilat publikohen në “Deklaratën e rritjes”. Ky përcaktim nuk pengon përdorimin e kësaj infrastrukture nga lloje të tjera të qarkullimit kur kapacitetet janë të disponueshme.

Neni 50

Analiza e kapaciteteve

1. Objektivi i analizës së kapaciteteve është përcaktimi i kufizimeve mbi kapacitetet e infrastrukturës që pengojnë plotësimin siç duhet të kërkesave për kapacitete dhe propozimi i metodave që mundësojnë plotësimin e kërkesave shtesë. Në analizën e kapaciteteve identifikohen shkaqet e tejnepjes dhe masat afatshkurtra e afatgjata që merren për lehtësimin e tejnepjes.

2. Në analizën e kapaciteteve merren parasysh infrastruktura, procedurat e shfrytëzimit, llojet e shërbimeve të ndryshme shfrytëzuese dhe ndikimi i të gjithë këtyre faktorëve mbi kapacitetet e infrastrukturës. Në masat që merren përfshihen në veçanti ndryshimet e itinerarit, riprogramimi i shërbimeve, ndryshimi i shpejtësive dhe përmirësimet e infrastrukturës.

3. Analiza e kapaciteteve përfundon brenda 6 muajve nga identifikimi i infrastrukturës si infrastrukturë e tejnepur.

Neni 51

Plani i rritjes së kapaciteteve

1. Brenda 6 muajve nga përfundimi i analizës së kapaciteteve, administruesi i infrastrukturës paraqet një plan për rritjen e kapaciteteve.

2. Ky plan i rritjes së kapaciteteve zhvillohet pas këshillimit me përdoruesit e infrastrukturës përkatëse të tejnepur dhe identifikon:

- a) arsyet e bllokimit;
- b) zhvillimin e ardhshëm të mundshëm të qarkullimit;
- c) pengesat në zhvillimin e infrastrukturës;
- ç) mundësitë dhe kostot për rritjen e kapaciteteve, përfshirë ndryshimet e mundshme të tarifave të hyrjes në infrastrukturë.



3. Në bazë të analizës kosto-fitim dhe koston së masave të mundshme të identifikuar, në planin e rritjes së kapaciteteve përcaktohen veprimet që ndërmerren për të rritur kapacitetet e infrastrukturës, përfshirë një grafik afatesh për zbatimin e masave.

Neni 52

Përdorimi i itinerareve të trenit

1. Administruesi i infrastrukturës në “Deklaratën e rritjes” jep kushtet e marrjes parasysh të niveleve të mëparshme të përdorimit të itinerareve të trenit për përcaktimin e prioriteteve në procesin e ndarjes.

2. Për infrastrukturën e tejnngopur në veçanti, administruesi i infrastrukturës kërkon anulimin e një itinerari treni, që për një periudhë të paktën prej një muaji është përdorur më pak se pragu i vendosur në “Deklaratën e rritjes”.

Neni 53

Kapacitetet e infrastrukturës për punimet e mirëmbajtjes

1. Kërkesat për kapacitetet e infrastrukturës, që mundësojnë punimet që kryhen për mirëmbajtje, paraqiten gjatë procesit të përgatitjes së planifikimit.

2. Administruesi i infrastrukturës merr parasysh ndikimin e rezervimit të kapaciteteve të infrastrukturës për punimet e mirëmbajtjes mbi kërkesit e kapacitetit.

3. Administruesi i infrastrukturës informon palët e interesuara për pavlefshmërinë e kapacitetit të infrastrukturës, për shkak të punimeve të mirëmbajtjes së paplanifikuar.

Neni 54

Masat e veçanta që merren në rast çrregullimi të lëvizjes të trenave

1. Në rastin e çrregullimit në lëvizjen e trenave, shkaktuar nga mosfunksionimi teknik ose për shkak të një aksidenti, administruesi i infrastrukturës merr të gjitha masat e nevojshme për ta kthyer gjendjen në normalitet. Për këtë qëllim ai harton një plan ndërhyrjeje, duke renditur organet e ndryshme që informohen në rastin e ngjarjeve të rënda ose çrregullimeve të mëdha në lëvizjen e trenave.

2. Në rastin e një emergjence dhe të nevojës së domosdoshme, për shkak të një mosfunksionimi

(defekti), që e bën infrastrukturën përkohësisht të papërdorshme, itinerari i trenave i shpërndarë tërhiqet pa paralajmërim për aq kohë sa nevojitet për të riparuar sistemin.

3. Sipërmarrja hekurudhore i nënshtrohet kontrollit në drejtim të zbatimit dhe të respektimit prej saj të rregullave teknike dhe rregullave kombëtare të sigurisë.

KREU IV

AUTORITETI RREGULLATOR HEKURUDHOR

Neni 55

Autoriteti Rregullator Hekurudhor

1. Autoriteti Rregullator Hekurudhor krijohet me ligj, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, nga pikëpamja organizative, funksionale, hierarkike dhe e vendimmarrjes, është një autoritet i pavarur nga çdo subjekt tjetër, publik ose privat.

Autoriteti Rregullator Hekurudhor është i pavarur në organizimin e tij, në financimin e tij, strukturën ligjore dhe të vendimmarrjes edhe nga çdo administrues i infrastrukturës, organ tarifues në hekurudhë, organ i ndarjes së kapaciteteve hekurudhore ose aplikues për kapacitet infrastrukturor.

Ai është funksionalisht i pavarur nga çdo autoritet kompetent i përfshirë në dhënien e një kontrate të shërbimit publik.

2. Autoriteti Rregullator Hekurudhor bashkëpunon me Autoritetin Kombëtar të Konkurrencës ose me një organ tjetër rregullator, për veprimtaritë e sektorit hekurudhor.

3. Drejtuesi i Autoritetit emërohet nga ministri përgjegjës për transportet. Marrëdhëniet e punës së drejtuesit të Autoritetit dhe të stafit rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

Neni 56

Funksionet e Autoritetit Rregullator Hekurudhor

1. Pa rënë ndesh me dispozitat që përcaktojnë formën e ankimit për ndarje të kapacitetit, aplikuesi ka të drejtë të ankohet tek Autoriteti Rregullator Hekurudhor nëse beson se është trajtuar padrejtësisht, është diskriminuar ose në ndonjë mënyrë është dëmtuar dhe mund të ankohet në veçanti kundër vendimeve të miratuara nga administruesi i infrastrukturës ose operatori i një



impianti të shërbimit në lidhje me:

a) deklaratën e tij të rrjetit në versionet paraprake të përkohshme dhe përfundimtare;

b) kriteret e përcaktuara në “Deklaratën e rrjetit”;

c) procesin e ndarjes së kapacitetit dhe rezultatin e këtij procesi;

ç) skemën e tarifimit;

d) skemën e përbërësve të tarifës që del detyrim për t'u paguar;

dh) marrëveshjet për qasje në infrastrukturë, në përputhje me nenet 10 deri në 13 të këtij Kodi;

e) qasjen në rrjet dhe tarifimin për shërbimet, në përputhje me nenin 13 të këtij Kodi.

2. Pa cenuar kompetencat e Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës, Autoriteti Rregullator Hekurudhor ka të drejtën e monitorimit të situatës konkurruese në tregjet e shërbimeve hekurudhore dhe, në veçanti, pikat e kontrollit, sipas parashikimeve në pikën 1, të këtij neni, me qëllim parandalimin e diskriminimit të aplikuesve.

Autoriteti Rregullator Hekurudhor kontrollon nëse “Deklarata e rrjetit” përmban elemente diskriminuese apo krijon kompetenca të pakufishme për administruesin e infrastrukturës që mund të përdoret për të diskriminuar aplikuesit.

Në rastet kur Autoriteti Rregullator Hekurudhor vëren shenjat e një sjelljeje antikonkurruese nga sipërmarrësit hekurudhorë në tregjet e shërbimeve hekurudhore, e përcjell rastin pranë Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës.

3. Autoriteti Rregullator Hekurudhor bashkëpunon ngushtë me Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore në lidhje me kërkesat thelbësore të ndërveprimit, si dhe me Autoritetin Licencues Hekurudhor për zbatimin e këtij Kodi.

Autoriteti Rregullator Hekurudhor harton një rregullore të posaçme për procesin e konsultimit me Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore dhe me Autoritetin Licencues Hekurudhor për nxjerrjen e përfundimeve dhe marrjen e vendimeve, në përputhje me parimin e ruajtjes së tregut.

4. Autoriteti Rregullator Hekurudhor jep rekomandime jodetyruese për versionin e përkohshëm të planit të biznesit, të marrëveshjes kontraktore dhe planit për përmirësimin e kapaciteteve të referuara në pikën 3, të nenit 11, të këtij Kodi, nëse ato përputhen me situatën konkurruese në tregjet e shërbimit hekurudhor.

5. Autoriteti Rregullator Hekurudhor ka kapacitetet e nevojshme organizative në aspektin e burimeve njerëzore edhe materiale, të cilat përputhen me madhësinë e sektorit që kontrollojnë dhe rëndësinë e tij për ekonominë.

6. Autoriteti Rregullator Hekurudhor siguron që tarifat e përcaktuara nga administruesi i infrastrukturës, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, të jenë jodiskriminuese. Negociatat ndërmjet aplikuesit të kapacitetit dhe një administruesi të infrastrukturës, në lidhje me nivelin e tarifave të infrastrukturës, lejohen vetëm nën mbikëqyrjen e Autoritetit Rregullator Hekurudhor. Autoriteti Rregullator Hekurudhor ndërhyt nëse negociatat janë në kundërshtim me kërkesat e këtij kreu.

7. Autoriteti Rregullator Hekurudhor, çdo dy vjet, konsultohet me përfaqësues të përdoruesve të shërbimeve të mallrave me hekurudhë dhe transportit të udhëtarëve, për të marrë parasysh pikëpamjet e tyre për tregun.

8. Autoriteti Rregullator Hekurudhor ka të drejtë të kërkojë informacion nga administruesi i infrastrukturës, nga aplikuesit dhe çdo palë e tretë e përfshirë në transportin hekurudhor.

Informacioni i kërkuar dërgohet brenda një periudhe që nuk e kalon një muaj, përveç nëse, në rrethana të jashtëzakonshme, Autoriteti Rregullator Hekurudhor përcakton një kohë shtesë që nuk i kalon dy javë të tjera. Autoriteti Rregullator Hekurudhor merr masa nëpërmjet vendosjes së sanksioneve për zbatimin e kërkesave të tij.

Në informacionin që kërkohet nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor përfshihen të gjitha të dhënat, të cilat shërbejnë për realizimin e detyrës së tij të monitorimit të konkurrencës në tregjet e shërbimeve hekurudhore, në përputhje me pikën 2 të këtij neni. Ky informacion përfshin të dhëna statistikore për qëllime të vëzhgimit të tregut.

9. Autoriteti Rregullator Hekurudhor shqyrton çdo ankesë, kërkon informata shtesë dhe fillon konsultimet me të gjitha palët e interesuara, brenda një muaji nga dita e pranimit të ankesës. Autoriteti Rregullator Hekurudhor vendos mbi çdo çështje, duke marrë masa për të korrigjuar situatën dhe informon palët përkatëse për vendimet e tij të arsyetuara brenda gjashtë javëve nga data e marrjes së të gjithë informacionit përkatës.

10. Pa cenuar kompetencat e Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës, për sigurimin e konkurrencës në tregun e shërbimit hekurudhor,



Autoriteti Rregullator Hekurudhor, sipas rastit, vendos me iniciativën e tij masa të përshtatshme për korrigjimin e diskriminimit ndaj kërkuesve, ndaj çrregullimit të tregut dhe çdo zhvillimi tjetër të padëshirueshëm, në veçanti në lidhje me përcaktimin e bërë në pikën 1, të këtij neni, si më poshtë:

a) vendimi i Autoritetit Rregullator Hekurudhor është i detyrueshëm për të gjitha palët e përfshira në këtë vendim dhe nuk i nënshtrohet një kontrolli tjetër administrativ. Autoriteti Rregullator Hekurudhor zbaton vendimet e tij me masa të përshtatshme, përfshirë sanksionet;

b) në rast të ankesës kundër refuzimit për dhënien e kapaciteteve të infrastrukturës ose kundër kushteve të një oferte të kapacitetit, Autoriteti Rregullator Hekurudhor ose konfirmon vendimin e administruesit të infrastrukturës, ose kërkon ndryshimin e këtij vendimi, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor;

c) vendimet e marra nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor;

ç) ankesat kanë efekt pezullues të vendimit të Autoritetit Rregullator Hekurudhor vetëm kur efekti i menjëhershëm i vendimit të tij shkakton dëme të pazëvendësueshme për ankuesin;

d) kjo dispozitë nuk cenon kompetencat e gjykatës. Vendimet e marra nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor publikohen;

dh) Autoriteti Rregullator Hekurudhor i kërkon administruesit të infrastrukturës, operatorëve të impianteve të shërbimit dhe të gjithë sipërmarrësve ose subjekteve të tjera, që kryejnë ose janë të integruar në mënyra të ndryshme me shërbimet e transportit hekurudhor ose me administrimin e infrastrukturës, siç përmendet në nenet 9, pikat 1 e 2, dhe 15, të këtij Kodi, informacion të mjaftueshëm të detajuar mbi llogaritë dhe kontabilitetin, siç shihet e nevojshme për realizimin e detyrës së tij;

e) pa cenuar kompetencat e autoriteteve kombëtare përgjegjëse për çështjet e ndihmës shtetërore, Autoriteti Rregullator Hekurudhor nxjerr përfundime nga llogaritë në lidhje me çështjet e ndihmës shtetërore dhe ia raporton këto autoritetit përgjegjës për ndihmën shtetërore;

ë) në çdo rast, Autoriteti Rregullator Hekurudhor njofton edhe Autoritetin Kombëtar të Konkurrencës.

11. Autoriteti Rregullator Hekurudhor, në përshtatje me zhvillimet vendore dhe rajonale, përmirëson kuadrin rregullator të kontrollit që ai kryen tek të gjitha subjektet hekurudhore në lidhje me:

- a) ndarjen e llogarive dhe bilanceve;
- b) skemën e tarifimit për të gjitha llojet e shërbimeve hekurudhore;
- c) treguesit e performancës financiare të subjekteve.

Neni 57

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve rregullatore hekurudhore

1. Autoriteti Rregullator Hekurudhor kërkon bashkëpunim dhe shkëmben informacione në lidhje me punën e tij dhe parimet e vendimmarrjes, si dhe për praktikën zbatuese me homologët e tij në vendet e tjera.

Në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave të rëndësishme, shkëmbimi i informacionit të përmendur më lart mes autoriteteve rregullatore hekurudhore plotëson konfidencialitetin e sekreteve të ofruara nga subjektet përkatëse.

2. Autoriteti Rregullator Hekurudhor bashkëpunon me homologët e vendeve të tjera edhe përmes marrëveshjeve të përbashkëta, për qëllime të ndihmës së ndërsjellë në detyrat e tyre të monitorimit të tregut dhe trajtimit të ankesave apo investigimeve.

3. Në rastin e një ankese ose të një investigimi mbi çështjet e qasjes apo të tarifimit, në lidhje me një transport ndërkombëtar hekurudhor, si dhe në kuadrin e monitorimit të konkurrencës në treg, në lidhje me shërbimet ndërkombëtare të transportit hekurudhor, Autoriteti Rregullator Hekurudhor konsultohet me homologët e vendeve, përmes të cilit rrugëkalimi ndërkombëtar i trenit në fjalë kalon dhe, kur është e përshtatshme, kërkon të gjitha informatat e nevojshme prej tyre para se të marrë vendimin e tij.

4. Autoriteti Rregullator Hekurudhor konsultohet në përputhje me pikën 3, të këtij neni, dhe siguron të gjithë informacionin që ata vetë kanë të drejtë të kërkojnë në bazë të legjislacionit në fuqi. Ky informacion përdoret vetëm për qëllime të trajtimit të ankesës ose investigimit të përmendur në pikën 3 të këtij neni.

5. Autoriteti Rregullator Hekurudhor pranon



ankesën ose kryerjen e një investigimi me iniciativën e vet dhe transferon informacionin përkatës te homologu, në mënyrë që të marrë masa në lidhje me palët e interesuara.

6. Administruesit e infrastrukturës sigurojnë dhe dorëzojnë, pa vonesë, gjithë informacionin e nevojshëm, me qëllim trajtimin e ankesës ose investigimit të përmendur në pikën 3, të këtij neni, dhe të kërkuar nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor i vendit, në të cilin është vendosur përfaqësuesi i ankimuesit.

7. Bazuar në përvojën e autoriteteve rregullatore hekurudhore mbi aktivitetet e rrjetit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, dhe për të siguruar bashkëpunimin efikas të Autoritetit Rregullator Hekurudhor, ky i fundit përshtat të gjitha udhëzimet europiane për kushtet kombëtare.

8. Autoriteti Rregullator Hekurudhor shqyrton vendimet dhe praktikatat e shoqatave të administruesve të infrastrukturës.

PJESA E TRETË ADMINISTRIMI I SIGURISË NË SISTEMIN HEKURUDHOR

KREU I ZHVILLIMI DHE ADMINISTRIMI I SIGURISË

Neni 58

Zhvillimi dhe përmirësimi i sigurisë hekurudhore

1. Me synim zhvillimin dhe përmirësimin e sigurisë hekurudhore, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, brenda kufijve të kompetencave të tij, garanton se:

a) siguria hekurudhore ruhet në tërësi dhe, kur është e arsyeshme dhe e mundur, përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke pasur parasysh zhvillimin e rregullave ndërkombëtare, progresin teknik dhe shkencor, duke i dhënë përparësi parandalimit të aksidenteve dhe incidenteve;

b) i gjithë legjislati i zbatueshëm është aplikuar në një mënyrë të hapur dhe jodiskriminuese, duke nxitur zhvillimin e një sistemi të vetëm të transportit hekurudhor europian;

c) masat për zhvillimin dhe përmirësimin e sigurisë hekurudhore marrin parasysh nevojën për një qasje të bazuar në sistem;

ç) përgjegjësia për funksionimin e sigurt të sistemit hekurudhor dhe kontrollin e rreziqeve vendoset për administruesit e infrastrukturës dhe sipërmarrjet hekurudhore, çdonjëri për pjesën e vet të sistemit, duke i detyruar ata:

i) të zbatojnë masa të nevojshme të kontrollit të rrezikut, në lidhje me metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM), nëse është e përshtatshme, në bashkëpunim me njëra-tjetrën;

ii) të zbatojnë rregullat kombëtare dhe europiane të sigurisë;

iii) të krijojnë sisteme të menaxhimit të sigurisë (SMS), në përputhje me këtë Kod;

d) pa cenuar detyrimin civil, në përputhje me kërkesat ligjore, çdo administrues i infrastrukturës dhe sipërmarrje hekurudhore bëhen përgjegjës për pjesën e vet të sistemit dhe funksionimin e vet të sigurt, përfshirë furnizimin e materialeve dhe kontraktimin e shërbimeve, përballë aktorëve të interesuar dhe aktorëve të tjerë të përmendur në pikën 4 të këtij neni:

i) përgatisin dhe publikojnë plane vjetore të sigurisë që përcaktojnë masat e parashikuara për arritjen e objektivave të përbashkët të sigurisë (CST);

ii) nëse është e nevojshme, mbështesin Agjencinë në punën e saj për të monitoruar zhvillimin e sigurisë hekurudhore në nivel europian.

2. Sipërmarrjet hekurudhore dhe administruesit e infrastrukturës:

a) zbatojnë masat e nevojshme të kontrollit të rrezikut, në lidhje me metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM), kur është e nevojshme, në bashkëpunim me njëra-tjetrën dhe me grupe të tjera interesi;

b) marrin parasysh në sistemet e tyre të menaxhimit të sigurisë (SMS) rreziqet e shoqëruara me aktivitetet e grupeve të tjera të interesit dhe palëve të treta;

c) kur është e përshtatshme, detyrojnë me kontratë grupet e tjera të interesit, të përmendura në pikën 4, të këtij neni, që kanë ndikim potencial në funksionimin e sigurt të sistemit hekurudhor për zbatimin e masave të kontrollit të rrezikut;

ç) garantojnë se kontraktuesit e tyre zbatojnë masa të kontrollit të rrezikut nëpërmjet zbatimit të metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM) për proceset monitoruese, të përcaktuara në këto metoda për monitorim dhe se kjo përcaktohet në



masat kontraktore që duhet të zbulohen me kërkesë të Agjencisë ose Autoritetit Kombëtar të Sigurisë.

3. Pa cenuar përgjegjësitë e sipërmarrjeve hekurudhore dhe administruesve të infrastrukturës, të përmendur në pikën 2, të këtij neni, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe të gjithë aktorët e tjerë që kanë ndikim potencial në funksionimin e sigurt të sistemit hekurudhor, përfshirë prodhuesit, furnizuesit e mirëmbajtjes, mbajtësit, ofruesit e shërbimeve, subjektet kontraktuese, transportuesit, dërguesit e mallrave:

a) zbatojnë masat e nevojshme për kontrollin e rrezikut, kur është e nevojshme, në bashkëpunim me grupe të tjera interesi;

b) garantojnë se nënsistemet, aksesorët, pajisjet dhe shërbimet e furnizuara prej tyre pajtohen me kërkesat dhe kushtet e përcaktuara për përdorim, në mënyrë që të mund të operohen në mënyrë të sigurt nga sipërmarrja hekurudhore dhe/ose administruesi i interesuar i infrastrukturës.

4. Sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës dhe çdo grup interesi që identifikon ose informohet për një rrezik sigurie të lidhur me defektet dhe mospërputhjet ose keqfunksionimet e ndërimit të pajisjes teknike, përfshirë ato të nënsistemeve strukturore, brenda kufijve të kompetencës së tyre përkatëse:

a) marrin çdo masë të nevojshme korrigjuese për trajtimin e rrezikut të identifikuar të sigurisë;

b) ua raportojnë këto rreziqe palëve përkatëse të përfshira, me qëllim që t'u mundësojnë atyre të marrin çdo masë të nevojshme të mëtejshme korrigjuese për të garantuar arritjen e vazhdueshme të përmbushjes së sigurisë të sistemit hekurudhor.

5. Në rastin e shkëmbimit të mjeteve midis sipërmarrjeve hekurudhore, çdo aktor i përfshirë shkëmben të gjithë informacionin e lidhur me funksionimin e sigurt, duke përfshirë, por pa u kufizuar te statusi dhe historiku i mjetit hekurudhor përkatës, elementet e dosjeve të mirëmbajtjes, për qëllim të gjurmueshmërisë së mjetit, gjurmueshmërisë së operacioneve të ngarkimit dhe fletëngarkesave.

Neni 59

Treguesit e përbashkët të sigurisë (CSI)

1. Me qëllim lehtësimin e vlerësimit të arritjes së treguesve të përbashkët të sigurisë (CSI) dhe parashikimin e monitorimit të zhvillimit të

përgjithshëm të sigurisë hekurudhore, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mbledh informacion për këta tregues nëpërmjet raporteve vjetore të administruesit të infrastrukturës dhe sipërmarrjes hekurudhore.

2. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore publikon çdo vit, siç janë përcaktuar nga BE-ja, treguesit e përbashkët të sigurisë (CSI), pas miratimit nga ministri përgjegjës për transportet.

3. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore harton dhe publikon çdo vit treguesit e përbashkët të sigurisë (CSI), në përputhje me raportet, sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e këtij Kodi.

Neni 60

Metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM)

1. Metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM), të zhvilluara dhe të publikuara nga BE-ja, konsiderohen si bazë për sigurinë hekurudhore në Shqipëri.

2. Metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM) hartohen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe miratohen me akt nënligjor nga ministri përgjegjës për transportet.

3. Metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM) rishikohen në interval të rregullt nga Agjencia e Bashkimit European për Hekurudhat.

4. Metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM) përshkruajnë se si janë vlerësuar nivelet e sigurisë hekurudhore, arritjen e objektivave të përbashkët të sigurisë (CST) dhe pajtueshmërinë me kërkesat e tjera të sigurisë, përfshirë, kur është e përshtatshme, me anë të një organi të pavarur të vlerësimit, duke kryer (zhvilluar, trajtuar, punuar) dhe duke përcaktuar:

a) vlerësimin e riskut dhe metodat e vlerësimit;

b) metodat për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për certifikatat e sigurisë dhe autorizimet e sigurisë, të lëshuara në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, certifikatën e sigurisë për sipërmarrjet hekurudhore dhe autorizimet e sigurisë për administruesit e infrastrukturës;

c) metodat për mbikëqyrjen që do të aplikohen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe metodat e monitorimit që do të zbatohen nga sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen;

ç) metodat për vlerësimin e nivelit të sigurisë dhe performancën e sigurisë të operatorëve hekurudhorë në nivel kombëtar;



d) metodat për vlerësimin e përmbushjes së objektivave të përbashkët të sigurisë (CST) në nivel kombëtar.

5. Rishikimet e metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM) pasohen nga ndryshimet e nevojshme në rregullat përkatëse të sigurisë.

Neni 61

Objektivat e përbashkët të sigurisë (CST)

1. Objektivat e përbashkët të sigurisë (CST) rishikohen në intervale të rregullta kohore, duke pasur parasysh zhvillimin global të sigurisë hekurudhore.

2. Objektivat e përbashkët të sigurisë (CST) të rishikuara reflektojnë çdo zonë prioritare ku siguria duhet të përmirësohet më tej.

3. Ndryshimet apo kërkesat e nevojshme për të arritur objektivat e përbashkët të sigurisë (CST) përputhen me detyrimet e përcaktuara në nenin 59, të këtij Kodi, dhe shoqërohen me vlerën e kostos dhe përfitimin prej tyre, duke treguar ndikimin e tyre të mundshëm për të gjithë operatorët dhe agjentët ekonomikë të përfshirë dhe ndikimin e tyre në pranimin e riskut social.

Zbatimi i tyre bëhet sipas një afati kohor gradual, duke marrë parasysh natyrën dhe shtrirjen e investimeve të nevojshme për zbatimin e tyre dhe afatin e shlyerjes së investimit.

Zbatimi i tyre analizon dhe parashikon ndryshimet e nevojshme të kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) për nënsisteme të ndryshme.

4. Në objektivat e përbashkët të sigurisë (CST) përcaktohen nivelet e sigurisë që duhet të jenë arritur nga pjesët e ndryshme të sistemit hekurudhor dhe shprehen në kriteret e pranimin të riskut për:

a) risqet individuale në lidhje me udhëtarët, stafin, përfshirë personelin e kontraktuesit, përdoruesit e kalimit në nivel dhe të tjerët dhe, pa cenuar rregullat ekzistuese kombëtare, risqet individuale në lidhje me persona të paautorizuar në mjediset hekurudhore;

b) risqet sociale.

5. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore kryen ndryshimet e nevojshme në rregulloret e sigurisë kombëtare, në mënyrë që të arrihet çdo objektiv i përbashkët i sigurisë (CST) i rishikuar.

Neni 62

Rregullat kombëtare të sigurisë në hekurudhë

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore harton në gjuhë të qartë dhe publikon rregullat e detyrueshme të sigurisë kombëtare në hekurudhë, të cilat miratohen nga ministria përgjegjëse për transportet.

2. Rregullat kombëtare të sigurisë, të miratuara, vihen në dispozicion për të gjithë administruesit e infrastrukturës, sipërmarrësit hekurudhorë, aplikuesit për certifikatën e sigurisë dhe për autorizimin e sigurisë, në të paktën dy gjuhë në faqen zyrtare të Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore.

3. Ministria përgjegjëse për transportet publikon rregullat kombëtare të detyrueshme të sigurisë me propozimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore dhe nën mbikëqyrjen e tij. Këto rregulla publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze dhe vihen në dispozicion të administruesve të infrastrukturës dhe të sipërmarrjeve hekurudhore, aplikuesve për certifikatën e sigurisë dhe autorizimin e sigurisë në një gjuhë të qartë për palët e përfshira. Këto rregulla kombëtare të sigurisë vihen në dispozicion në faqen e internetit të Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore.

4. Rregullat kombëtare të sigurisë për sektorin hekurudhor në Shqipëri miratohen me akt nënligjor nga ministri përgjegjës për transportet. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore njofton Agjencinë për rregullat kombëtare të sigurisë ekzistuese, të reja dhe ato të shfuqizuara. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mund të përcaktojë rregulla të reja kombëtare vetëm në rastet e mëposhtme:

a) nëse rregullat në lidhje me metodat ekzistuese të sigurisë nuk mbulohen nga një metodë e përbashkët e sigurisë (CSM);

b) nëse rregullat operative të rrjetit hekurudhor nuk janë mbuluar ende nga kushtet teknike të ndërveprimit (TSI);

c) si një masë urgjente parandaluese, në veçanti pas një aksidenti ose incidenti;

ç) nëse një rregull kombëtar i sigurisë, tashmë i njoftuar, duhet të rishikohet. Nëse rregullat në lidhje me kërkesat për personelin që kryen detyra kritike të sigurisë hekurudhore, përfshirë kriteret e përzgjedhjes, gjendjen fizike dhe psikologjike dhe trajnimin profesional, nuk janë mbuluar ende nga kushtet teknike të ndërveprimit (TSI).



5. Ministria përgjegjëse për transportet konsultohet me të gjitha palët e interesit nëse kërkon që të paraqesë rregullat kombëtare të sigurisë në nivel më të lartë sesa objektivat e përbashkët të sigurisë (CST).

Neni 63

Klasifikimi i rregullave kombëtare

Me qëllim që të lehtësohet procedura për autorizimin e vënies në shërbim të mjeteve hekurudhore, rregullat kombëtare klasifikohen në përputhje me rregulloren për klasifikimin e tyre, të miratuar nga ministri përgjegjës për transportet.

Neni 64

Sistemet e administrimit të sigurisë (SMS)

1. Administruesit e infrastrukturës dhe sipërmarrësit hekurudhorë krijojnë sistemet e tyre të administrimit të sigurisë (SMS) për të garantuar që sistemi hekurudhor të arrijë të paktën objektivat e përbashkët të sigurisë (CST), në përputhje me rregullat kombëtare të sigurisë, të përshkruara në nenin 62, të këtij Kodi, dhe me kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në kushtet teknike të ndërveprimit (TSI), si dhe aplikimin e pjesëve përkatëse të metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM).

2. Sistemi i administrimit të sigurisë (SMS) përbëhet nga kërkesat apo elementet e përcaktuara si më poshtë:

a) një politikë të sigurisë hekurudhore, e miratuar nga drejtori i përgjithshëm që u komunikohet të gjithë punonjësve;

b) objektivat cilësorë dhe sasiorë të njësisë së mirëmbajtjes dhe të përmirësimit të sigurisë, si dhe planet e procedurat për arritjen e këtyre objektiveve;

c) procedurat për të përmbushur standardet teknike dhe funksionale ekzistuese, të reja e të ndryshuara, ose kërkesat e tjera të përcaktuara:

i) në kushtet teknike të ndërveprimit (TSI); ose

ii) në rregullat kombëtare të sigurisë, të referuara në nenin 62 të këtij Kodi; ose

iii) në rregullat e tjera përkatëse; ose

iv) në vendimet e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore dhe procedurat që sigurojnë përputhjen me këto standarde dhe kërkesat e tjera në të gjithë ciklin e punës së pajisjeve dhe aktiviteteve;

ç) procedura dhe metoda për identifikimin e risqeve, duke kryer vlerësimin e riskut dhe duke

zbatuar masa për kontrollin e riskut sa herë që një ndryshim i kushteve operative ose prezantim i një materiali të ri shkakton rreziqe të reja në infrastrukturë ose mbi operacionet;

d) ofrimi i programeve për trajnimin e personelit dhe sistemeve për të siguruar që është ruajtur kompetenca e stafit dhe detyrat e kryera në përputhje me rrethanat, duke përfshirë masa në lidhje me gjendjen fizike e psikologjike;

dh) masat për sigurimin e informacionit të mjaftueshëm brenda njësisë dhe, sipas rastit, ndërmjet njësisë që veprojnë në të njëjtën infrastrukturë;

e) procedurat dhe formatet për mënyrën se si informacioni i sigurisë dokumentohet dhe përcaktimi i procedurave për kontrollin e konfigurimit të informacionit të sigurisë;

ë) procedura për të garantuar se aksidentet, incidentet, aksidente të mundshme, si pasojë e goditjeve të paqëllimshme, dhe ngjarje të tjera të rrezikshme raportohen, investigohen dhe analizohen dhe marrja e masave të nevojshme parandaluese;

f) sigurimi i planeve për veprim në rast alarmi dhe informacioni, në rast emergjence, duke rënë dakord me autoritetet përkatëse publike;

g) dispozitat për auditimin e brendshëm periodik të sistemit të administrimit të sigurisë (SMS).

3. Sistemi i administrimit të sigurisë (SMS) u përshtatet tipit, shkallës, zonës së operacioneve dhe kushteve të tjera të aktivitetit të ndjekur. Ai garanton kontrollin e të gjitha rreziqeve të shoqëruara me aktivitetin e administruesit të infrastrukturës ose sipërmarrjes hekurudhore, përfshirë sigurimin e mirëmbajtjes, si dhe përdorimin e kontraktuesve.

4. Pa cenuar rregullat ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare të detyrimeve, sistemi i administrimit të sigurisë (SMS) merr gjithashtu parasysh, kur është e përshtatshme dhe e arsyeshme, rreziqet që lindin si rezultat i aktiviteteve nga grupe të tjera interesi të përmendura në dispozitat e këtij Kodi.

5. Sistemi i administrimit të sigurisë (SMS) përmban procedura dhe formate për dokumentacionin e informacionit të sigurisë dhe përcaktimin e procedurës për kontrollin e konfigurimit të informacionit të rëndësishëm të sigurisë.



Sistemet e administrimit të sigurisë (SMS) zhvillohen me synimin e bashkërendimit të procedurave të emergjencës të administruesit të infrastrukturës me të gjitha sipërmarrjet hekurudhore që operojnë për infrastrukturën e tij dhe me shërbimet e emergjencës, për të lehtësuar ndërhyrjen e shpejtë të shërbimeve të shpëtimit dhe me çdo palë tjetër që mund të përfshihej në një situatë emergjence. Për infrastrukturën ndërkufitare, bashkëpunimi ndërmjet administruesve përkatës të infrastrukturës lehtëson bashkërendimin dhe gatishmërinë e nevojshme të shërbimeve kompetente të emergjencës në të dyja anët e kufirit.

6. Sistemi i administrimit të sigurisë (SMS) i çdo administruesi të infrastrukturës merr parasysh efektet e operimeve nga sipërmarrës të ndryshëm hekurudhorë në rrjet, për të cilat hartohen rregullore për të lejuar të gjithë sipërmarrësit hekurudhorë të veprojnë në përputhje me kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) dhe rregullat kombëtare të sigurisë, si dhe me kushtet e përcaktuara në certifikatën e tyre të sigurisë. Sistemi i administrimit të sigurisë (SMS) për më tepër do të zhvillohet me qëllim të koordinimit të procedurave të emergjencës së administruesit të infrastrukturës me të gjitha sipërmarrjet hekurudhore që veprojnë në infrastrukturën e tij.

7. Para datës 31 maj të çdo viti, të gjithë administruesit e infrastrukturës dhe sipërmarrjet hekurudhore i paraqesin Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore një raport vjetor të sigurisë në lidhje me vitin pararendës kalendarik. Raporti i sigurisë përmban:

a) informacion për mënyrën se si përmbushen objektivat e përbashkët të sigurisë (CSI) të organizatës dhe rezultatet e planeve të sigurisë;

b) një përmbledhje të zhvillimit të treguesve të sigurisë kombëtare (CSI), në masën që është e rëndësishme për organizatat raportuese, sipas dispozitave të këtij Kodi;

c) rezultatet e auditimit të brendshëm të sigurisë;

ç) vërejtje mbi të metat dhe keqfunksionimet e operacioneve hekurudhore dhe administrimit të infrastrukturës që mund të jenë të rëndësishme për Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore, përfshirë një përmbledhje të informacionit të dhënë nga grupet përkatëse të interesit, dhe garantojnë që i gjithë legjislacioni i zbatueshëm është aplikuar në një mënyrë të hapur dhe jodiskriminuese, duke nxitur zhvillimin e një sistemi të vetëm të

transportit hekurudhor europian;

d) një raport për zbatimin e metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM) përkatëse.

KREU II

CERTIFIKIMI DHE AUTORIZIMI PËR SIGURINË

Neni 65

Certifikatat e sigurisë

1. Në mënyrë që të jepet qasje në infrastrukturën hekurudhore, sipërmarrësit hekurudhorë duhet të mbajnë certifikatën e sigurisë, siç parashikohet në këtë kre. Certifikata e sigurisë mund të mbulojë të gjithë rrjetin hekurudhor ose vetëm një pjesë të përcaktuar të tij.

Qëllimi i certifikatës së vetme të sigurisë është që të dëshmojë se sipërmarrja hekurudhore ka krijuar sistemin e saj të administrimit të sigurisë (SMS) dhe se ajo është në gjendje për të vepruar në mënyrë të sigurt në fushën e synuar të veprimtarisë.

2. Në kërkesën e saj për një certifikatë të vetme të sigurisë, sipërmarrja hekurudhore duhet të specifikojë llojin dhe shtrirjen e operacioneve hekurudhore që mbulohen në fushën e synuar të veprimtarisë.

3. Kërkesa për një certifikatë të vetme të sigurisë shoqërohet me një dosje, duke përfshirë dëshmi të dokumentuara se:

a) sipërmarrja hekurudhore ka krijuar sistemin e saj të administrimit të sigurisë (SMS), në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, dhe se plotëson kërkesat e përcaktuara në kushtet teknike të ndërveprimit (TSI), metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM) dhe objektivat e përbashkët të sigurisë (CSI) dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse, për të kontrolluar rreziqet dhe ofruar shërbime transporti në mënyrë të sigurt në rrjet;

b) sipërmarrja hekurudhore, kur është e zbatueshme, plotëson kërkesat e përcaktuara në rregullat kombëtare përkatëse të njoftuara.

4. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore lëshon certifikatën e vetme të sigurisë ose njofton aplikuesin mbi vendimin e tij negativ, brenda një kohe të paracaktuar e të arsyeshme dhe, në çdo rast, jo më shumë se 4 muaj pasi i gjithë informacioni i nevojshëm dhe çdo informacion shtesë i kërkuar të jenë paraqitur nga kërkuesi (aplikuesi). Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore zbaton masat praktike të procedurës së certifikimit



që duhet të krijohen në aktin përkatës, në zbatim të Kodit.

5. Agjencia lëshon një certifikatë të vetme të sigurisë për sipërmarrjet hekurudhore që kanë aktivitet në një ose më shumë shtete anëtare. Me qëllim që të nxjerrë një vërtetim të tillë, Agjencia:

a) vlerëson elementet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij neni;

b) dërgon menjëherë të gjithë dosjen e sipërmarrjes hekurudhore tek autoritetet kombëtare të sigurisë, të interesuara nga fusha e synuar e veprimtarisë, për një vlerësim të elementeve të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij neni.

Si pjesë e vlerësimeve të mësipërme, Agjencia dhe Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore autorizohen të kryejnë vizita dhe kontrolle në vendet e punës të sipërmarrjes hekurudhore, si dhe auditime dhe mund të kërkojnë informacion përkatës shtesë. Agjencia dhe Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore koordinojnë organizimin e vizitave të tilla, auditimeve dhe inspektimeve.

6. Brenda 1 muaji nga data e marrjes së një kërkesë për një certifikatë të vetme të sigurisë, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore njofton sipërmarrjen hekurudhore se dosja është e plotë ose kërkon informacion përkatës shtesë, duke vendosur një afat të arsyeshëm për këtë informacion. Në lidhje me përmbajtjen e plotë, rëndësinë dhe qëndrueshmërinë e dosjes, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mund të vlerësojë gjithashtu elementet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij neni.

7. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore merr parasysh plotësisht vlerësimet, sipas pikës 5, të këtij neni, para se të marrë vendimin e tij për lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë.

8. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore merr përgjegjësinë e plotë për çdo certifikatë të vetme të sigurisë që lëshon.

Neni 66

Autorizimi i sigurisë për administruesin e infrastrukturës

1. Në mënyrë që të lejohet për të administruar një infrastrukturë hekurudhore, administruesi i infrastrukturës duhet të marrë autorizimin e sigurisë nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

Autorizimi i sigurisë:

a) vërteton pranimin e sistemit të administrimit të sigurisë (SMS) nga administruesi i infrastrukturës, siç është përshkruar në nenin 64 dhe përmban përshkrimin që konfirmon pranimin e dispozitave të sistemit të administrimit të sigurisë (SMS) nga administratori i infrastrukturës, sipas përcaktimit të nenit 64 të këtij Kodi;

b) vërteton pranimin e rregullave nga administruesi i infrastrukturës për të përmbushur kërkesat specifike të nevojshme për projektimin e sigurt, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës hekurudhore, përfshirë, kur është e nevojshme, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të kontrollit të trafikut dhe sinjalizimit (CCS) dhe përmban përshkrimin që konfirmon pranimin e dispozitave të administruesit të infrastrukturës për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për projektim, mirëmbajtje dhe operim të sigurt të infrastrukturës hekurudhore, përfshirë, kur është e përshtatshme, mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit (CCS).

2. Autorizimi i sigurisë përsëritet me kërkesë nga administruesi i infrastrukturës në intervale që nuk i kalojnë pesë vitet. Ai do të jetë tërësisht ose pjesërisht i përditësuar kur janë bërë ndryshime thelbësore në infrastrukturë, në sinjalistikë apo mbi rregullat e operimit e të mirëmbajtjes së saj. Mbajtësi i autorizimit të sigurisë duhet pa vonesë të informojë Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore për të gjitha këto ndryshime.

Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mund të kërkojë që autorizimi i sigurisë të rishikohet pas ndryshimeve thelbësore në kuadrin rregullator të sigurisë.

Nëse Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore konstaton se një administrues i autorizuar i infrastrukturës nuk i plotëson kushtet për një autorizim të sigurisë, e shfuqizon autorizimin, duke dhënë arsyet për vendimet e tij.

3. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore informon ministrinë përgjegjëse për transportet brenda një muaji mbi autorizimet e sigurisë që janë lëshuar, rinovuar, ndryshuar apo revokuar. Ai duhet të tregojë emrin dhe adresën e administruesit të infrastrukturës, datën e emetimit të autorizimit, fushëveprimin dhe vlefshmërinë e autorizimit të sigurisë dhe, në rast të revokimit, arsyet për vendimin e tij.



Neni 67

Kërkesat e aplikimit që kanë të bëjnë me certifikimin e sigurisë dhe autorizimin e sigurisë

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore merr vendim për aplikimin për certifikatën e sigurisë ose autorizimin e sigurisë pa vonesë dhe në çdo rast jo më shumë se katër muaj pasi është dorëzuar i gjithë informacioni i nevojshëm dhe çdo informacion shtesë i kërkuar nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore. Nëse aplikuesit i kërkohet që të paraqesë informacion plotësues, ky informacion duhet të dorëzohet menjëherë.

2. Për të lehtësuar krijimin e sipërmarrjeve të reja hekurudhore dhe dorëzimin e aplikimeve nga sipërmarrjet hekurudhore nga shtete të tjera, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore jep udhëzime të detajuara për mënyrën e marrjes së një certifikate të sigurisë. Ai duhet të listojë të gjitha kërkesat që janë të përcaktuara për qëllime të pikës 2, të nenit 65, të këtij Kodi, dhe të japë të gjitha dokumentet përkatëse në dispozicion të aplikuesit.

Udhëzim i veçantë jepet për sipërmarrjet hekurudhore që aplikojnë për një certifikatë të sigurisë, në lidhje me shërbimet në një pjesë të caktuar të kufizuar të infrastrukturës, duke identifikuar veçanërisht rregullat që janë të vlefshme për pjesën e infrastrukturës në fjalë.

3. Një dokument udhëzues me kërkesat për certifikatat e sigurisë dhe listën e dokumenteve që duhet të dorëzohen vihet në dispozicion të aplikuesve pa pagesë. Të gjitha aplikimet për certifikatat e sigurisë duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.

Neni 68

Qasja ndaj qendrave të formimit profesional (QFP)

1. Formimi profesional i personelit hekurudhor që ushtron funksione sigurie bëhet në shkollat të licencuara. Licencën kanë të drejtë ta marrin administruesit e infrastrukturës, sipërmarrjet hekurudhore, si dhe trajnues publikë dhe privatë. Kontrolli për kushtet dhe cilësinë e formimit realizohet nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore. Kushtet për licencimin e shkollave të formimit të personelit hekurudhor që ushtron funksione sigurie miratohen me akt nënligjor nga ministri përgjegjës për transportet. Qendër formimi profesional për

sistemin hekurudhor mund të hapë çdo subjekt që provon aftësinë e realizimit nëpërmjet disponimit të një stafi të certifikuar tek Agjencia e Bashkimit Europian për Hekurudhat dhe që disponon mjetet dhe objektet e nevojshme për ta realizuar formimin, të cilat përcaktohen me një akt nënligjor.

2. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore siguron nëpërmjet kontrollit që ofrimi i shërbimeve të formimit dhe dhënia e certifikatave për formim plotësojnë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në kushtet teknike për ndërveprim (TSI) apo rregullat kombëtare të sigurisë, të përshkruara në nenin 63 të këtij Kodi.

Nëse shërbimet e formimit nuk përfshijnë daljen në provim dhe dhënien e certifikatave, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore krijon mundësinë nëpërmjet homologëve në vendet e tjera që të interesuarit të kenë qasje në certifikime të tilla, në qoftë se kjo është një kërkesë e certifikatës së sigurisë.

3. Sipërmarrësit hekurudhorë që aplikojnë për një certifikatë të sigurisë kanë të drejtë qasjeje në mënyrë jodiskriminuese në shkollat e formimit për makinistët dhe personelin shoqëruar të trenave, sa herë që një formim i tillë është i nevojshëm për përmbushjen e kërkesave për të marrë certifikatën e sigurisë.

Administruesit e infrastrukturës dhe stafi i tyre që kryejnë detyrat e sigurisë kanë qasje të drejtë dhe jodiskriminuese në shkollat e formimit.

4. Në shërbimet e ofruara për formim përfshihen dhënia e njohurive të nevojshme për vijat hekurudhore, rregullat dhe procedurat operative, sistemin e kontroll-komandë-sinjalizimit (CCS) dhe kontrollit, si dhe procedurat emergjente që zbatohen në rrugëkalimet që do të operojnë.

5. Nëse krijohen qendra formimi profesional dhe ato janë në dispozicion vetëm për shërbimet e një sipërmarrësi hekurudhor ose të një administruesi të infrastrukturës, disponuesi i qendrës e vendos atë në dispozicion të sipërmarrësve të tjerë me një çmim të arsyeshëm dhe jodiskriminues, që është i lidhur me kostot dhe mund të përfshijë një marzh fitimi.

6. Kur rekrutojnë makinistë të rinj, stafin për bordin e trenit dhe stafin që kryen detyrat e sigurisë, sipërmarrjet hekurudhore marrin parasysh formimet, kualifikimet dhe përvojën e fituar më parë nga sipërmarrjet e tjera hekurudhore.



Për këtë qëllim, këta anëtarë të rinj të stafit kanë të drejtë të kenë qasje, të marrin kopje dhe t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet që dëshmojnë për formimin e tyre, kualifikimet dhe përvojat e punës.

7. Në çdo rast, çdo sipërmarrës hekurudhor dhe administrues i infrastrukturës është përgjegjës për nivelin e formimit e të kualifikimit të stafit të tij që kryen punë që lidhet me sigurinë, siç është përcaktuar në nenin 64, të këtij Kodi, me kontrollin e aftësive të tyre.

KREU III AUTORITETI I SIGURISË HEKURUDHORE

Neni 69 Detyrat

Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore krijohet me ligj si organi përgjegjës për të siguruar që niveli i sigurisë hekurudhore mbahet dhe përmirësohet vazhdimisht. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore zotëron kapacitetin e nevojshëm organizativ për sa u përket burimeve njerëzore dhe materiale. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore është i pavarur në drejtim të organizimit, strukturës ligjore, administrimit, kryerjes së detyrave dhe në vendimmarrje nga çdo sipërmarrje hekurudhore, administrues i infrastrukturës, aplikues apo ente të prokurimit, subjekte aplikuese ose kontraktuese, si dhe nga çdo subjekt që jep kontrata të shërbimit publik.

Neni 70 Mbikëqyrja

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mbikëqyr në vazhdimësi pajtueshmërinë me detyrimet ligjore të sipërmarrjeve hekurudhore dhe administruesve të infrastrukturës për sa i përket përdorimit të një sistemi të administrimit të sigurisë (SMS).

Për këtë qëllim, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore zbaton parimet e përcaktuara në metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM) përkatëse për sa i përket mbikëqyrjes së referuar në shkronjën “c”, të pikës 4, të nenit 60, të këtij Kodi, për të siguruar që aktivitetet e mbikëqyrjes të përfshijnë, në veçanti, kontrollin e zbatimit, nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administruesit e infrastrukturës, të masave përkatëse për:

a) sistemin e administrimit të sigurisë (SMS) për të monitoruar efektivitetin e vet;

b) elementet individuale ose të pjesshme të sistemit të administrimit të sigurisë (SMS), përfshirë aktivitetet operative, furnizimin e mirëmbajtjes dhe materialeve dhe përdorimin e kontraktuesve për të monitoruar efektivitetin e tyre;

c) metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM) përkatëse, të referuara në nenin 60 të këtij Kodi. Aktivitetet e mbikëqyrjes në lidhje me këtë pikë zbatohen, sipas rastit, edhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen.

2. Sipërmarrjet hekurudhore duhet të informojnë Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore të paktën 2 muaj para se të fillojnë një operacion të ri të transportit hekurudhor, në mënyrë që t'i lejojnë këtij të fundit të planifikojë aktivitetet mbikëqyrëse. Sipërmarrjet hekurudhore duhet gjithashtu të japin një ndarje të kategorive të personelit dhe të llojeve të mjeteve.

3. Mbajtësi i një certifikate të vetme të sigurisë informon Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore pa vonesë për çdo ndryshim madhor në informacionin e referuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Monitorimi i pajtueshmërisë me rregullat e punës në fuqi, të drejtimit dhe kohës së pushimit për makinistët e trenave sigurohet nga autoritetet kompetente të caktuara nga shteti. Kur monitorimi i pajtueshmërisë nuk sigurohet nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, autoritetet kompetente bashkëpunojnë me Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore, me qëllim që ta lejojnë atë të përmbushë rolin e tij të mbikëqyrjes së sigurisë hekurudhore.

5. Nëse gjatë mbikëqyrjes, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore identifikon një rrezik serioz të sigurisë, ai mund të zbatojë në çdo kohë masa të përkohshme të sigurisë, përfshirë kufizimin ose pezullimin e menjëhershëm të operacioneve përkatëse. Nëse certifikata e vetme e sigurisë është lëshuar nga Agjencia, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore informon menjëherë Agjencinë dhe vë në dispozicion prova mbështetëse për vendimin e saj.

6. Nëse Agjencia konstaton se mbajtësi i një certifikate të vetme të sigurisë nuk i plotëson kushtet për certifikim, ajo menjëherë kufizon ose revokon këtë certifikatë.

7. Nëse Agjencia konstaton se masat e dhëna nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore nuk janë në përputhje me gjendjen reale, ajo mund t'i kërkojë këtij Autoriteti të tërhiqet ose të përshtatë masat e



dhëna. Agjencia dhe Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore bashkëpunojnë me synimin e arritjes së një zgjidhjeje të pranueshme. Kur është e nevojshme, ky proces përfshin edhe sipërmarrjen hekurudhore. Nëse kjo procedurë e fundit dështon, mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore për zbatimin e masave të përkohshme.

8. Vendimi i Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore në lidhje me masat e përkohshme të sigurisë i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor kombëtar, siç referohet në pikën 3, të nenit 71, të këtij Kodi. Në një rast të tillë, masat e përkohshme të sigurisë mund të zbatohen deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, pa cenuar përcaktimin e bërë në pikën 5 të këtij neni.

9. Nëse kohëzgjatja e një mase të përkohshme është më shumë se 3 muaj, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore i kërkon Agjencisë të kufizojë ose të shfuqizojë certifikatën e vetme të sigurisë dhe të zbatojë procedurën e përcaktuar në pikën 5 të këtij neni.

10. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mbikëqyr nënsistemet e kontrollit, komandimit dhe sinjalizimit të rrugëkalimit, të energjisë dhe infrastrukturës për të siguruar se ato janë në përputhje me kërkesat thelbësore. Në rastin e infrastrukturave ndërkuftare, ai i kryen aktivitetet e tij të mbikëqyrjes në bashkëpunim me autoritetet e tjera përkatëse kombëtare të sigurisë. Nëse Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore konstaton se një administrues i infrastrukturës nuk i plotëson më tej kushtet për autorizimin e vet të sigurisë, autoriteti kufizon ose revokon këtë autorizim, duke dhënë dhe arsyet përkatëse për vendimin e tij.

11. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mund të adresojë njoftime për paralajmërimin e administruesve të infrastrukturës dhe të sipërmarrjeve hekurudhore në rastet e mosrespektimit të detyrimeve të tyre, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

12. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore e përdor informacionin e mbledhur nga Agjencia, gjatë vlerësimit të dosjes së përmendur në shkronjën “a”, të pikës 3, të nenit 65, të këtij Kodi, për qëllime të mbikëqyrjes së një sipërmarrjeje hekurudhore pas lëshimit të certifikatës së saj të vetme të sigurisë, përdor të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të autorizimit të sigurisë, për qëllime të mbikëqyrjes së administruesit të infrastrukturës.

13. Për qëllime të rinovimit të certifikatave të vetme të sigurisë, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore ose Agjencia, në rastin e një certifikate të sigurisë, të lëshuar në përputhje me nenin 65, të këtij Kodi, e përdorin informacionin e mbledhur gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes. Për qëllim të rinovimit të autorizimeve të sigurisë, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore e përdor informacionin e grumbulluar gjatë aktiviteteve të tyre të mbikëqyrjes.

14. Agjencia dhe Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore kryejnë rregullimet e nevojshme për të koordinuar dhe për të siguruar shkëmbimin e plotë të informacionit të përmendur në pikat 11, 12 dhe 13 të këtij neni.

Neni 71

Parimet e vendimmarrjes

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore kryen detyrat e tij në mënyrë të hapur, jodiskriminuese dhe transparente. Në veçanti, lejon të gjitha palët që të dëgjohen dhe të japin arsye të vendimet e tij.

Ai u përgjigjet menjëherë kërkesave të aplikuesve e komunikon kërkesat e tij për informacion shtesë pa vonesë dhe miraton të gjitha vendimet e tij brenda katër muajve pasi i kanë dhënë të gjitha informacionet e kërkuara. Ai mund të kërkojë në çdo kohë asistencë teknike prej administruesve të infrastrukturës dhe sipërmarrësve hekurudhorë apo nga organe të tjera të kualifikuara kur ai është duke kryer detyrat e tij të përmendura në dispozitat e këtij Kodi.

Në procesin e hartimit të kuadrit rregullator kombëtar (rregulloret dhe udhëzimeve për zbatim), Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore konsultohet me të gjithë personat e përfshirë dhe palët e interesuara, përfshirë administruesit e infrastrukturës, sipërmarrësit hekurudhorë, prodhuesit dhe ofruesit e mirëmbajtjes, përdoruesit edhe përfaqësuesit e punëmarrësve.

2. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore ka të drejtë të kryejë të gjitha inspektimet, auditimet dhe investigimet që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij dhe atij i jepet qasje në të gjitha dokumentet dhe objektet, instalimet dhe pajisjet e administruesve të infrastrukturës dhe sipërmarrësve hekurudhorë. Ai ka të njëjtat të drejta lidhur me sipërmarrjet hekurudhore, kur ai kryen detyrat e tij të certifikimit të sigurisë, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.



3. Vendimet e marra nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore janë subjekt i shqyrtimit gjyqësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore shkëmben pikëpamje dhe eksperiencë me homologët e vet të vendeve të tjera, me qëllim harmonizimin e kritereve të vendimmarrjeve të tyre. Bashkëpunimi i tyre ka qëllim të veçantë lehtësimin dhe koordinimin e certifikimit të sigurisë së sipërmarrësve hekurudhorë, të cilëve u jepet rrugëkalim hekurudhor ndërkombëtar.

Sipas rastit, autoritetet e sigurisë hekurudhore kërkojnë mbështetjen e Agjencisë në realizimin e kësaj detyre.

Neni 72 Raporti vjetor

1. Çdo vit, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore publikon një raport vjetor lidhur me aktivitetet e tij në vitin paraardhës, të cilin ia dërgon ministrit përgjegjës për transportet, deri më 30 shtator, dhe Agjencisë së Bashkimit Europian për Hekurudhat.

2. Raporti vjetor i Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore përmban informacion për:

a) zhvillimin e sigurisë hekurudhore, përfshirë edhe një bashkim në nivel kombëtar dhe europian të treguesve të përbashkët të sigurisë (CSI), në përputhje me pikën 1 të nenit 59, të këtij Kodi;

b) ndryshime të rëndësishme në legjislacionin dhe rregulloret në lidhje me sigurinë hekurudhore;

c) zhvillimin e certifikimit të sigurisë dhe autorizimit të sigurisë;

ç) rezultatet dhe përvojën në lidhje me mbikëqyrjen e administruesve të infrastrukturës dhe sipërmarrjeve hekurudhore, përfshirë numrin dhe rezultatet e inspektimeve e të auditimeve;

d) përjashtimet e vendosura në përputhje me nenin 15 të këtij Kodi;

dh) përvojën e sipërmarrjeve hekurudhore e të administruesve të infrastrukturës në zbatimin e metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM) përkatëse.

KREU IV INVESTIGIMI I AKSIDENTEVE DHE INCIDENTEVE HEKURUDHORE

Neni 73 Detyrimi për të investiguar

1. Pas çdo aksidenti të rëndë në sistemin hekurudhor, Autoriteti Kombëtar i Investigimit të

Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore kryen investigimin. Qëllimi i investigimit është për të përmirësuar, kur është e mundur, sigurinë hekurudhore dhe parandalimin e aksidenteve e të incidenteve.

2. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore mund të investigojë ato aksidente dhe incidente, të cilat, në kushte disi më të ndryshme, mund të kishin shkaktuar aksidente të rënda, përfshirë edhe defektet teknike të nënsistemeve strukturore ose funksionale apo të përbërësve të ndërveprimit të sistemit hekurudhor.

Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore vendos nëse një investigim i tillë për një aksident ose incident të ndërmerret ose jo. Në vendimin e tij Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve duhet të marrë parasysh:

a) shkallën e aksidentit ose incidentit;

b) nëse ai është pjesë e një serie aksidentesh apo incidentesh përkatëse të sistemit në tërësi;

c) ndikimin e tij në sigurinë hekurudhore;

ç) kërkesat nga administruesit e infrastrukturës, nga sipërmarrjet hekurudhore, nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

3. Shtrirja e investigimeve dhe procedura që duhet të ndiqet për kryerjen e investigimeve përcaktohet nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, duke marrë parasysh nenet 21 e 23, të këtij Kodi, dhe në varësi të mësimave që pritet të nxirren nga aksidenti ose incidenti për përmirësimin e sigurisë.

4. Në asnjë rast nuk duhet që investigimi të merret me caktimin e fajit apo përgjegjësisë.

Neni 74 Statusi i investigimit

1. Shteti, në kuadrin e sistemit të tij përkatës ligjor, përcakton statusin ligjor të investigimit, specifikisht u mundëson investiguesve në detyrë kryerjen e detyrës së tyre në mënyrë sa më efektive dhe në kohën më të shkurtër.

2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetet përgjegjëse ofrojnë bashkëpunim të plotë, sipas kërkesës, marrëveshje apo memorandum të bashkëpunimit për çdo procedurë hetimore. Investiguesve përgjegjës u mundësohet akses sa më i shpejtë dhe informacion e prova të lidhura me investigimin. Në veçanti, atyre u jepet:



a) akses i menjëhershëm në vendin e aksidentit ose incidentit, si dhe në mjetet hekurudhore të përfshira në instalimet përkatëse të infrastrukturave, kontrollit të trafikut dhe të sinjalizimit;

b) e drejta për një listim të menjëhershëm të provave dhe heqjes së kontrolluar të mbetjeve, instalimeve të infrastrukturës ose komponentëve për shqyrtim ose për qëllime analizash;

c) akses i pakufizuar dhe për përdorim të përmbajtjes së regjistruarve e të pajisjeve që ndodhen në bord për regjistrimin e mesazheve verbale dhe regjistrimin e operacionit të sistemit të sinjalizimit e të kontrollit të trafikut (CCS);

ç) akses në rezultatet e ekzaminimit të trupave të viktimave;

d) akses në rezultatet e ekzaminimeve të personelit të trenit dhe të personelit tjetër hekurudhor të përfshirë në aksident ose incident;

dh) mundësi për marrjen në pyetje të personelit hekurudhor të përfshirë në aksident ose incident dhe të dëshmitarëve të tjerë;

e) akses në çdo informacion të nevojshëm ose regjistrime të mbajtura nga administruesi i infrastrukturës, sipërmarrjet hekurudhore, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, si dhe autoriteti kombëtar përkatës i sigurisë hekurudhore.

3. Agjencia bashkëpunon me Autoritetin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore kur investigimi përfshin mjetet e autorizuar nga Agjencia apo sipërmarrjet hekurudhore të certifikuar nga Agjencia. Ajo paraqet, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjithë informacionin ose të dhënat e kërkuara nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe jep shpjegimet përkatëse, kur kërkohet.

4. Investigimi kryhet në mënyrë të pavarur nga çdo hetim gjyqësor.

Neni 75

Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore

1. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore krijohet me ligj, në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Qëllimi i investigimit është përmirësimi, kur është e mundur, i sigurisë hekurudhore në funksion të parandalimit të aksidenteve e të incidenteve.

2. Investigimi bëhet pas ndodhjes së ngjarjes së pretenduar si aksident ose incident hekurudhor.

3. Shtrirja kohore dhe procedura që ndiqet në kryerjen e investigimeve përcaktohen nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, duke marrë parasysh rrethanat objektive të ngjarjes, por gjithmonë jo më shumë se 1 vit.

4. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore nuk përcakton fajtorin dhe përgjegjësinë.

5. Investigimi i aksidenteve dhe incidenteve kryhen nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, i cili përbëhet të paktën nga një investigues i aftë për të kryer funksionin e investiguesit në detyrë në rastet e një aksidenti ose incidenti. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore është i pavarur në organizimin, strukturën ligjore dhe vendimmarrjen e tij nga administruesi i infrastrukturës, sipërmarrja hekurudhore, organi ngarkues, organi caktues dhe organi i vlerësimit të përputhshmërisë, si dhe nga çdo palë tjetër, interesat e të cilave mund të bien ndesh me detyrat që i janë besuar këtij Autoriteti. Gjithashtu, Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore është i pavarur nga funksioni i Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, nga Agjencia dhe çdo autoritet rregullator hekurudhor.

6. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore kryen detyrat e tij në mënyrë të pavarur nga subjektet e tjera të përmendura në pikën 1, të këtij neni, dhe duhet të jetë i aftë të marrë burime të mjaftueshme për ta bërë këtë. Investiguesve të këtij Autoriteti u jepet statusi duke u dhënë atyre garancitë e nevojshme të pavarësisë.

7. Sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës dhe, kur është e përshtatshme, edhe Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore janë të detyruara të njoftojnë Autoritetin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore menjëherë për aksidentet dhe incidentet dhe të vënë në dispozicion të tij të gjithë informacionin që disponojnë. Kur është e përshtatshme, ky njoftim përditësohet sa më shpejt me informacione të reja që vihen në dispozicion.

Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore vendos



pa vonesë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së njoftimit të aksidentit ose incidentit, nëse investigimi duhet të fillojë apo jo.

8. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore mund të kombinojë detyrat e tij me punën e investigimit të dukurive të ndryshme nga aksidentet dhe incidentet hekurudhore për sa kohë që investigime të tilla të tjera nuk rrezikojnë pavarësinë e tij.

9. Nëse është e nevojshme dhe me kusht që të mos dëmtohet pavarësia e tij, Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kombëtar të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve nga shtete të tjera ose nga Agjencia për kryerjen e ekspertizës ose inspektimeve, analizave apo vlerësimeve teknike.

10. Organet homologe të shteteve të tjera mund t'i kërkojnë Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore edhe kryerjen e investigimit të aksidenteve dhe incidenteve të tjera hekurudhore, të ndryshme nga ato të përmendura në nenin 73 të këtij Kodi.

11. Autoritetet kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore zbatojnë një shkëmbim aktiv të pikëpamjeve dhe përvojës për qëllime të zhvillimit të metodave të përbashkëta të investigimit, të hartimit të parimeve të përbashkëta për zbatimin e rekomandimeve dhe përshtatjeve të sigurisë në zhvillimin e progresit teknik e shkencor.

Neni 76

Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore përcaktohet me ligj. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore është një autoritet i pavarur publik, që ka statusin e vet juridik në vendimmarrje dhe në kompetencat e tij të investigimit.

Neni 77

Bashkëpunimi me organet homologe

Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore kryen

bashkëpunim aktiv me organe homologe të shteteve të huaja, me qëllim zhvillimin e metodave të përbashkëta investiguese, hartimin e parimeve të përbashkëta për përcjelljen e rekomandimeve të sigurisë dhe përshtatjen në zhvillimin e progresit teknik dhe shkencor.

Neni 78

Procedura investiguese

1. Një aksident ose incident i përmendur në nenin 73, të këtij Kodi, investigohet nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore. Nëse ka ndodhur në kufi ose në afërsi të një instalimi kufitar midis dy shteteve, autoritetet përkatëse kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve bien dakord se cili prej tyre do të kryejë investigimin ose bien dakord për ta kryer atë në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Në rastin e parë, autoriteti kombëtar i investigimit të aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore i shtetit tjetër lejohet të marrë pjesë në investigim dhe të ndajë plotësisht rezultatet e tij.

Autoritetet kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve nga shteteve të tjera ftohen, nëse është e përshtatshme, për të marrë pjesë në një investigim, kur:

a) një sipërmarrje hekurudhore, e krijuar dhe e licencuar në një prej këtyre shteteve, është e përfshirë në aksident ose incident; ose

b) një mjet i regjistruar ose i mirëmbajtur në një prej këtyre shteteve është përfshirë në aksident ose incident.

2. Autoriteteve kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve të shteteve të ftuara u jepen kompetencat e nevojshme për t'u mundësuar, kur u kërkohet, për të ndihmuar në mbledhjen e provave për autoritetin kombëtar të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore të një shteti tjetër.

3. Autoriteteve kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve të shteteve të ftuara u jepet akses në informacionin dhe provat e nevojshme që ata të marrin pjesë në mënyrë efektive në investigime, duke respektuar ligjet kombëtare në lidhje me procedurat gjyqësore.

4. Kjo pikë nuk i përjashton shtetet e tjera nga rënia dakord që autoritetet kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve të kryejnë investigime në bashkëpunim me njëri-tjetrin në rrethana të tjera.



5. Për çdo aksident ose incident Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore organizon mjetet e nevojshme që përfshijnë ekspertizën e nevojshme funksionale dhe teknike për të kryer investigimin. Ekspertiza mund të merret nga brenda ose jashtë organit, në varësi të karakterit të aksidentit ose incidentit që investigohet.

6. Investigimi kryhet me transparencën më të gjerë të mundshme, në mënyrë që të gjitha palët të dëgjohen dhe të shkëmbejnë rezultatet. Administruesit të infrastrukturës dhe sipërmarrjet hekurudhore përkatëse, Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, Agjencisë, viktimave dhe të afërmve të tyre, pronarëve të pasurive të dëmtuara, prodhuesve, shërbimeve të përfshira të urgjencës dhe përfaqësuesve të personelit e përdoruesve të tjerë u jepet të gjithëve një mundësi për të dhënë informacionin e duhur teknik, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e raportit të investigimit. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore duhet të marrë gjithashtu parasysh nevojat e arsyeshme të viktimave dhe të të afërmve të tyre dhe t'i mbajë ata të informuar për progresin e bërë në investigim.

Ai duhet të përfundojë shqyrtimin e tij në vendin e aksidentit në kohën më të shkurtër të mundshme, në mënyrë që t'i mundësojë administruesit të infrastrukturës të rivendosë infrastrukturën në gatishmëri dhe të rifillojë shërbimet e transportit hekurudhor sa më parë.

Neni 79

Marrëveshja për investigim me shtete të huaja

1. Aksidenti ose incidenti i pretenduar investigohet nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore. Sikurse në nenin 77, të këtij Kodi, kur kjo nuk është e mundur ose ngjarja ka ndodhur në/ose afërsi të kufirit me një shtet tjetër, autoritetet kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve, përkatësisht, bien dakord që një prej tyre të kryejë investigimin ose ta kryejnë në bashkëpunim. Në rastin kur investigimi vendoset të kryhet nga njëri prej autoriteteve kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore, autoriteti tjetër lejohet të marrë pjesë në investigim dhe të informohet plotësisht mbi rezultatet e tij.

2. Autoritetet kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve të huaja ftohen dhe marrin pjesë në investigim, kur sipërmarrësi hekurudhor i përfshirë në ngjarje është themeluar dhe licencuar në atë shtet.

Paragrafi i parë i kësaj pike nuk përjashton rastet e bashkëpunimit në rrethana të tjera.

Neni 80

Raportet

1. Investigimi i një aksidenti ose incidenti të përmendur në nenin 72, të këtij Kodi, është subjekt i raporteve në një formë të përshtatshme për llojin dhe seriozitetin e aksidentit ose incidentit dhe rëndësinë e gjetjeve të investigimit. Në këto raporte duhet të deklarohen objektivat e investigimeve, siç përmendet në nenin 72, të këtij Kodi, dhe ato duhet të përmbajnë, kur është e përshtatshme, rekomandime të sigurisë.

2. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore publikon raportin përfundimtar në kohën më të shkurtër të mundshme dhe normalisht jo më vonë se 12 muaj pas datës së ngjarjes. Nëse raporti përfundimtar nuk mund të bëhet publik brenda 12 muajve, autoritetet kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve lëshojnë një deklaratë të përkohshme të paktën në çdo përvjetor të aksidentit, duke evidentuar progresin e investigimit dhe çdo çështje që ngrihet për sigurinë. Raporti, përfshirë rekomandimet e sigurisë, u komunikohet palëve përkatëse, si dhe organeve e palëve të interesuara në shtetet e tjera anëtare.

3. Duke marrë parasysh përvojën e fituar nga autoritetet kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve, Komisioni Europian cakton, nëpërmjet akteve zbatuese, strukturën e raportimit që duhet të ndiqet nga sa më afër të jetë e mundur për raportet e investigimit të aksidenteve e të incidenteve. Kjo strukturë e raportimit duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të ngjarjes dhe informacion paraprak në lidhje me të;

b) një regjistrim të investigimeve e të kërkimeve, përfshirë sistemin e administrimit të sigurisë (SMS), rregullat dhe rregulloret në fuqi, funksionimin e mjeteve lëvizëse dhe instalimeve teknike, organizimin e burimeve njerëzore, dokumentet e sistemit operativ dhe dukuritë e mëparshme me karakter të ngjashëm;



c) analiza dhe konkluzione për shkaqet e ngjarjes, përfshirë faktorët kontribues në lidhje me:

i) veprimet e ndërmarra nga personat e përfshirë;

ii) gjendjen e mjeteve lëvizëse ose instalimeve teknike;

iii) aftësitë e personelit, procedurat dhe mirëmbajtjen;

iv) kushtet e kuadrit rregullator;

v) zbatimin e sistemit të administrimit të sigurisë (SMS).

Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit, të referuar në nenin 78 të këtij Kodi.

4. Më 30 shtator, çdo vit, Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore publikon një raport vjetor shpjegues për investigimet e kryera në vitin pararendës, rekomandimet e sigurisë që janë lëshuar, si dhe veprimet e ndërmarra në përputhje me rekomandimet e lëshuara më parë.

Neni 81

Informacioni që do të dërgohet në Agjenci

1. Brenda 7 ditëve pas vendimit për të hapur një investigim, Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore njofton Agjencinë. Informacioni duhet të tregojë datën, kohën dhe vendin e shfaqjes, llojin dhe pasojat e saj për sa i përket viktimave, të plagosurve dhe dëmeve materiale.

2. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore i dërgon Agjencisë së Bashkimit Europian për Hekurudhat një kopje të raportit përfundimtar, të përmendur në nenin 78, të këtij Kodi, dhe të raportit vjetor, të referuar në nenin 79 të këtij Kodi.

Neni 82

Rekomandimet e sigurisë

1. Një rekomandim për sigurinë, i lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, në asnjë rast, nuk krijon një përcaktim të fajit apo përgjegjësisë për aksidentet ose incidentet e ndodhura.

2. Rekomandimet i drejtohen Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore dhe, kur është e nevojshme, për shkak të karakterit të rekomandimit, i drejtohen edhe Agjencisë, organeve ose autoriteteve të tjera

kombëtare ose shteteve të tjera anëtare. Shtetet anëtare, autoritetet e tyre kombëtare të sigurisë dhe Agjencia, brenda kufijve të kompetencave të tyre, marrin masat e nevojshme për të garantuar që rekomandimet e sigurisë, të lëshuara nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, të merren siç duhet parasysh dhe, kur është e përshtatshme, të veprohet sipas rekomandimeve të tyre.

3. Agjencia, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe autoritetet ose organet e tjera ose, kur është e përshtatshme, shtetet e tjera, tek të cilat janë drejtuar rekomandimet, raportojnë në mënyrë periodike për masat që janë marrë apo planifikuar në vijim të një rekomandimi të dhënë.

PJESA E KATËRT TRANSPORTI HEKURUDHOR

KREU I REALIZIMI, LLOJET E TRANSPORTIT HEKURUDHOR

Neni 83

Realizimi i transportit hekurudhor

Transporti i udhëtarëve dhe/ose transporti i mallrave në trafikun hekurudhor kryhet si transport publik ose transport për nevoja të veta, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në këtë Kod.

Neni 84

Llojet e transportit hekurudhor

1. Transporti hekurudhor klasifikohet si:

a) transport ndërkombëtar hekurudhor i udhëtarëve dhe/ose i mallrave;

b) transport i brendshëm hekurudhor i udhëtarëve dhe/ose i mallrave;

c) transporti ndërkombëtar i kombinuar i mallrave;

ç) transport i brendshëm i kombinuar i mallrave.

2. Transporti i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kryhet në bazë të kontratës së transportit ndërmjet administruesit të infrastrukturës dhe sipërmarrësve (operatori transporti) hekurudhorë, përveçse nëse parashihet ndryshe në këtë Kod ose në ligje të tjera.

Neni 85

Transporti i brendshëm dhe ndërkombëtar i udhëtarëve dhe i mallrave

Transporti hekurudhor i brendshëm dhe ndërkombëtar, i parashikuar në nenin 84, të këtij



Kodi, mund të jetë transporti publik i udhëtarëve dhe transporti publik i mallrave me hekurudhë.

1. Transporti hekurudhor publik i udhëtarëve kryhet si:

- a) transport qytetas, për zonën qytetase;
- b) transport rrethqytetas, për zonën rrethqytetase dhe më gjerë;
- c) transport rajonal, për zonën e disa bashkive;
- ç) transport ndërkombëtar, për territorin e disa shteteve.

2. Transporti publik i mallrave kryhet si:

- a) transport rajonal, për zonën e disa bashkive;
- b) transport ndërkombëtar, për territorin e disa shteteve.

Neni 86

Transporti i kombinuar i mallrave

1. Transporti i kombinuar i mallrave realizohet me njësitë e transportit të mallrave ose mjeteve hekurudhore, rimorkio, gjysmërimorkio me ose pa mjet tërheqës ose një kontejner me një gjatësi të paktën gjashtë metra. Në fillim ose në fund të itinerarit, njësia e transportit të mallrave ngarkohet apo shkarkohet në terminal apo në një port, në një stacion hekurudhor të përshtatshëm, dhe gjatë transportit ai përdor rrugë, hekurudha, ujëra të brendshme apo linjat detare.

2. Në rastin e transportit të kombinuar të mallrave me njësitë e transportit të kombinuar të mallrave, sipërmarrësi hekurudhor përcakton në dokumentacion stacionet hekurudhore të ngarkimit e të shkarkimit për pjesën hekurudhore ose portet e ngarkimit e të shkarkimit për pjesën e transportit detar. Këto të dhëna regjistrohen para transportit dhe vërtetohen me vulat e administratave hekurudhore në stacionet hekurudhore ose të administratës së porteve në liqen ose në portet detare, kur ajo pjesë e udhëtimit është kryer në vijë hekurudhore, itinerare në ujërat e brendshme apo linja detare.

3. Të gjithë sipërmarrësit hekurudhorë dhe rrugorë, që kryejnë transport të kombinuar të mallrave me transport rrugor në nisje ose në mbërritje, mund, por nuk janë të detyruar, që të përfshijnë në dokumentacion pikën e kalimit kufitar.

Neni 87

Transporti për nevoja të veta

1. Transport për nevoja të veta është një transport i udhëtarëve dhe/ose i mallrave, të kryera nga administruesi i infrastrukturës, sipërmarrësi hekurudhor ose personat e tjerë juridikë, pronarët e mjeteve hekurudhore, për nevojat e tyre në rrejetin hekurudhor.

2. Transporti për nevoja të veta mund të kryhet nga personat juridikë për transportin e mallrave e të punëtorëve për nevojat e veta në vija të brendshme hekurudhore të tyre.

KREU II

TRANSPORTI HEKURUDHOR I UDHËTARËVE

Seksioni 1

Kushte të përgjithshme dhe tarifat

Neni 88

Rregullimi ligjor i transportit të udhëtarëve

1. Transporti hekurudhor i udhëtarëve dhe bagazheve kryhet sipas dispozitave të këtij Kodi.

2. Për të gjitha ato çështje që nuk rregullohen në këtë Kod, zbatohen dispozitat e Kodit Civil për kontratën e transportit.

Neni 89

Kushtet dhe detyrimet e sipërmarrësit hekurudhor

1. Sipërmarrësit hekurudhorë, të autorizuar dhe që marrin përsipër transportin e udhëtarëve dhe të bagazheve, janë të detyruar që t'u sigurojnë atyre të gjitha kushtet e nevojshme, para dhe gjatë udhëtimit, si dhe të sigurojnë ruajtjen e trajtimin e bagazheve.

2. Kushtet e realizimit të transportit hekurudhor të udhëtarëve e të bagazheve, përcaktimi i dispozitave specifike për kontratën e transportit, përfundimi dhe realizimi i kontratës së transportit, përcaktimi i përgjegjësive të transportuesit në raste të ndryshme të mosrealizimit të kontratës apo të humbjes e të dëmtimit të bagazheve, dhe përgjegjësitë e udhëtarit, rregullohen nga dispozitat e këtij Kodi dhe, për çështje që nuk gjejnë rregullim në të, nga dispozitat përkatëse të Kodit Civil.



Neni 90 Tarifat

1. Tarifat e shërbimit të transportit hekurudhor të udhëtarëve, që nuk përfshihet në skemën e detyrimit të shërbimit publik, përcaktohen nga sipërmarrësi hekurudhor në bazë të konkurrencës së lirë me llojet e tjera të transportit të udhëtarëve.

2. Tarifat e transportit të bagazheve, me përjashtim të kolive të dorës, përcaktohen nga sipërmarrësi hekurudhor.

3. Ministri përgjegjës për transportet dhe autoriteti kompetent, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë skemën e detyrimeve të shërbimit publik për shërbime kryesisht të udhëtarëve, të cilat, për arsye sociale, mjedisore dhe të menaxhimit të territorit, si dhe për disa kategori qytetarësh, kompensohen financiarisht nga Buxheti i Shtetit si shërbime me interes të përgjithshëm, por që sipërmarrësit hekurudhorë nuk i marrin përsipër si shërbime jofitimprurëse.

4. Kur një autoritet kompetent, nëpërmjet procedurave ligjore, i jep një sipërmarrësi hekurudhor të drejtën e realizimit të një shërbimi publik të transportit të udhëtarëve, marrëveshja lidhet në kuadrin e një kontrate të shërbimit publik.

Në këtë rast, tarifat e shërbimit hekurudhor të transportit të udhëtarëve përcaktohen nga plotësimi sa më i lartë i treguesve bashkëkohorë të këtij shërbimi dhe vlefë më e ulët për realizimin e këtyre treguesve.

Për të përcaktuar subjektin që plotëson këta tregues realizohet procedura ligjore nga ministria përgjegjëse për transportet, në bashkëveprim me autoritetin kompetent.

5. Kur një autoritet kompetent vendos t'i japë një sipërmarrësi hekurudhor të zgjedhur prej tij një të drejtë ekskluzive dhe/ose kompensim, të çfarëdo lloji, në këmbim të detyrimeve të shërbimit publik, në këtë rast tarifa e transportit hekurudhor të udhëtarëve i referohet udhëzimit të përbashkët, sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Në periudhën kalimtare, derisa të përcaktohet skema dhe procedura e detyrimeve të shërbimit publik, çmimet e biletave të udhëtimit për transportin hekurudhor të udhëtarëve miratohen nga ministri përgjegjës për transportet.

7. Këshilli i Ministrave, me vendim, përcakton shërbimet e interesit të përgjithshëm publik, parimet e kontratës së shërbimeve publike,

procedurat e tenderimit të ofrimit të shërbimeve publike, financimin e shërbimeve publike nga Buxheti i Shtetit apo i autoriteteve vendore.

Seksioni 2

Të drejtat dhe detyrimet e udhëtarëve në transportin hekurudhor

Neni 91

Kontrata e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve

Bileta e transportit përbën lidhjen dhe përmbajtjen e kontratës së transportit ndërmjet udhëtarit dhe sipërmarrësit hekurudhor. Ky i fundit merr përsipër dërgimin e udhëtarit dhe të bagazhit të tij në destinacionin e përcaktuar në biletë, sipas orarit të publikuar të lëvizjes së trenave.

Neni 92

Përjashtimi dhe kushtet e kufizimeve

1. Në përputhje me këtë Kod, në një kontratë transporti nuk mund të kufizohen detyrimet ndaj udhëtarëve, nuk mund të hiqet dorë prej tyre, si dhe nuk mund të parashikohet një shmangie, përjashtim apo klauzolë kufizuese.

2. Sipërmarrësit hekurudhorë mund të ofrojnë kushte më të favorshme në kontratën për udhëtarët sesa ato të përcaktuara në këtë Kod.

Neni 93

Detyrimi i informimit lidhur me ndërprerjen e shërbimeve

Sipërmarrësit hekurudhorë ose, nëse duhet, autoriteti kompetent përgjegjës për një kontratë hekurudhore të shërbimit publik duhet të bëjë publike vendimet e ndërprerjes së shërbimeve me anë të mjeteve të përshtatshme dhe para zbatimit të tyre.

Neni 94

Informacione mbi udhëtimit

1. Sipërmarrësit hekurudhorë dhe shitësit e biletave, duke ofruar bileta udhëtimit në emër të një ose më shumë sipërmarrësve hekurudhorë, i ofrojnë udhëtarëve para udhëtimit, me kërkesën e tyre, të paktën informacionin për:

a) kushtet e përgjithshme të zbatimit të kontratës;

b) oraret dhe kushtet për një udhëtim më të shpejtë;

c) oraret dhe kushtet për tarifat më të ulëta;



c) mundësinë, kushtet e hyrjes dhe disponibilitet në tren të pajisjeve për personat me aftësi dhe lëvizshmëri të kufizuar;

d) mundësinë dhe kushtet e hyrjes së biçikletave;

dh) vendet e qëndrimit në zonat e rezervuara;

e) aktivitetet që mund të ndërpresin ose të vonojnë shërbimet;

ë) disponibilitetin e shërbimeve në bordin e trenave;

f) procedurat e reklamimit të bagazheve të humbura;

g) procedurat e depozitimit të ankesave.

2. Sipërmarrësit hekurudhorë u sigurojnë udhëtarëve gjatë udhëtimit informacionet për:

a) shërbimin që ofrohet në bordin e trenave;

b) stacionin vijues;

c) vonesat;

ç) korrespondencat kryesore;

d) çështjet që lidhen me sigurinë.

3. Informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, ofrohet në formën më të përshtatshme. Vëmendje e veçantë në këtë drejtim u kushtohet personave që janë me dëmtime të shikimit ose të dëgjimit.

Neni 95

Vlefshmëria e biletave dhe rezervimet

1. Sipërmarrësit hekurudhorë dhe shitësit e biletave ofrojnë bileta udhëtimi dhe bëjnë rezervime.

2. Pa cenuar pikën 3, të këtij neni, sipërmarrësit hekurudhorë shpërndajnë biletat për udhëtarët me të paktën një nga mënyrat e mëposhtme të shitjes:

a) sportelet ose makinat automatike;

b) telefon, internet apo çdo teknologji tjetër e përdorur gjerësisht;

c) në trena gjatë lëvizjes.

3. Sipërmarrësit hekurudhorë ofrojnë mundësinë për të marrë bileta për shërbimin përkatës në bordin e trenit, veç nëse kjo mundësi kufizohet ose refuzohet në vende të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, për arsye që lidhen me sigurinë ose luftën kundër mashtimit, të arsyeve të rezervimit të detyrueshëm të trenit apo për shkaqe të arsyeshme tregtare.

4. Kur në stacionin e nisjes nuk ka zyrë ose makinë për të shitur bileta, atëherë udhëtarët duhet të informohen në stacion lidhur me procedurën e blerjes së biletave.

Neni 96

Asistenca ndaj udhëtarëve

1. Në rastin e një vonese në mbërritje ose në nisje, sipërmarrësi hekurudhor ose administruesi i infrastrukturës informojnë udhëtarin për situatën, si dhe për orën e nisjes apo të mbërritjes së parashikuar, nëse këto informacione ai i disponon.

2. Në rast se treni është bllokuar në vijën hekurudhore ose në stacionin hekurudhor, udhëtarëve u ofrohet transporti nga vendndalimi i trenit deri në pikën e nisjes apo në stacionin e destinacionit final të shërbimit, nëse kjo është e mundur.

3. Në rast se shërbimi hekurudhor nuk mund të vazhdohet më, sipërmarrësit hekurudhorë organizojnë sa më shpejt të jetë e mundur shërbimet alternative të transportit të udhëtarëve.

4. Sipërmarrësi hekurudhor, me kërkesë të udhëtarit, vërteton në biletë se shërbimi hekurudhor, për të cilin ai ka marrë biletë direkt, ka pësuar një vonesë, ka çuar në një lidhje të humbur ose që është anuluar.

5. Në zbatimin e pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, sipërmarrësit hekurudhorë në fjalë i kushtojnë vëmendje të veçantë nevojave të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar dhe çdo personi që i shoqëron ata.

Neni 97

E drejta për transport e personave me aftësi të kufizuara dhe e personave me lëvizshmëri të reduktuar

1. Sipërmarrësit hekurudhorë dhe administruesit e stacioneve hartojnë dhe zbatojnë rregulla për pjesëmarrjen jodiskriminuese në transport të personave me aftësi të kufizuara dhe të personave me lëvizshmëri të reduktuar, në konsultim me organizatat që i përfaqësojnë ata.

2. Sipërmarrësi hekurudhor dhe shitësi i biletave nuk mund të refuzojnë rezervimin ose shitjen e një bilete për një person me aftësi të kufizuar ose një personi me lëvizshmëri të reduktuar. Në varësi të kushteve specifike, ata mund të kërkojnë që një person i tillë të shoqërohet nga një person tjetër.

3. Me kërkesë, një sipërmarrës hekurudhor apo një shitës biletash duhet t'u sigurojë personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar informacion për mundësinë e



shërbimeve hekurudhore dhe kushtet e hyrjes në mjetet lëvizëse.

4. Kur një sipërmarrës hekurudhor ose shitës i biletave nuk mund të zbatojë rregullat e parashikuara në këtë nen, ata duhet të informojnë me shkrim personin me aftësi të kufizuara apo personin me lëvizshmëri të reduktuar për arsyet në fjalë, brenda pesë ditëve pune nga refuzimi për të bërë rezervimin ose për të dhënë biletën ose imponimi për të qenë i shoqëruar.

5. Pa prekur rregullat që i referohen këtij neni, sipërmarrësit hekurudhorë duhet t'u sigurojnë personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar ndihmë falas në stacionet hekurudhore dhe në bordin e një treni, gjatë hipjes dhe zbritjes nga treni.

Neni 98

Mundësitë e hyrjes në mjediset hekurudhore

1. Sipërmarrësit hekurudhorë dhe administruesit e stacioneve, në përputhje me standardet e hartuara apo të parashikuara nga standardet ndërkombëtare për transportin e personave me aftësi të kufizuara dhe me lëvizshmëri të reduktuar sigurojnë që stacionet, platformat, vagonët dhe objektet e tjera të kenë kushte të nevojshme për pranimin e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar.

2. Në mungesë të stafit shoqëruar në bordin e një treni apo në stafin e një stacioni, sipërmarrësit hekurudhorë dhe administruesit e stacioneve bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të mundësuar që personave me aftësi të kufizuara ose personave me aftësi të reduktuar t'u mundësohet udhëtimi me hekurudhë.

Neni 99

Siguria personale e udhëtarëve

Sipërmarrësit hekurudhorë, administruesit e infrastrukturës dhe administruesit e stacioneve marrin masat e duhura, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, për të garantuar lëvizjen e sigurt të udhëtarëve në stacionet hekurudhore dhe në trena dhe për të administruar rreziqet. Ata bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacione për praktikatat më të mira në lidhje me parandalimin e veprimeve, të cilat mund të përkeqësojnë nivelin e sigurisë.

Neni 100

Ankesat

1. Sipërmarrësit hekurudhorë janë të detyruar që të publikojnë procedurën për trajtimin e ankesave, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e udhëtarëve të përcaktuara në këtë Kod.

2. Udhëtarët mund të paraqesin ankesën te sipërmarrësi hekurudhor. Brenda një muaji, marrësi i ankesës jep një përgjigje të arsyetuar mbi të gjitha çështjet e trajtuara në të.

3. Sipërmarrësit hekurudhorë, në raportin vjetor që i referohet nenit 101, pika 2, publikojnë numrin dhe kategoritë e ankesave të marra, ankesat e trajtuara, afatet e përgjigjeve dhe veprimet e ndërmarra për përmirësimin e situatës.

Neni 101

Standarde të cilësisë së shërbimit

1. Sipërmarrësit hekurudhorë përcaktojnë standardet e cilësisë së shërbimit dhe zbatojnë një sistem të administrimit të cilësisë për ta ruajtur këtë cilësi. Standardet e cilësisë së shërbimit të paktën duhet të mbulojnë çështje, si:

a) informacionet dhe biletat;

b) përpikëria e shërbimeve dhe parimet e përgjithshme për të kapërcyer çrregullimet e shërbimeve;

c) anulimet e shërbimeve;

ç) pastërtia e mjeteve lëvizëse dhe e mjedisëve të stacioneve (cilësia e ajrit në vagonë, higjiena e pajisjeve sanitare etj.);

d) evidentimi i plotësimit të kërkesave të udhëtarëve;

dh) trajtimi i ankesave, rimbursimet, kompensimet në rastin e mosrespektimit të standardeve të cilësisë së shërbimit;

e) asistencë në rastin e personave me aftësi të kufizuara dhe e personave me lëvizshmëri të reduktuar.

2. Sipërmarrësit hekurudhorë monitorojnë punën e tyre sipas standardeve të cilësisë së shërbimit. Ata publikojnë çdo vit një raport vlerësimi mbi ecurinë cilësisë së tyre të shërbimit, së bashku me raportin e tyre vjetor. Raportet mbi ecurinë e cilësisë së shërbimit publikohen në faqen e internetit të sipërmarrësve hekurudhorë.



Neni 102

Informacione për udhëtarët mbi të drejtat e tyre

1. Kur shesin bileta për udhëtimet me hekurudhë, sipërmarrësit hekurudhorë dhe administruesit e stacionit informojnë udhëtarët për të drejtat dhe detyrimet e tyre, sipas këtij Kodi.

2. Sipërmarrësit hekurudhorë dhe administruesit e stacioneve informojnë udhëtarët në stacion dhe në tren për detajet e kontaktit, lidhur me ankimet për cilësinë e shërbimit.

Neni 103

Zbatimi

1. Autoriteti rregullator është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi. Ai merr masat e nevojshme për të siguruar që të drejtat e udhëtarëve të respektohen.

2. Çdo udhëtar mund të ankohet tek organi përkatës, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, ose në ndonjë organ tjetër përkatës, të caktuar nga ministri, në lidhje me një shkelje të dyshuar të këtij Kodi.

KREU III

TRANSPORTI HEKURUDHOR I MALLRAVE

Neni 104

Natyra dhe funksionimi

1. Transporti hekurudhor i mallrave është veprimtaria hekurudhore për qarkullimin e lëndëve të para, të produkteve bujqësore dhe industriale, i makinerive dhe pajisjeve, në funksion të prodhimit, tregtisë, konsumit, shërbimeve dhe për nevoja shtetërore të personave fizike dhe juridikë.

2. Sipërmarrësit hekurudhorë, publikë e privatë, të pajisur me licencën përkatëse për realizimin e transportit hekurudhor të mallrave, e kryejnë këtë shërbim në kushte të konkurrencës së lirë ndërmjet tyre dhe me llojet e tjera të transportit.

Neni 105

Rregullimi ligjor i transportit të mallrave

1. Detyrimet e ndërsjella të sipërmarrësve hekurudhorë, të nisësve dhe pritësve të mallrave përcaktohen në kontratën e transportit, e cila hartohet në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi.

2. Kushtet e realizimit të transportit hekurudhor të mallrave, përcaktimi i dispozitave specifike për kontratën e transportit hekurudhor të mallrave, përfundimi dhe realizimi i kontratës së transportit të mallrave, përcaktimi i përgjegjësive të sipërmarrësit hekurudhor në raste të ndryshme të mosrealizimit të kontratës apo të humbjes dhe të dëmtimit të mallrave, si dhe përgjegjësitë e aktorëve që marrin pjesë në transport, që nga ngarkimi i mallit e deri në dorëzimin e tij, rregullohen nga dispozitat e këtij Kodi dhe, për çështje që nuk gjejnë rregullim në të, nga dispozitat përkatëse të Kodit Civil.

3. Ministri përgjegjës për transportet nxjerr akte nënligjore për transportin e mallrave të rrezikshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për klasifikimin, ruajtjen, ambalazhimin, si dhe importin dhe eksportin e tyre.

Neni 106

Tarifat

Tarifat e shërbimit të transportit hekurudhor të mallrave përcaktohen nga sipërmarrësit hekurudhorë.

PJESA E PESTË INFRASTRUKTURA

KREU I RRJETI DHE INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE

Seksioni 1

Përcaktimi, përbërja, klasifikimi

Neni 107

Rrjeti hekurudhor i Republikës së Shqipërisë

Rrjeti hekurudhor i Republikës së Shqipërisë është tërësia e të gjitha rrjeteve hekurudhore shtetërore dhe private që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 108

Rrjeti hekurudhor publik në territorin e Republikës së Shqipërisë

Rrjeti hekurudhor publik përbëhet nga linjat dhe infrastrukturat hekurudhore në pronësi të shtetit shqiptar që ofrojnë shërbime hekurudhore për më shumë se një sipërmarrës që plotëson kushtet në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.



Neni 109

Përfshirjet nga rrjeti hekurudhor publik

Nuk bëjnë pjesë në rrjetin hekurudhor publik:

1. Infrastrukturat hekurudhore, të ndërtuara nga shteti ose me lejen e tij, me synim shfrytëzimin e shërbimeve hekurudhore të transportit të udhëtarëve apo të mallrave, vetëm të karakterit lokal.

2. Infrastrukturat hekurudhore, të ndërtuara në brendësi të territoreve të sipërmarrjeve industriale, tregtare, bujqësore ose portuale, përfshirë këtu sipërmarrësit e mirëmbajtjes së mjeteve të sipërmarrësve të transportit hekurudhor.

3. Degëzimet lidhëse të rrjetit në shfrytëzim të përbashkët me ato të subjekteve të përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Neni 110

Rrjeti hekurudhor

1. Ky rrjet ndahet sipas kategorive të mëposhtme:

a) vijat e parashikuara për transportin e udhëtarëve;

b) vijat e parashikuara për transport të përzier (udhëtarë dhe mallra);

c) vijat e posaçme për transportin e mallrave;

ç) stacione nyje të transportit të udhëtarëve;

d) stacione nyje të transportit të mallrave, përfshirë dhe terminallet intermodale;

dh) linjat lidhëse për kategoritë e mësipërme.

2. Ky rrjet përfshin:

a) drejtësinë dhe menaxhimin e trafikut;

b) sistemet e drejtimit;

c) instalimet teknike për përpunimin e të dhënave dhe të telekomunikacionit, të destinuara për shërbimet e udhëtarëve të distancave të gjata, të mallrave dhe shërbimeve në rrjet, për të garantuar funksionimin e sigurt dhe harmonik të rrjetit dhe administrimin efikas të trafikut;

ç) mjete lëvizëse të përshtatshme teknikisht, të cilat janë:

i) trena me motor me djegie të brendshme (diesel) ose elektrik;

ii) mjete tërheqëse (lokomotiva) me motor diesel ose elektrik;

iii) vagonë udhëtarësh (transport të brendshëm dhe ndërkombëtar);

iv) vagonë malli për të gjitha llojet e mallrave (të lehta/të rënda, të ngurta/të lëngëta, të hapura/të

mbyllura, kontejner, si dhe për mallrat e rrezikshme).

Neni 111

Elementet përbërëse të infrastrukturës hekurudhore

Infrastruktura hekurudhore përbëhet nga elementet e mëposhtme, që janë pjesë e rrugëve kryesore dhe rrugëve të shërbimit, me përfshirje të atyre të vendosura në repartet e riparimit, depot apo garazhe të lokomotivave, si dhe binarëve privatë:

a) sipërfaqe tokësore, trualli;

b) traseja dhe shtrati i trasesë, argjinaturat, profili i trasesë, kanalet kulluese dhe llogore, llogore muraturë, tombino, veshje muri, mbjellje për mbrojtjen e shpateve anësore, platformat e udhëtarëve e të mallrave, përfshirë edhe stacionet e udhëtarëve dhe terminallet e mallrave, rrugë kalimi për këmbësorë, muret rrethuese, mure mbrojtëse nga zjarri, impiantet e ngrohjes, kryqëzimet etj.;

c) veprat e artit, strukturat inxhinierike: ura, tombino dhe mbikalime të tjera, tunele, prerje të mbuluara dhe nënkalime të tjera, mure mbajtëse, struktura për mbrojtjen kundër ortekëve me gurë në rënie etj.;

ç) vendkalimet në nivel, përfshirë pajisjet e garantimit të sigurisë së lëvizjes;

d) superstruktura ku futen shinat, kundërshinat në urat me gjatësi të madhe, në zonat ku traseja është e ndërtuar me mure të larta, në zonat ku traseja është e dobët, në kthesa;

dh) traversat dhe pajisje lidhëse me shinat, çakëll prej guri apo prej zhavorri, platformat rrotulluese për lokomotiva, vendkalimet etj.;

e) vendkalimet për qasje për udhëtarët dhe për mallrat, përfshirë qasje me rrugë dhe qasje për udhëtarët që mbërrijnë ose nisen në këmbë;

ë) siguria, sinjalizimi dhe instalimet në stacionet e trenave, përfshirë objektin e gjenerimit, transformimit dhe shpërndarjes së energjisë për sinjalizim dhe telekomunikim dhe të frenimit;

f) instalime ndriçimi, për qëllime të komunikacionit e të sigurisë;

g) reparte për transformim të energjisë elektrike për transport me tren: nënstacione, kabllot e furnizimit ndërmjet nënstacioneve dhe mbështetës hekurudhorë për të tretë;

gj) ndërtesat e përdorura nga departamenti i infrastrukturës.



Seksioni 2

Sistemet e kontrollit dhe drejtimit të infrastrukturës hekurudhore

Neni 112

Sistemet e kontroll-komandës dhe sinjalizimit (CCS)

1. Sistemet e kontroll-komandës dhe sinjalizimit (CCS) të infrastrukturës shërbejnë për të realizuar komandimin e sigurt të trafikut hekurudhor.

2. Sistemet e kontroll-komandës dhe sinjalizimit (CCS) projektohen, ndërtohen dhe mirëmbahen në përputhje me standardet e përcaktuara në aktet nënligjore të hartuara nga njësia e ndërveprimit pranë Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore. Këto akte miratohen nga ministri përgjegjës për transportet dhe zbatohen nga projektuesit, ndërtuesit dhe administruesi i infrastrukturës hekurudhore.

3. Komunikimi midis punonjësve që kujdesen drejtpërdrejt për qarkullimin hekurudhor realizohet nëpërmjet rrjetit dhe infrastrukturës elektronike të komunikimit në mënyrë gjurmëlënëse dhe të arkivueshme.

4. Metodatat e përdorimit e të mirëmbajtjes të sistemit të komunikimit hartohen nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore, në përputhje me standardet e nxjerra nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

Neni 113

Sistemet e shenjzimit dhe shenjave

1. Sistemi i shenjzimit dhe shenjave shërben për të orientuar kryesisht përdoruesit joaktivë të rrjetit hekurudhor, si udhëtarët, kalimtarët, mjetet lëvizëse rrugore etj.

2. Shenjat e sistemit të shenjzimit kanë forma, madhësi, ngjyra, vendndodhje, në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloret e dala nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

3. Organizimi i vendosjes së tyre përputhet me organizimin dhe procesin e punës në qarkullimin hekurudhor dhe pëmbushin kërkesat për sigurinë e lëvizjes.

4. Shenjat dhe sistemi i shenjzimit kanë të njëjtin kuptim me ato të të gjithë rrjetit hekurudhor europian.

Neni 114

Sistemi i elektrifikimit

Elektrifikimi i rrjetit hekurudhor kryhet në përputhje me standardet teknike, të hartuara nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe të miratuara në zbatim të këtij Kodi.

Seksioni 3

Mbrojtja

Neni 115

Paprekshmëria e infrastrukturës hekurudhore

Tërësia e infrastrukturës hekurudhore klasifikohet si objekt i rëndësishë së veçantë, pasi cenimi i infrastrukturës hekurudhore nga dëmtues fizikë johekurudhorë mund të jetë shkak për aksidente me pasoja të rënda.

Neni 116

Masat për mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore

Administruesi i infrastrukturës hekurudhore për mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore zbaton rregullat kombëtare të sigurisë, të miratuara në zbatim të këtij Kodi.

Neni 117

Mbrojtja e vijave dhe e degëzimeve hekurudhore

1. Vijat dhe degëzimet hekurudhore nën administrimin e administruesit të infrastrukturës hekurudhore mbrohen prej tij.

2. Degëzimet e reja hekurudhore, pronë e personit juridik, publik ose privat, mbrohen nga personi juridik, të cilit i shërbejnë.

Neni 118

Kufizime në funksion të mbrojtjes së vijës hekurudhore

1. Për të siguruar mbrojtjen e vijave hekurudhore ndalohet:

a) derdhja e ujërave të kanaleve ujëtare e kulluese dhe e ujërave të tjera në vijën hekurudhore ose në kanalet e trasesë së saj;

b) ndërhyrja në sistemin e kullimit të ujërave nga kanalet e trasesë së hekurudhës deri në derdhjen përfundimtare;



c) hapja më afër se 100 metra nga brezi i vijës hekurudhore i guroreve, zhavorrishteve e ranishtave, gërmimi masiv i dheut dhe hapja e kanaleve. Për ndërtimin e këtyre objekteve, në distancë 100-200 metra nga brezi i vijës hekurudhore, merret leje nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore;

ç) kalimi i mjeteve me zinxhirë dhe i mjeteve të tjera të rënda mbi vijën hekurudhore, me përjashtim të rasteve kur administruesi i infrastrukturës hekurudhore cakton vendet e lejuara dhe rregullat për kalimin e tyre;

d) çdo lloj ndërtimi, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë vijës hekurudhore, më pranë se 25 metra nga brezi i kësaj vije, për territoret jashtë zonave urbane. Por, në këto zona lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit dhe i ndërtesave të tjera, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë brezit të vijës hekurudhore, në distancë 25-100 metra nga ky brez.

2. Për ndërtimin e çdo lloj objekti, që ndodhet në zonat urbane, jashtë brezit të vijës hekurudhore dhe në distancë deri në 25 metra nga ky brez, kërkohet leje nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore.

Neni 119

Punimet në brezin mbrojtës të vijës hekurudhore

1. Në brezin mbrojtës të vijës hekurudhore mund të bëhen punime për vendosjen e ujësjellësve, kanalizimeve, tubacioneve, përcjellësve elektrikë, linja/rrjete të telekomunikacionit dhe objekteve të ngjashme, me kusht që të mos pengojnë regjimin e trafikut hekurudhor dhe të mos dëmtojnë stabilitetin e vijës hekurudhore.

2. Në rastin e kryqëzimeve të vijës hekurudhore me rrjetin elektrik, linja/rrjete të telekomunikacionit ose teleferik apo të rrjeteve të ngjashme me to, këto duhet të vendosen jashtë gabariteve të hapësirës ajrore të vijës hekurudhore.

3. Për kryerjen e punimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, jepet miratimi nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore, me kërkesë të personit juridik, i cili do të kryejë punimet.

4. Për miratimin e kryerjes së punimeve, sipas pikës 1, të këtij neni, administruesi i infrastrukturës

hekurudhore është i detyruar të njoftojë Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore të paktën 15 ditë para fillimit të punimeve.

Neni 120

Punimet mbrojtëse

Punimet për mbrojtjen e vijave hekurudhore dhe të objekteve mbi to, punimet për rregullsinë dhe sigurinë e trafikut ose për veprime të tjera në vijën hekurudhore dhe në brezin e vijës hekurudhore kryhen vetëm me miratimin e administruesit të infrastrukturës hekurudhore.

Seksioni 4

Kryqëzimet me hekurudhat

Neni 121

Qëllimi dhe miratimi

1. Për ndërtime, modifikime dhe zhvendosje të kryqëzimeve ndërmjet hekurudhave dhe rrugëve publike ose private, kërkohet leje tek administruesi i infrastrukturës dhe miratim tek Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

2. Kryqëzimet me rrugë publike miratohen nëse gjatë dhe pas ndërtimit të tyre është i garantuar shfrytëzimi dhe trafiku hekurudhor nëpërmjet marrjes së masave të duhura dhe instalimit të impianteve të sigurisë.

Neni 122

Kushtet teknike

1. Kryqëzimet e reja me rrugët publike duhet të realizohen nëpërmjet nënkalimeve ose mbikalimeve, si më poshtë:

a) projektimi dhe ndërprerja e autostradave, rrugëve interurbane dhe urbane kryesore me vijat hekurudhore kryesore ekzistuese realizohet me mbikalim ose nënkalim rrugor;

b) projektimi dhe ndërtimi i ndërprerjeve të vijave të reja kryesore hekurudhore me autostradat, rrugët interurbane dhe urbane kryesore realizohet me mbikalime ose nënkalime hekurudhore;

c) numri i kryqëzimeve të infrastrukturës hekurudhore dhe rrugore publike duhet të minimizohet me anë të lidhjes së dy apo më shumë rrugëve publike në një kalim të përbashkët;

ç) distanca minimale mes dy kryqëzimeve duhet të jetë 2500 m;

d) kryqëzimet e infrastrukturës hekurudhore dhe rrugore të pakategorizuara, sipas shkronjave



“a” dhe “b”, të kësaj pike, mund të realizohen edhe në nivel (kalim në nivel).

2. Kushtet teknike për kryqëzimet ndërmjet rrugëve dhe hekurudhave propozohen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe miratohen nga ministri përgjegjës për transportet.

Neni 123

Shpenzimet

1. Kur një linjë e re hekurudhore, e destinuar për trafik publik, kryqëzon një rrugë publike, ose një rrugë e re publike kryqëzon një linjë hekurudhore, pronari i rrugës së re të komunikimit përballon shpenzimet e ndërtimit të mbikalimit ose nënkalimit, shpenzimet e instalimit të pajisjeve dhe mekanizmave, shpenzimet e tjera për sigurimin e trafikut.

2. Përfshihen nga shpenzimet kostot për shfrytëzimin e themelit të trupit të rrugës apo hekurudhës në vendin e kryqëzimit.

Neni 124

Kalim në nivel, kalesa hekurudhore

1. Kalim në nivel është ndërprerja në nivel e rrugës me hekurudhën, e njohur nga administruesi i infrastrukturës dhe e hapur për përdoruesit publikë apo privatë.

2. Numri dhe vendndodhja e kalimeve hekurudhore janë të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për transportet dhe të publikuara periodikisht në “Deklaratën e rrjetit” të administruesit të infrastrukturës.

3. Çdo kalim hekurudhor apo vendkalim për këmbësorë, e ndërtuar dhe që nuk figuron në listën e kalimeve, të miratuara sipas pikës 2, të këtij neni, konsiderohet e paligjshme.

Subjektet që kanë ndërtuar kalimin hekurudhor në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, organi përkatës që ka miratuar punimet e parregullta për ndërtimin e saj ose administruesi i infrastrukturës së pjesës së vijës ku është ndërtuar kalimi hekurudhor mbajnë përgjegjësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë Kod.

4. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore publike nuk mban përgjegjësi për aksidentet dhe avaritë që ndodhin në kalimet hekurudhore, të ndërtuara në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi.

5. Nga ky përcaktim përjashtohen kalimet në nivel ndërmjet platformave të stacioneve dhe kalimeve të rezervuara për personelin hekurudhor.

Neni 125

Ndryshime në kalimet në nivel (kryqëzimet ekzistuese)

1. Në rast se një kalim në nivel duhet të zëvendësohet me nënkalim apo mbikalim ose të ndërpritet për shkak të spostimit të rrugës, shpenzimet për ndryshimet në hekurudhë apo në rrugë janë në ngarkim:

a) të hekurudhës, në rastin kur ndryshimi është kërkuar për nevoja të trafikut hekurudhor;

b) të pronarëve të rrugës, në rastin kur ndryshimi është kërkuar për nevoja të trafikut rrugor.

2. Për të gjitha ndryshimet e tjera të kryera në një kryqëzim, përfshirë përshtatjen dhe përmirësimin e impianteve të sigurisë, ndërmarrja hekurudhore dhe pronari i rrugës duhet të përballojnë shpenzimet e ardhura nga ndërtimi i impianteve hekurudhore dhe rrugore proporcionalisht me kërkesat e bëra për ndryshim.

3. Përfshihen nga shpenzimet kostot për shfrytëzimin e themelit të trupit të rrugës apo hekurudhës në vendin e kryqëzimit.

Neni 126

Pjesëmarrja në shpenzimet

1. Në çdo rast, çdonjëri nga palët (pronarët përkatës të hekurudhës dhe rrugës) duhet të kontribuojë në shpenzimet në masën e avantazheve të përftuara nga modifikimi i kushteve.

2. Pala që, në interes të një përmirësimi të qëndrueshëm ose të një sistemimi të impianteve të saj, vë kushte të veçanta, duhet e vetme të përballojë shpenzimet në vendin e kryqëzimit.

Neni 127

Rrugë të reja private

Në përputhje me nenin 123, të këtij Kodi, në rast të kryqëzimit të një hekurudhe me një rrugë të re private, administruesi i infrastrukturës hekurudhore lejon përdorimin e trupit të hekurudhës kundrejt një shpërblimi të arsyeshëm. Administratori mund të kërkojë, për shpenzimet, një paradhënie ose ofrimin e garancive të nevojshme.



Neni 128

Kryqëzimet me rrugët e reja private

Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, përballimi i shpenzimeve të punimeve të mirëmbajtjes e të rinovimit, të masave të përkohshme e të përhershme, të ndërmarra për parandalimin e aksidenteve në vendet e kryqëzimit, me rrugët e reja private, përfshin edhe shpenzimet e instalimeve të shërbimit.

Neni 129

Kryqëzimet ndërmjet hekurudhave

Parashikimet e neneve 123, 124, 125 dhe 126, të këtij Kodi, zbatohen dhe për kryqëzimet ndërmjet hekurudhave.

Neni 130

Kryqëzimet me impiante të tjera

1. Në përputhje me nenin 121, të këtij Kodi, rregullohet veprimtaria për kryqëzimet e hekurudhës me tubacionet gaz-naftësijellës, sistemet e furnizimit me ujë, energji, kabllo të nën sipërfaqe dhe instalime të tjera të ngjashme, linja/rrjete të telekomunikacionit, teleferikë dhe impiante të tjera të ngjashme, publike apo private.

2. Shpenzimet për ndërtimin, mirëmbajtjen, rinovimin e një kryqëzimi të ri ose të modifikimit të një kryqëzimi ekzistues, si dhe të gjitha masat e përkohshme apo të përhershme, me qëllim parandalimin e dëmeve në vendin e kryqëzimit, janë në ngarkim të investitorit.

Administruesi i infrastrukturës mund të kërkojë një kompensim të tarifës për përdorim të pronës së tij në favor të impianteve private.

Neni 131

Marrëveshje të veçanta

Dispozitat e këtij Kodi nuk zbatohen në rastet kur palët kanë bërë marrëveshje për një shpërndarje të ndryshme të shpenzimeve.

PJESA E GJASHTË NDËRVEPRIMI

KREU I NDËRVEPRIMI

Neni 132

Ndërveprimi

1. Ndërveprimi është aftësia e sistemit hekurudhor shqiptar për të lejuar shfrytëzimin të

sigurt dhe të pandërprerë të mjeteve hekurudhore, që përmbushin nivelet e kërkuara të performancës për këto linja. Kjo aftësi varet nga plotësimi i të gjitha kushteve rregullatore teknike dhe funksionale, të cilat plotësojnë kërkesat thelbësore.

2. Realizimi progresiv i ndërveprimit të sistemit hekurudhor kryhet nëpërmjet harmonizimit të specifikimeve teknike dhe bazohet në:

a) plotësimin e kërkesave thelbësore lidhur me sigurinë, besueshmërinë, mbrojtjen e shëndetit të personelit, mbrojtjen e ambientit, përputhshmërinë teknike dhe shfrytëzuese të sistemit;

b) plotësimin e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI), të përshtatura për çdo nënsistem dhe pjesë të nënsistemit;

c) plotësimin e kushteve të kualifikimit profesional të personelit hekurudhor.

Neni 133

Përmbajtja e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI)

1. Secili prej nënsistemeve mbulohet nga një prej kushteve teknike të ndërveprimit (TSI). Kur është e nevojshme, një nënsistem mund të mbulohet nga disa kushte teknike të ndërveprimit (TSI) dhe një kusht teknik i ndërveprimit (TSI) mund të mbulojë disa nënsisteme.

2. Nënsistemi fiks duhet të përputhet me kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) dhe rregullat kombëtare në fuqi në kohën e kërkesës për autorizim dhe vendosjen në shërbim, në përputhje me këtë Kod dhe pa cenuar shkronjën “dh”, të pikës 3, të këtij neni.

Mjetet hekurudhore duhet të jenë në përputhje me kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) dhe rregullat kombëtare në fuqi në kohën e kërkesës për autorizimin e vendosjes në treg, në përputhje me këtë Kod dhe pa cenuar shkronjën “dh”, të pikës 3, të këtij neni.

Konformiteti dhe pajtueshmëria e nënsistemeve fikse dhe mjeteve ruhen në mënyrë të përhershme, ndërsa ata janë në përdorim.

3. Për të arritur objektivat e këtij Kodi, çdo kusht teknik i ndërveprimit (TSI):

a) përcakton qëllimin për të mbuluar çdo pjesë të rrjetit ose të mjeteve hekurudhore, çdo nënsistem: ose

b) përcakton kërkesat thelbësore për secilin nënsistem dhe elementet bashkuese me nënsistemet e tjera;



c) përcakton specifikimet funksionale dhe teknike që duhet të përmbushen nga nënsistemi dhe elementet bashkuese me nënsistemet e tjera. Nëse është e nevojshme, këto specifikime mund të ndryshojnë në bazë të përdorimit të nënsistemit, për shembull, sipas kategorive të linjës, shpërndarës dhe/ose të mjeteve të parashikuara në elementet e sistemit hekurudhor;

ç) përcakton përbërësit e ndërveprimit, të cilët duhet të mbulohen nga specifikimet europiane, përfshirë standardet europiane, të cilat janë të nevojshme për arritjen e ndërveprimit brenda sistemit hekurudhor europian;

d) në çdo rast në shqyrtim, përcakton procedurat që do të përdoren për të vlerësuar konformitetin ose përshtatshmërinë për përdorimin e përbërësve të ndërveprimit, nga njëra anë, apo verifikimin e nënsistemeve, nga ana tjetër. Këto procedura bazohen në modulet e përcaktuara në vendimin e Komisionit Europian;

dh) tregon strategjinë për zbatimin e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI). Në veçanti, është e nevojshme të përcaktojë fazat për të përfunduar, duke marrë parasysh kostot e vlerësuara dhe përfitimet e pasojat e pritshme për aktorët e prekur, në mënyrë që të bëjë një kalim gradual nga situata ekzistuese në situatën përfundimtare, në të cilën pajtueshmëria me kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) do të jetë normë. Kur zbatimi i koordinuar i kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) është i nevojshëm mes administruesve të infrastrukturës dhe sipërmarrjeve hekurudhore, strategjia mund të përmbajë propozime për plotësimin në faza;

e) tregon për stafin, kualifikimet profesionale dhe kushtet e shëndetit e të sigurisë në punë, të kërkuara për operimin dhe mirëmbajtjen e nënsistemit të mësipërm, si dhe për zbatimin e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI);

ë) tregon dispozitat e zbatueshme për riparim të nënsistemeve ekzistuese dhe mjeteve, në veçanti, në rast kur përmirësimet sjellin modifikim të ri, atëherë kërkohet një aplikim për një autorizim të ri;

f) tregon parametrat e mjeteve dhe nënsistemet fikse që kontrollohen nga sipërmarrja hekurudhore dhe procedurat që zbatohen për të kontrolluar parametrat, pas marrjes të autorizimit të mjeteve për vendosjen e tyre në shërbim dhe përdorimit të parë të mjetit të siguar me përputhshmërinë mes mjetit dhe vijës hekurudhore në të cilën do të operohet.

4. Çdo kusht teknik i ndërveprimit (TSI) hartohet në bazë të ekzaminimit të një nënsistemi ekzistues dhe tregon një nënsistem, i cili mund të arrihet gradualisht brenda një periudhe të arsyeshme. Prandaj, miratimi i kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) dhe pajtueshmëria me to do të çojnë gradualisht në arritjen e ndërveprimit të sistemit hekurudhor.

5. Në qoftë se disa aspekte teknike që korrespondojnë me kërkesat thelbësore nuk mund të mbulohen në mënyrë të qartë nga një kusht teknik i ndërveprimit (TSI), ato identifikohen qartë në një shtojcë të kushteve teknike të ndërveprimit (TSI), si pika të hapura.

6. Kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) nuk pengojnë lëvizjen në infrastrukturën hekurudhore të mjeteve që nuk mbulohen nga kushtet teknike të ndërveprimit (TSI).

Neni 134

Moszbatimi i kushteve teknike të ndërveprimit (TSI)

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mund të lejojë aplikuesin të mos zbatojë një ose më shumë kushte teknike të ndërveprimit (TSI) ose pjesë të tyre në rastet e mëposhtme:

a) për një nënsistem të ri ose pjesë të tij për rinovimin ose përmirësimin e një nënsistemi ekzistues ose pjesë të tij, ose për ndonjë element, i cili është në një fazë të avancuar të zhvillimit ose që është objekt i një kontrate gjatë aplikimit të kushteve teknike të ndërveprimit (TSI);

b) kur pas një aksidenti ose një fatkeqësie natyrore, kushtet ekonomike ose teknike për rivendosjen e shpejtë të rrjetit nuk të lejojnë aplikimin e pjesshëm ose të plotë të kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) përkatëse, rast në të cilin moszbatimi i kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) do të kufizohet me periudha para restaurimit të rrjetit;

c) kur për çdo rinovim të propozuar, zgjerimi ose përmirësimi i një nënsistemi ekzistues ose i një pjese të tij, aplikimi i kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) përkatës do të bazohet në qëndrueshmërinë ekonomike të projektit dhe/ose pajtueshmërinë e sistemit hekurudhor;

ç) për mjetet që vijnë nga/ose që shkojnë në vende të treta, gjerësia e vijave hekurudhore e të cilave është e ndryshme nga ajo e rrjetit kryesor hekurudhor.



2. Në rastet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore do t’i komunikojë Komisionit European vendimin e tij për të mos aplikuar një ose më shumë kushte teknike të ndërveprimit (TSI) ose pjesë të tyre.

3. Në rastet e përmendura në shkronjat “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore do t’i paraqesë Komisionit European kërkesën për moszbatimin e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) apo pjesët e tyre, të shoqëruar nga një skedar që përmban arsyetimin për kërkesën dhe duke specifikuar dispozitat alternative që ai ka ndër mend të aplikojë në vend të kushteve teknike të ndërveprimit (TSI). Në rastet e përmendura në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, Komisioni European do të miratojë vendimin e tij me anë të zbatimit të akteve, mbi bazën e analizave të tilla. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të referuar në pikën 3, të nenit 51, të këtij Kodi.

Neni 135

Përshtatja, rishikimi dhe publikimi i kushteve teknike të ndërveprimit (TSI)

Ministri përgjegjës për transportet përcakton qëllimin, përshtatjen dhe ndryshimin e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) për sistemin hekurudhor shqiptar, si dhe miraton hartimin, rishikimin, përditësimin dhe publikimin e tyre prej Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore.

Neni 136

Vendosja në operim e mjeteve të transportit hekurudhor

1. Mjetit të konfirmuar të transportit, i cili e ka autorizimin, duhet t’i jepet autorizimi për futje në operim, duke u bazuar në deklaratën e konformitetit mbi tipin pa kontrollime të mëtejshme.

2. Autorizimet për futjen e mjeteve të transportit në operim, lëshuar në Bashkimin European dhe në shtetet tjera, me të cilat Shqipëria ka marrëveshje të veçanta, duhet të konsiderohen të vlefshme nëse janë në përputhje me legjislacionin në Shqipëri.

3. Vendet, të cilat kanë marrëveshje me Shqipërinë, duhet ta njohin autorizimin për futje në operim të mjeteve të transportit, të lëshuar nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

4. Në rast se Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore në Shqipëri refuzon apo revokon një marrëveshje për ta futur në operim një mjet hekurudhor, vendimi duhet të jetë i vërtetuar në mënyrë të detajuar.

5. Në një akt nënligjor përshkruhen procedurat për autorizimet, si më poshtë:

a) për futjen në operim të mjeteve të transportit në përputhje ose jo me kushtet teknike të ndërveprimit (TSI);

b) autorizimet dhe modelet shtesë të nevojshme të deklarimit të konformitetit të tipit miratohen nga ministri përgjegjës për transportet.

Neni 137

Mirëmbajtja e mjeteve të transportit

1. Për secilin mjet hekurudhor, para se të hyjë në operim ose të përdoret në mjet, duhet të ketë një subjekt të ngarkuar për mirëmbajtje, i cili duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e mjeteve të hekurudhore të autorizuar në Shqipëri.

2. Subjektet e ngarkuara me mirëmbajtjen e mjeteve hekurudhore mund të jenë sipërmarrja hekurudhore, administruesi i infrastrukturës apo mbajtësi i këtyre mjeteve të transportit.

3. Ky subjekt duhet të sigurojë që mjetet hekurudhore, për të cilat ai është i ngarkuar t’i mirëmbajë, të jenë në gjendje të sigurt dhe të lëvizin me mjetet e sistemit të mirëmbajtjes. Subjekti i ngarkuar me mirëmbajtjen duhet të sigurojë që mjetet hekurudhore të jenë të mirëmbajtura, në përputhje me:

a) dokumentacionin e mirëmbajtjes për secilin mjet të transportit;

b) kërkesat në fuqi, përfshirë rregullat e mirëmbajtjes dhe dispozitat e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI).

4. Subjekti përgjegjës për mirëmbajtje duhet ta kryejë vetë mirëmbajtjen apo t’i përdorë sipërmarrjet e kontraktuara për mirëmbajtje.

5. Në rastin e mjeteve hekurudhore të transportit të mallrave në Shqipëri, secili subjekt përgjegjës për mirëmbajtje duhet të jetë i certifikuar nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

6. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mban regjistrin e subjekteve të vendosura në Shqipëri, të cilat janë të ngarkuara për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave.

7. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mban regjistrin e mbajtësve të mjeteve hekurudhore të



regjistruara në Shqipëri dhe mban kontaktet e domosdoshme, lidhur me mbajtësit e mjeteve hekurudhore dhe subjekteve të ngarkuara për mirëmbajtjen e këtyre mjeteve që janë në operim në Shqipëri.

Neni 138

Harmonizimi i certifikatave të sigurisë

Kërkesat e përbashkëta, të harmonizuara në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 65, të këtij Kodi, i përmbahen një formati të përbashkët të sugjeruar nga Agjencia.

KREU II REGJISTRAT

Neni 139

Sistemi i numërimit të mjeteve hekurudhore

1. Çdo mjet hekurudhor, i vënë në shërbim në sistemin hekurudhor, mban një numër evropian të mjetit të caktuar (EVN – *European Vehicle Number*), i cili merret kur jepet leja e parë për vënien në operim.

2. Parashtruesi i kërkesës për lejen e parë është përgjegjës për regjistrimin e këtij mjeti me EVN-në e caktuar për të.

3. EVN-ja përcaktohet në kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) mbi shfrytëzimin dhe administrimin e qarkullimit.

4. Një mjet hekurudhor i caktohet një EVN vetëm një herë, përveçse nëse përcaktohet ndryshe në kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) mbi shfrytëzimin dhe administrimin e qarkullimit.

5. Pavarësisht nga sa përcaktohet në pikën 1, të këtij neni, në rastin e mjeteve hekurudhore që operojnë ose kanë për qëllim të operojnë nga/ose drejt vendeve të treta, gjerësia e vijës së të cilave është e ndryshme nga ato të rrjetit kryesor hekurudhor evropian, mund të pranohen mjetet hekurudhore që janë identifikuar qartë, sipas një sistemi kodimi të ndryshëm.

Neni 140

Numri kombëtar dhe regjistri i mjeteve të transportit hekurudhor

1. Çdo mjet i transportit hekurudhor, i futur në operim në Shqipëri, duhet të ketë numrin kombëtar të mjetit hekurudhor, të dhënë kur është lëshuar autorizimi për futjen në operim.

2. Nëse mjeti i transportit hekurudhor është i autorizuar në BE, aplikuesi për autorizimin e parë

duhet të jetë përgjegjës për shënimin e mjetit të transportit hekurudhor me numrin evropian të mjetit, i cili duhet të njihet për përdorimin e mjeteve të transportit hekurudhor në Shqipëri.

3. Regjistri i mjeteve të transportit hekurudhor të autorizuar në Shqipëri duhet të mbahet dhe të përditësohet. Ky regjistër duhet të jetë në dispozicion të Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore në Shqipëri dhe të Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore. Ai po ashtu duhet të jetë në dispozicion për çfarëdo kërkesë legjitime të Autoritetit Rregullator Hekurudhor, të tregut, sipërmarrjeve hekurudhore dhe administruesit të infrastrukturës, si dhe personave e organizatave të tjera.

4. Regjistri duhet të ketë së paku informatat në vijim për secilin mjet transporti hekurudhor të autorizuar në Shqipëri:

- a) numrin kombëtar të mjetit të transportit;
- b) referencën për deklaratën e verifikimit të organit që e ka lëshuar;
- c) identifikimin e pronarit e të mbajtësit të mjetit të transportit;
- ç) kufizimet se si një mjet i transportit duhet të përdoret;
- d) subjektin përgjegjës për mirëmbajtje.

5. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore është përgjegjës për numërimin e mjeteve hekurudhore dhe mbajtjen e regjistrit për mjetet e transportit hekurudhor, të futura në operim në Shqipëri.

Neni 141

Regjistri i autorizimeve të operimit të mjeteve të transportit hekurudhor

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore mban regjistrin për autorizimet për vendosjen në operim të llojeve të mjeteve.

Ky regjistër është:

- a) publik dhe elektronikisht i aksesueshëm;
- b) në përputhje me specifikimet e përbashkëta, të përmendura në pikën 2 të këtij neni;
- c) i lidhur me regjistrat përkatës të mjeteve.

2. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore miraton specifikimet e përbashkëta për regjistrin e llojeve të mjeteve të autorizuar, që kanë të bëjnë me përmbajtjen, formatin e të dhënave strukturore, funksionale e teknike, mënyrën operative, rregullat për futjen e të dhënave dhe konsultimin me anë të akteve zbatuese.



3. Regjistri përmban të paktën elementet e mëposhtme për çdo lloj mjeti:

a) karakteristikat teknike, përfshirë ato që lidhen me qasjen për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar, të llojit të mjetit, siç përcaktohet në kushtin teknik të ndërveprimit (TSI) përkatës;

b) emrin e prodhuesit;

c) të dhënat e autorizimeve që kanë të bëjnë me fushën e përdorimit për një lloj mjeti, duke përfshirë edhe ndonjë kufizim apo tërheqje.

Neni 142

Regjistri i infrastrukturës

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore siguron publikimin e regjistrit të infrastrukturës, ku deklarohen vlerat e parametrave të rrjetit të secilit nënsistem ose pjesë të nënsistemit në fjalë, siç përcaktohet në kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) përkatës.

2. Vlerat e parametrave të regjistruara në regjistrin e infrastrukturës përdoren në kombinim me vlerat e parametrave të regjistruara në autorizimin e mjeteve për vendosjen në treg për të kontrolluar përputhshmërinë teknike ndërmjet mjetit dhe rrjetit.

3. Regjistri i infrastrukturës mund të përcaktojë kushtet për përdorimin e instalimeve fikse dhe kufizime të tjera.

4. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore siguron që regjistri i infrastrukturës të përditësohet në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

5. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore miraton kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) për regjistrin e infrastrukturës, në lidhje me përmbajtjen, formatin e të dhënave strukturore, funksionale dhe teknike, mënyrën operative, rregullat për futjen e të dhënave dhe konsultime me anë të akteve zbatuese.

KREU III STANDARDIZIMI

Neni 143

Kushtet teknike të ndërveprimit (TSI)

1. Kushtet teknike të ndërveprimit (TSI) janë kushtet teknike, me të cilat çdo nënsistem ose pjesë nënsistemi plotëson kërkesat thelbësore dhe siguron ndërveprimin e sistemit hekurudhor në Republikën e Shqipërisë.

2. Kushtet teknike për ndërveprim (TSI), të

miratuara në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, zbatohen në të gjitha nënsistemet hekurudhore në Republikën e Shqipërisë, si vijon:

a) nënsistemet strukturore, si:

i) infrastruktura;

ii) energjia;

iii) kontroll-komanda dhe sinjalizimi anash vijave hekurudhore;

iv) kontroll-komanda dhe sinjalizimi te kabina e komandimit të trenit të mjeteve hekurudhore;

v) mjetet lëvizëse të transportit hekurudhor;

b) nënsistemet funksionale, si:

i) operimi dhe administrimi i trafikut;

ii) mirëmbajtja;

iii) aplikimet e informacionit në distancë (telematike) për shërbimet e udhëtarëve dhe mallrave.

Neni 144

Standardet e nënsistemeve

Në të gjitha nënsistemet e përfshira në sistemin hekurudhor, si infrastruktura, energjia, mjetet lëvizëse, operimi dhe administrimi i trafikut, mirëmbajtja, aplikimet e informacionit në distancë (telematike), si edhe në të gjitha proceset e ndryshme të punës që përdoren te mjetet lëvizëse të sistemit hekurudhor, si lëvizja, lidhja, ndarja, frenimi i trenave etj., pajisjet dhe aparaturat që përdoren te sistemi i kontroll - komandës e sinjalizimit (CCS), si dhe programet kompjuterike dhe protokollet e aplikuara te sistemet e komunikimit e të transmetimit të të dhënave të tyre duhet të plotësojnë standardet e ndërveprimit, në lidhje me sigurinë, mbrojtjen, besueshmërinë, disponueshmërinë, përputhjen teknike, ruajtjen e shëndetit të punonjësve e të udhëtarëve, mbrojtjen e mjedisit, zhurmat, mbrojtjen nga zjarret, aksidentet, evakuimet etj.

Neni 145

Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturore në Shqipëri

1. Për futjen në shërbim të secilit nënsistem hekurudhor, administratori i infrastrukturës apo sipërmarrja hekurudhore marrin një autorizim nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

2. Për ta marrë këtë autorizim për futjen në shërbim të një nënsistemi, aplikuesi dëshmon se nënsistemi është i projektuar, ndërtuar dhe instaluar



në mënyrë të tillë që të plotësojë kërkesat themelore kur integrohet në sistemin hekurudhor. Në veçanti, aplikuesi dëshmon:

a) pajtueshmëri teknike të nënsistemit me sistemin në të cilin është integruar;

b) integrim të sigurt të nënsistemit në sistemin hekurudhor;

c) përputhshmëri të nënsistemit me dispozitat e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) për operimin dhe mirëmbajtjen.

3. Një nënsistem strukturor konsiderohet si ndërveprues dhe i plotëson kërkesat thelbësore të sigurisë, nëse për të është lëshuar deklarata e verifikimit.

4. Deklarata për verifikimin e nënsistemeve hekurudhore është e vlefshme në Shqipëri nëse është në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

5. Detyra e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, përgjegjës për verifikimin e këtij nënsistemi, fillon në fazën e projektimit dhe mbulon kohën gjatë gjithë periudhës së prodhimit përmes fazës së pranimit, para se nënsistemi të futet në shërbim. Ai gjithashtu mbulon verifikimin e ndërlydhjes së nënsistemit me sistemin që ndërfitet në shërbim.

6. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore është përgjegjës për përmbledhjen e dokumentacionit teknik, i cili shoqëron deklaratën për verifikim. Ky dokumentacion teknik përmban të gjitha dokumentet e nevojshme lidhur me karakteristikat e nënsistemit dhe, kur është nevoja, të gjitha dokumentet që dëshmojnë konformitetin e përbërësve të ndërveprimit. Ai gjithashtu përfshin të gjitha elementet për gjendjen dhe limitet që i përkasin kryerjes së shërbimit, monitorimin e vazhdueshëm apo rutinë, përshtatjen dhe mirëmbajtjen.

7. Në rast të ripërtëritjes apo të ngritjes së një nënsistemi, njësia kontraktuese apo prodhuese i dërgon Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore dokumentacionin, në të cilin përshkruhet projekti. Pas ekzaminimit vendoset nëse është fjala për një autorizim të ri për futje në shërbim.

8. Regjistri i infrastrukturës mbahet, përditësohet dhe publikohet. Ky regjistër paraqet karakteristikat kryesore të secilit nënsistem apo pjesë të nënsistemit të përfshirë, si dhe ndërvarësinë e tyre me veçoritë e paraqitura të standardeve teknike të aplikueshme të ndërveprimit. Kështu, secili standard teknik i

ndërveprimit tregon se çfarë informacioni përfshihet në regjistrin e infrastrukturës.

9. Regjistri i infrastrukturës mbahet dhe përditësohet nga secili administrues i infrastrukturës, i vendosur në Shqipëri nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore.

10. Me akt nënligjor përcaktohen procedurat, dokumentet dhe testet e nevojshme për lëshimin e autorizimit për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturore hekurudhore në Shqipëri.

Neni 146

Leja për vendosjen në operim të mjeteve hekurudhore të transportit

1. Para se të përdoret në rrjet, mjeti i transportit autorizohet që të futet në operim.

2. Mjetit të transportit që futet në operim duhet t'i jepet autorizimi nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, kur të gjitha nënsistemet strukturore të mjetit të transportit janë të autorizuar për futje në operim pas procedurave të vlerësimit e të verifikimit, të paraqitura në standardet teknike të ndërveprimit. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore është përgjegjës për dhënien e autorizimit për futjen në operim të mjetit hekurudhor dhe për kontrollin e pajtueshmërisë teknike ndërmjet nënsistemeve të mjeteve të transportit dhe integritetit të sigurt të tyre, pajtueshmërisë teknike ndërmjet mjeteve të transportit dhe rrjetit dhe pajtueshmërisë teknike me rregullat e tjera kombëtare.

Neni 147

Procedura për vendosjen në shërbim të nënsistemeve

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore lejon vendosjen në shërbim të nënsistemeve strukturore që përbëjnë sistemin hekurudhor, të cilat janë vendosur në shërbim ose përdoren në Shqipëri.

2. Pasi këto nënsisteme të vihen në shërbim, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore kryen këto kontrolle:

a) për infrastrukturën, në kontekstin e dhënies dhe mbikëqyrjes së autorizimeve të sigurisë në sistemin hekurudhor;

b) për mjetet, në kontekstin e dhënies dhe mbikëqyrjes së certifikatave të sigurisë në sistemin hekurudhor.

3. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore siguron që rregullat e detyrueshme teknike të publikohen dhe



të vihen në dispozicion për të gjithë administruesit e infrastrukturës, sipërmarrësit hekurudhorë dhe kërkuesit për autorizime për vënien në shërbim me një gjuhë të qartë që mund të kuptohet nga palët e interesuara.

Neni 148

Vënia në shërbime e nënsistemeve ekzistuese pas rinovimit apo përmirësimit

1. Subjekti kontraktues, në lidhje me një projekt për rinovim apo përmirësim të një nënsistemi ekzistues strukturor, duhet t'i kërkojë me shkrim Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore një vendim, kur kërkohet një autorizim për vënien në shërbim të këtij nënsistemi.

2. Subjekti kontraktues në lidhje me një projekt të nënsistemit:

a) emëron një organ të njoftimit për të kryer procedurën e verifikimit të vlerësimit;

b) siguron që një organ i njoftimit (qoftë ai i emëruar fillimisht apo një tjetër) vazhdon të jetë i caktuar deri kur është dhënë ose refuzuar leja.

3. Emërimi i një organi të njoftimit, sipas pikës 2, të këtij neni, bëhet:

a) para përfundimit të fazës së hartimit të projektit të nënsistemit; ose

b) përpara fillimit të fazës së prodhimit të projektit të nënsistemit, cilado qoftë faza më e hershme.

4. Subjekti kontraktues përpilon një deklaratë kontrolli në lidhje me këtë projekt të nënsistemit kur:

a) ai ka pëmbushur kërkesat thelbësore (përfshirë lidhjet ndërmjet tyre me sistemin hekurudhor mbi të cilin do të vendoset në shërbim);

b) procedura e duhur e kontrollit të vlerësimit kryhet nga një organ i njoftimit;

c) një certifikatë e pajtueshmërisë është hartuar nga një organ i njoftimit;

ç) është përgatitur një dosje teknike që përmban informacionin dhe dokumente të nevojshme në përputhje me një rregullore të veçantë.

5. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore merr vendimin e tij jo më vonë se katër muaj pas dorëzimit të dosjes së plotë nga ana e kërkuesit.

Neni 149

Lëvizja e lirë e nënsistemeve

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore në

territorin shqiptar nuk ndalon, nuk kufizon apo nuk pengon ndërtimin, vendosjen në shërbim dhe funksionimin e nënsistemeve strukturore, që përbëjnë sistemin hekurudhor, të cilat plotësojnë kushtet thelbësore.

2. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore në territorin e shqiptar nuk ndalon, nuk kufizon ose nuk pengon vendosjen në treg të përbërësve të ndërveprimit për përdorim në sistemin hekurudhor.

3. Llojet e kushteve teknike të ndërveprimit (TSI) dhe specifikimet e tyre përkatëse nuk janë pengesë e vendimeve të përdorimit të infrastrukturës për mjetet e transportit, të cilat nuk janë të mbuluara me kushtet teknike të ndërveprimit (TSI).

4. Zbatimi i dispozitave mbi ndërveprimin e sistemit hekurudhor nuk duhet të krijojë pengesa të pajustificuara në aspektin e kosto-fitimit për ruajtjen e rrjetit ekzistues hekurudhor kombëtar.

PJESA E SHTATË SHËRBIMET ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK DHE EKONOMIK

KREU I KONTRATAT E SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 150

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij kreu synojnë të përcaktojnë mënyrat e ndërhyrjes së autoritetit kompetent në sektorin e transportit hekurudhor publik të udhëtarëve, për të garantuar që ky shërbim me interes të përgjithshëm të ofrohet, midis të tjerash, me kapacitet sa më të lartë, të jetë sa më i sigurt, sa më cilësor ose i ofruar me çmime më të ulëta sesa ato të tregut të hapur.

2. Për këtë qëllim, në këtë kre vendosen kushtet, sipas të cilave autoritetet kompetente, në rastet kur përcaktojnë apo kontraktjnë detyrime të shërbimeve publike, kompensojnë operatorët e shërbimit publik për kostot që përballohen prej tyre dhe/ose u japin atyre të drejta ekskluzive në këmbim të pëmbushjes së detyrimeve për ofrimin e shërbimeve publike.

3. Mekanizmat, që mund të përdorë autoriteti kompetent për të garantuar ofrimin e shërbimit publik të transportit hekurudhor të udhëtarëve, përfshijnë dhënien në favor të operatorëve të



shërbimit publik të të drejtave ekskluzive ose të kompensimit financiar përkundrejt zbatimit nga ana e operatorëve të rregullave për kryerjen e shërbimeve të transportit publik.

Neni 151

Kontratat e shërbimit publik, parimet e përgjithshme

1. Në rast se autoriteti kompetent vendos t'i japë një operatori të përzgjedhur një të drejtë ekskluzive dhe/ose kompensim të çfarëdo lloji, në këmbim të përmbushjes së detyrimeve për ofrimin e shërbimeve publike, këto të drejta jepen me anë të një kontrate të shërbimit publik.

2. Në përjashtim nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, detyrimet e shërbimit publik, të cilat kanë si qëllim vendosjen e tarifave maksimale për të gjithë udhëtarët apo për disa kategori udhëtarësh, mund të rregullohen nga rregullat e përgjithshme të tregut.

3. Autoriteti kompetent kompenson operatorët e shërbimit publik, në përputhje me parimet e këtij kreu, për sa u përket efekteve financiare neto, pozitive dhe negative, kostove të përballuara dhe fitimeve të realizuara nga përmbushja e detyrimeve tarifore, sipas modaliteteve, me qëllim shmangien e kompensimit të padrejtë.

Neni 152

Përmbajtja e detyrueshme e kontratave të shërbimit publik

1. Kontratat e shërbimit publik përcaktojnë:

a) qartësisht detyrimet e shërbimit publik që operatori i shërbimit duhet të përmbushë, si dhe zonat gjeografike përkatëse;

b) paraprakisht në mënyrë objektive dhe transparente:

i) parametrat bazë, mbi të cilat do të llogaritet kompensimi;

ii) llojin dhe vlerën e të drejtave ekskluzive të dhëna dhe/ose kompensimit të çfarëdo lloji, me qëllim shmangien e kompensimit të padrejtë;

c) modalitetet e shpërndarjes së kostove të lidhura me furnizimin e shërbimeve;

ç) modalitetet e shpërndarjes së të ardhurave nga shitja e biletave të udhëtimit.

2. Parametrat bazë përcaktohen në mënyrë që kompensimi i dhënë të mos kalojë vlerën e nevojshme për të mbuluar efektin financiar neto mbi kostot e përballuara dhe të ardhurave të

realizuara nga kryerja e shërbimit publik, duke marrë në konsideratë të ardhurat e mbajtura nga operatori i shërbimit publik, si edhe të një norme të arsyeshme fitimi.

3. Kohëzgjatja maksimale e kontratave të shërbimit publik hekurudhor të udhëtarëve është 15 vjet, e cila mund të rritet me 50 për qind në rastet e përcaktuara nga ky Kod.

Neni 153

Kompensimi i shërbimit publik

Të gjitha kompensimet lidhur me një normë të përgjithshme ose kontratë të shërbimit publik duhet të jenë në përputhje me përmbajtjen e detyrueshme të kontratave të shërbimit publik, pavarësisht nga mënyra e dhënies së kontratës.

KREU II

KONTRATAT ME INTERES EKONOMIK

Neni 154

Kontratat me interes ekonomik të përgjithshëm

Për realizimin e objektivave të shërbimit publik dhe me qëllim nxitjen e transportit hekurudhor në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm, administruesi i infrastrukturës, si përgjegjës për rregullimin, zhvillimin, lidhjen dhe dhënien vlerë të infrastrukturës së rrjetit hekurudhor kombëtar, lidh me autoritetin shtetëror kompetent një kontratë për parametrat teknikë të infrastrukturës hekurudhore.

Neni 155

Parimet e hartimit të kontratës me interes ekonomik të përgjithshëm

Kontrata, sipas nenit 152, të këtij Kodi, është një marrëveshje që pasqyron detyrimet dhe të drejtat e palëve kontraktuese, si dhe duhet të përmbajë, si më poshtë:

1. Përshtatjen e hapjes së tregut dhe rritjen e përmirësimit të të ardhurave tregtare, si:

a) realizimi i një marrëdhënieje klienti për shitjen dhe krijimin e itinerareve;

b) përmirësimi i cilësisë së itinerareve dhe ekuilibrit me kërkesën;

c) parametrat tekniko-shfrytëzues të qarkullimit;

ç) krijimi i shërbimeve të reja të transportit dhe ofertave të reja të infrastrukturës;

d) rritja e përmirësimit të të ardhurave tregtare.



2. Modernizimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e parametrave tekniko-shfrytëzues të rrjetit, si:

- a) rinovimi i infrastrukturave;
- b) kontrolli i kostove të investimit për rinovimin;
- c) ndarja e politikave të administrimit të rrjetit;
- ç) organizimi i mënyrave për mirëmbajtjen e rrjetit;
- d) modernizimi i shfrytëzimit;
- dh) konceptimi i projekteve të zhvillimit të rrjetit;
- e) ushtrimi i kontrollit mbi veprat (programi, kostot, afatet);
- ë) strategjia mbi truallin dhe pronën.

3. Synimin e ekuilibrit ekonomik dhe krijimin e një financimi të qëndrueshëm, si:

- a) një model ekonomik, bazuar në mbulimin e kostos së plotë të rrjetit;
- b) rritja e të ardhurave tregtare, e udhëhequr nga një llogaritje e rezultatit;
- c) plani i biznesit;
- ç) ekuilibrat e papranuar nga nënbashkësitë.

4. Organizimin e një udhëheqjeje dinamike dhe sigurimin e një drejtimi të përgjegjshëm, si:

- a) ndihmesa e sipërmarrjes në drejtimin e sistemit hekurudhor;
- b) drejtimi, organizimi i sipërmarrjes dhe strategjia e kompetencës.

Neni 156

Lidhja e kontratës

Kontrata lidhet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për transportet dhe administruesit të infrastrukturës, duke pasur parasysh parimet dhe parametrat e dispozitave të këtij Kodi, për një afat kohor prej të paktën katër vjetësh.

PJESA E TETË KUNDËRVAJTJET DHE SANKSIONET

KREU I KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 157

Përgjegjësia për dëmet

Dëmtimi, shkatërrimi dhe ndërhyrja në kundërshtim me rregullat e përcaktuara, sipas këtij Kodi, në çdo pjesë të infrastrukturës hekurudhore

dhe në drejtimin e lëvizjes hekurudhore, kur nuk përbën vepër penale, është kundërvajtje administrative dhe dënohet në përputhje me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore, që dalin në zbatim të këtij Kodi.

Neni 158

Sanksionet për kundërvajtjet administrative

Për zbatimin e dispozitave të këtij Kodi, me akte ligjore dhe nënligjore të posaçme përcaktohen procedurat dhe vendimmarrja në lidhje me:

- a) vlerësimin e dëmeve në vlerë monetare nga administruesit e infrastrukturave, sipërmarrësit hekurudhorë apo ndaj të tretëve, në rast aksidenti apo incidenti;
- b) përcaktimin e sanksioneve dhe masave zhdëmtuese, si ajo financiare, heqje e së drejtës së hyrjes në infrastrukturë, heqje e certifikatës, autorizimit apo licencës etj.

Neni 159

Kundërvajtjet administrative

A. Konsiderohen kundërvajtje administrative, nëse nuk përbëjnë vepër penale, veprimet dhe mosveprimet në rastet e mëposhtme:

1. Kur administruesit e infrastrukturës, sipërmarrësit hekurudhorë apo cilado palë tjetër nuk i ofron Autoritetit Rregullator Hekurudhor të Tregut informacionin e kërkuar.
2. Kur administruesit e infrastrukturës nuk publikojnë “Deklaratën e rrjetit” sipas kritereve të përcaktuara në dispozitat e këtij Kodi.
3. Kur administruesit e infrastrukturës nuk e njoftojnë Autoritetin Rregullator Hekurudhor për zbritjen e tarifës së qasjes në infrastrukturë.
4. Kur administruesit e infrastrukturës bëjnë rezervime të kapaciteteve të infrastrukturës pa respektuar procedurat e përcaktuara në këtë Kod dhe akteve ligjore dhe nënligjore që miratohen në zbatim të tij.
5. Kur të ardhurat financiare, të krijuara nga qasja në infrastrukturën hekurudhore, nuk regjistrohen nga administruesi i infrastrukturës, si dhe nuk bëhen publike.
6. Kur evidentohen rastet që grafiku i shpërndarjes së kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore nga administruesi i infrastrukturës është hartuar në mënyrë diskriminuese, në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi.



7. Kur infrastruktura hekurudhore është deklaruar e mbingarkuar nga administruesi i infrastrukturës dhe nuk analizohen kapacitetet në afatin e caktuar.

8. Kur nuk është propozuar plani për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës nga administruesi i infrastrukturës, në rastet kur infrastruktura është deklaruar e mbingarkuar, si dhe është përfunduar analiza e kapacitetit infrastrukturor.

9. Kur procesi i planifikimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës i administruesit të infrastrukturës është kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe akteve zbatuese.

10. Kur evidentohen rastet se sipërmarrësit hekurudhorë nuk i përmbahen dispozitave të këtij Kodi, lidhur me licencat për shërbime hekurudhore dhe certifikatat e makinistëve, si në rastet kur nuk mbahen regjistrat e licencimit, si dhe certifikatave.

11. Kur sistemet e vendosura për administrimin e sigurisë nga administruesit e infrastrukturës apo sipërmarrësit hekurudhorë nuk përmbajnë elementet, të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor, sipas këtij Kodi, elementet bazë të SMS.

12. Kur administruesit e infrastrukturës apo sipërmarrësit hekurudhorë nuk paraqitin raportin vjetor tek Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore në afatin e caktuar.

13. Kur sistemet dhe nënsistemet hekurudhore nuk i plotësojnë kërkesat e sigurisë.

14. Kur subjekti nuk ka deklaratën e verifikimit, e cila dëshmon se nënsistemi strukturor konsiderohet si ndërveprues dhe i plotëson kërkesat thelbësore të sigurisë.

15. Kur mjetet e transportit hekurudhor operojnë pa numrin kombëtar të regjistrimit të mjeteve.

16. Kur transportuesi hekurudhor nuk mban në mënyrë korrekte regjistrin kombëtar të mjeteve hekurudhore.

17. Kur administruesit e infrastrukturës nuk disponojnë autorizimin e sigurisë hekurudhore, sipas dispozitave të përcaktuara të këtij Kodi, si dhe kur nuk aplikohet për rifreskim të autorizimit të sigurisë nga administruesi i infrastrukturës për vënien në shërbim të nënsistemeve strukturore pas çdo ndryshimi të realizuar në to.

18. Kur certifikatës të sigurisë së sipërmarrësit hekurudhor i ka kaluar afati kohor.

19. Kur administruesi i infrastrukturës nuk

mban regjistrin (me të dhënat teknike) për infrastrukturën hekurudhore.

20. Kur administruesi i infrastrukturës nuk përgatit planin e kërkuar të biznesit dhe dokumentet që lidhen me to.

21. Kur subjektet juridike, të cilat ndërtojnë apo rindërtojnë infrastrukturën hekurudhore, nuk marrin masat e duhura për zhvillimin e sigurt të trafikut hekurudhor, apo nuk largojnë nga vija hekurudhore, brezi mbrojtës i vijës hekurudhore, pas kryerjes së punëve, mbetjet, mjetet, shenjat lajmëruese dhe objektet tjera për të siguruar transport të sigurt me hekurudhë.

22. Kur administruesit e infrastrukturës hekurudhore nuk ndërmarrin masat adekuate në rast të çrregullimit në lëvizjet e trenave.

23. Kur Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore nuk i lejohet qasje në dokumentacion dhe objekte, instalime dhe pajisje, sipas dispozitave të këtij Kodi.

24. Kur administruesit e infrastrukturës hekurudhore dhe sipërmarrësit hekurudhorë futin në shërbim një nënsistem hekurudhor pa e marrë autorizimin për futjen në shërbim të mjetit nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

25. Kur sipërmarrësit hekurudhorë e futin në operim mjetin e transportit hekurudhor pa autorizim të mjetit dhe certifikatë përkatëse për funksionimin e tij.

26. Kur evidentohen rastet që mirëmbajtja e mjeteve të transportit hekurudhor bëhet në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi.

27. Kur gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës hekurudhore, nga administruesit e infrastrukturës, nuk ofrohen informacionet dhe zgjidhjet e kërkuara për publikun.

28. Kur, pas ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës hekurudhore, administratorët e infrastrukturës nuk aplikojnë për autorizim të sigurisë hekurudhore.

29. Kur administruesit e infrastrukturës hekurudhore nuk e ndërtojnë infrastrukturën hekurudhore me elementet e përshtatshme, sipas dispozitave të këtij Kodi.

30. Kur, pa miratimin e administruesit të infrastrukturës hekurudhore, personat juridikë, vendosin kablllo të rrjetit të telekomunikacionit, telefonike, elemente të rrjetit elektrik, gypa të ujërave etj. në brezin e vijës hekurudhore.

31. Kur administruesit e infrastrukturës nuk marrin masat e domosdoshme për mbrojtje teknike



dhe fizike nga fatkeqësitë elementare dhe forcat madhore.

32. Kur persona juridikë apo personat e tjerë ndërtojnë afër brezit mbrojtës të hekurudhës në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi.

33. Kur persona juridikë apo persona të tjerë ndërtojnë nënkalime, mbikalime apo vendkalime në nivel pa pëlqimin paraprak të administruesit të infrastrukturës hekurudhore.

34. Kur vendoset çfarëdo objekti në vijën hekurudhore, në mjetet hekurudhore, në sistemin e sinjalizimit dhe të ndërlikohjes (komunikimit), që cenon sigurinë e lëvizjes dhe trafikut të trenave.

35. Kur kryhet hapja e traut të kalesës hekurudhore nga persona të paautorizuar, vendosje e çfarëdo objekti mbi trautin e saj, dëmtimi i pajisjeve të sinjalizimit e të ndërlikohjes (komunikimit) të kalesës hekurudhore.

36. Kur kryhen punime në afërsi të kalesës hekurudhore, të cilat reduktojnë ose pengojnë fushëpamjen e vijës hekurudhore.

37. Kur pengohet puna e drejtuesit të lëvizjes së trenave në stacione, makinistëve, punonjësve që mbikëqyrin vijën hekurudhore, punonjësve që shërbejnë në kalesa hekurudhore, ura, tunele ose të çdo punonjësi tjetër hekurudhor gjatë trafikut hekurudhor.

38. Kur kryhet lëvizja ose ndalimi i automjeteve, i karrove të tërhequra me kafshë në vendkalime të pamiratuara.

39. Kur evidentohet qëndrimi ose lëvizja e njerëzve apo e kafshëve dhe kullotja e gjësë së gjallë mbi dhe nëpër vijat hekurudhore.

40. Kur evidentohen raste të ndezjes së zjarreve, djegia e vegjetacionit (barit, shkurreve) dhe e të mbjellave brenda ose në brezin e vijës hekurudhore, si dhe ndikimeve negative në mjedis.

41. Kur persona të paautorizuar hyjnë në vendet e drejtimit të trenave, në lokomotivat, në mjetet e tjera dhe në të gjitha postet e lëvizjes së trenave.

42. Kur evidentohet përdorimi nga punonjësit hekurudhorë i pijeve alkoolike, drogave ose substancave narkotike dhe të rrezikshme për shëndetin, para dhe gjatë kryerjes së shërbimit.

B. Kundërvajtjet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dënohen me gjobë, masa e së cilës përcaktohet në aktet ligjore në zbatim të këtij Kodi.

C. Në rastin e kundërvajtjeve administrative, përveç gjobës mund të vendosen dhe kufizime të tjera, të lidhura me profesionet për sektorin e

transportit hekurudhor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 160

Autoritetet zbatuese

1. Autoritetet që ngarkohen për marrjen e masave administrative dhe zhdëmtimin janë si më poshtë:

a) Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore merr masa për heqje, sipas rastit, të certifikatës dhe autorizimeve të dhëna;

b) Autoriteti Rregullator Hekurudhor është organi që, në zbatim të legjislacionit në fuqi, aplikon zhdëmtimin financiar;

c) Autoriteti Licencues Hekurudhor, në rastet kur Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore vepron me akte të heqjes së certifikatave apo autorizimeve, është i detyruar të rishqyrtojë dhënien e licencës.

2. Të tria këto autoritete kombëtare, në zbatim të këtij Kodi dhe të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore, që dalin në zbatim të tij, mund të bashkëpunojnë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë përgjegjëse për secilin autoritet.

3. Qëllimi i bashkëpunimit është ruajtja e tregut, sigurimi i transparencës dhe moslejimi i diskriminimit.

4. Rastet që nuk janë parashikuar në këtë Kod trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

5. Procedurat e vjeljes së detyrimeve që rrjedhin nga sanksionet administrative kryhen në zbatim të legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe detyrimet.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 161

Aktet ligjore dhe nënligjore

1. Aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të këtij Kodi hartohen brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Ligji nr. 9317, datë 18.11.2004, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Kodi.

3. Aktet ligjore e nënligjore, që lidhen me objektin e këtij Kodi, mbeten në fuqi ose kanë efekt për aq sa nuk bien në kundërshtim me të, deri në daljen e akteve të reja, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.



Neni 162
Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi një vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.12.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9944, datë 9.1.2017 të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar
Nishani**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 560 lekë